



Studime e publicistikë

Qendra për Çështjet e Informimit Publik

GERTI SHELLA

MEDIA DHE AXHENDA ANTIKORRUPSION

Në televizion, midis politikës dhe shoqërisë civile



Studime e publicistikë

Konsulent shkencor:
Prof. Dr. Artan FUGA



BOTIMET DUDAJ



Adresa: Rr "Ali Demi", P 137, Sh 3, A 23, Tirane

E-mail: qendra@cip-al.org

Project Title:

Integrating the anti-corruption of civil society agenda into the political agenda

Contract number: 2103-09-CPII

© Autori

ISBN 978-99943-0-023-5

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 41 pranë Universitetit "Marin Barleti", godina nr.4, Tiranë

Tel. - fax.: 00355 4 249 944

E-mail: info@botimedudaj.com

Website: www.botimedudaj.com

REFUZIM

Ky studim u mundësua nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID) nëpërmjet Programit të Shtetit Ligjor.

Pikëpamjet e autorit të shprehura këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

TABELA E LËNDËS

DEKLARIMI I PROBLEMIT	9
Teza (...që ka ekzistuar).....	9
Antiteza (që pasoi ...)	10
Sinteza (...tani dhe këtu).....	11
Konkluzioni (... një tezë e re ...)	12
Synimi i studimit	14
DY FJALË HYRËSE LEXUESIT	16
SA E PENGON SJELLJEN POLITIKE KORRUPTIVE	
LIGJI ELEKTORAL?	23
Standardet zgjedhore dhe korrupsioni.....	24
Konsensusi i bazuar në ligj.....	25
Dy divanet	27
“Shqiptarët e hanë mirë politikën”	29
Politika dhe administrata.....	32
«Keni marrë mandatet tona, zhvilloni përgjegjësitë tuaja!».....	32
Kolltuku bosh	35
PUSHTETI LOKAL DHE KORRUPSIONI	42
Korrupsioni dhe pasojat e tij ekonomike mbi publikun	43
Dy kolltukët	44
Korrupsioni dhe plani rregullues i qytetit	49
Përballë akuzave për korrupsion: dinamikat urbane	51
KORRUPSIONI, MES POLITIKËS DHE DREJTËSISË	61
Gjendja dhe niveli i korrupsionit	63
NEWS 24 ka filluar të «hajë» djathtas	63
I kujt është faji për nivelin e korrupsionit?.....	65
Avantazhet e analizës së aktorëve të shoqërisë civile	68
Reformim nga jashtë apo nga brenda?.....	74
Përse media televizive është më e hapur ndaj shoqërisë civile sesa mediat e tjera?.....	79
Shteti si korporatë biznesi	83

POLICIA DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT	87
Policia na mbron ne, kush na mbron nga policia?.....	87
Dallime midis shoqatës joqeveritare dhe grupeve të interesit.....	89
Kompetencat profesionale të aktorëve të shoqërisë civile	93
Përse ndodh që politikani të jetë më kritik se aktorët e shoqërisë civile?.....	95
MORALI POLITIK DHE KORRUPTIMI I VLERAVE	100
A mund të bashkëpunohet me një ish-kundërshtar?.....	100
«Moralitë elektoral».....	104
VËSHTIRËSITË E AKTORËVE TË SHOQËRISË CIVILE.....	107
KAPACITETI REAGUES I SHOQËRISË CIVILE.....	110
Shoqëria civile, sa është impact-oriented?	113
KOMUNIKIMI POLITIK DHE SHOQËRIA CIVILE.....	115
Shumëllojshmëria e formave të komunikimit.....	115
Aftësia për të ndërtuar argumente bindëse dhe adresimi i qartë	117
Gatishmëria për t'u ballafaquar me të tjerët	118
Kompetencat profesionale në trajtimin e çështjeve.....	119
Etika në debatin publik	121
Kapaciteti reagues ndaj aktualitetit mediatic	122
Pavarësia e mendimit dhe mungesa e oportunitizmit.....	123
Masivizimi i mendimit politik.....	125
Artikulimi i mendimit – aksion	126
Çinteresi material dhe përkushtimi personal.....	128
PROF. DR. ARTAN FUGA	
EDHE NJË HERË MBI KORRUPSIONIN	131
Pasojat negative të korrupsionit.....	131
Përafrime të mangëta të çështjes	135
ARSYE QË MBAJNË GJALLË KORRUPSIONIN.....	139
Modeli ekonomik kryesisht tregtar i vendit	139
Politizimi i administratës dhe i sistemit të drejtësisë	141
Varfëria dhe mungesave e infrastrukturave.....	144
SHTOJCA 1	
MBI METODOLOGJINË E STUDIMIT	147

FALËNDERIM

Ky studim mbi komunikimin politik dhe rolin e medias në integrimin e axhendës antikorruption të aktorëve të shoqërisë civile në axhendën e vendimmarrjes politike, sidomos para dhe gjatë proceseve legjislative, është i pari në serinë e botimeve të Qendrës për Çështje të Informimit Publik. Shpresoj që një botim i tillë t'u hapë rrugën studimeve të tjera më të thelluara në këtë disiplinë të shkencave të komunikimit, e cila është sa e domosdoshme, aq edhe bashkëkohore për t'i dhënë një shans më shumë demokracisë shqiptare, e cila sapo ka hyrë në fazën e konsolidimit.

Në emër të Qendrës për Çështje të Informimit Publik dhe në emrin tim personal si autor i këtij studimi falënderoj Dott. Carlo Bollino, administrator i përgjithshëm i grupit mediatik që zotëron televizionin *NEWS 24* për kujdesin e jashtëzakonshëm dhe mbështetjen që më ka siguruar, jo vetëm në kuadër të këtij studimi, por edhe në karrierën time si gazetar televiziv.

Falënderoj gjithashtu kryeredaktoren e televizionit *NEWS 24*, Alba Malltezi, për ndihmën e pakursyer profesionale dhe për të gjitha sugjerimet e saj dhëna prej saj edhe në kuadër të këtij studimi.

Gjithashtu, një studim i tillë do të kishte qenë i pamundur të realizohej pa ndihmesën e vyer të stafit realizues të emisioneve *Vila 24* dhe *Studio 24* dhe në mënyrë të posaçme të drejtores së programacionit në *NEWS 24*, Anduena Manushi.

Në emër të Qendrës për Çështje të Informimit Publik falënderoj Koalicionin Shqiptar Kundër Korrupsionit, ACAC, Zyrën për Mbrojtjen e Qytetarëve, CAO dhe të gjithë ata përfaqësues të shoqërisë civile të cilët nuk kanë hezitur në asnjë rast të ofrojnë ndihmesën, rekomandimet dhe sugjerimet e tyre profesionale dhe njerëzore.

Një falënderim dhe një mirënjohje e thellë shkon për të gjithë stafin menaxherial të *Casals&Associate* dhe në mënyrë të posaçme për z. Gerald Mayerman, si dhe në përgjithësi për USAID në Shqipëri, që mundësoi financiarisht, por jo vetëm, këtë studim.

Dhe falënderimi më i veçantë është për profesorin tim të Filozofisë, personalitetin dhe mbi të gjitha njeriun që ka ndikuar më shumë se gjithë të tjerët në formimin tim universitar dhe intelektual, ndihmesa e pakursyer e të cilit bëri realitet një objektiv që dukej i paarrtshëm, konsulentin shkencor të këtij studimi, Prof. Dr. Artan Fuga.

Gerti Shella

DEKLARIMI I PROBLEMIT

Teza (...që ka ekzistuar)

Edhe pse Shqipëria ka zhvilluar në këto vite, falë një bashkëpunimi të ngushtë me komunitetin ndërkombëtar, një numër mekanizmesh për të luftuar korrupsionin sistematik shumë të përhapur, ende mbetet për t'u parë se në çfarë mase është shënuar progres. Që nga viti 2000 deri në vitin 2003, Shqipëria arriti të demonstrojë kapacitete për të zhvilluar plane veprimi apo të përgatisë matrica antikorrupsion, madje të ngrrejë deri edhe institucione të posaçme që kanë objektiv të veprimitarisë së tyre luftën kundër korrupsionit. Deri në vitin 2003, lufta kundër korrupsionit konsistonte vetëm në deklarata dhe/apo memorandume mirëkuptimi mes qeverisë dhe atyre operatorëve të shoqërisë civile të angazhuar së fundmi në luftën kundër korrupsionit në rritje. Këto memorandume mirëkuptimi dhe deklarata të përbashkëta rezultuan të ishin joefikase dhe rrjedhimisht të pamjaftueshme¹. Programet dhe projektet antikorrupsion, sidomos ato të Koalicionit Shqiptar Kundër Korrupsionit (ACAC), u prirën në

1) Martin Tisne' & Daniel Smilov: "From the ground up", Assessing the record of Anticorruption Assistance in South-Eastern Europe, Center for Policy Studies, Series 2004, Central European University.

përgjithësi të konsideronin si më shumë frytdhënës bashkëpunimin me qeverinë, sesa konfrontimin me të për sa i përket arritjes së rezultateve të prekshme në luftën kundër korrupsionit.

Antiteza (që pasoï ...)

Kjo lloj qasjeje jokonfrontuese në raport me qeverinë nuk justifikonte mirë një lloj mandati si "grupe presioni" që ACAC dhe OJF të tjera kishin filluar të merrnin në sy të publikut. Kjo "vetëdije" e re si grupe presioni, e cila po krijohej për këto organizata në publik dhe njëkohësisht që edhe ato vetë po krijonin mbi rolin e tyre do të fillonte të prodhonte shumë shpejt të kundërtën e asaj që në fillim ishte një qasje bashkëpunuese me qeverinë për ndërtimin e matricave të përbashkëta antikorrupsion. Dialogu në nivel institucional që ekzistonte deri në vitin 2003-2004 u konvertua në të kundërtën e vet. Aktorë të rinj të shoqërisë civile filluan të dalin në rrugë e bulevarde për të protestuar. Angazhimin e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe keqqeverisjes këta aktorë të rinj filluan "ta firmosnin" me letra higjienike apo me "bojën" e siguruar nga qindra vezë që thyheshin në një portret butaforik të shefit të qeverisë, në vend që të hidhnin me stilograf firmën për marrëveshje të përbashkëta të angazhimit në luftën kundër korrupsionit, sikurse përfaqësuesit e tjerë të shoqërisë civile para tyre kishin bërë. Rasti më ilustrues i këtij realiteti të ri është lëvizja "Mjaft", e konceptuar apo më mirë të themi "e lindur" për të protestuar. Sigurisht që gjithçka ndodh për një arsye; fushatat në shkallë të gjerë për ndërgjegjësim të publikut në luftën kundër korrupsionit, të ndërmarra deri para daljes së "Mjaft"-it kishin prodhuar pritshmëri shumë të larta të publikut ndaj qeverisë dhe shoqërisë civile. Sa i përket qeverisë, kjo u bë gjithmonë e më e korruptuar, sa më shumë shoqëria civile ndërgjegjësonte publikun se sa i dëmshëm është fenomeni korruptiv. Sigurisht që komunikimi institucional (si shprehje e komunikimit politik) mes shoqërisë civile

dhe shoqërisë politike të përfaqësuar nga qeveria e kishte humbur kuptimin dhe legjitimitetin. Dalja e "Mjaft"-it në skenë shënon edhe fundin e këtij lloj komunikimi. Qeveritë socialiste të kohës u bënë gjithmonë e më të korruptuara, derisa më në fund u perceptuan nga publiku si "vetë korrupsioni". Më 3 korrik 2005, shqiptarët ndër të tjera votuan edhe kundër korrupsionit.

Sinteza (...tani dhe këtu)

Pas 3 korrikut 2005, qeveria e kryesuar nga demokratët demonstroi fillimisht një vullnet politik për të luftuar korrupsionin. Në këtë fazë, mediat ishin përcjellëse të këtij lloj vullneti në publik. Antikorrupsioni ishte kali i betejës së fituar elektorale të 3 korrikut, që i kishte dhënë ngjyrimin e veçantë edhe gjithë komunikimit politik si para fushatës elektorale, ashtu edhe pas ardhjes në pushtet të mazhorancës së djathtë. Për shkak të komunikimit politik efikas, ose për shkak të disa masave që synonin goditjen e nepotizmit dhe konfliktit të interesave në administratë, niveli i perceptimit të korrupsionit pësoi rënie që në vitin e parë të qeverisjes së demokratëve. Megjithatë mbetet shumë akoma për t'u provuar dhe për t'u parë nëse vetëm ekzistenca e një vullneti politik mjafton për të luftuar korrupsionin dhe informalitetin. Si rregull, vullneti politik nuk mjafton, nëse nuk mbështetet në nisma ligjore të studiuara, të cilat nga ana e tyre duhet të integrojnë ekspertizën më të mirë vendase dhe të huaj. Një shoqëri civile aktive mund të luajë një rol të fuqishëm jo vetëm në stigmatizimin e dështimeve të qeverisë, por mbi të gjitha në monitorimin e kapjes së objektivave nga ana e qeverisë duke ofruar në të njëjtën kohë ekspertizën e saj më të mirë. Edhe pse shoqëria civile në Shqipëri mbarë gjithë legjitimitetin e domosdoshëm për të qenë dyshuese ndaj masave që ndërmerr qeveria për të luftuar korrupsionin dhe informalitetin, kjo nuk do të

justifikonte aspak mungesën e një komunikimi pro-aktiv, qoftë edhe formalisht. Një ndërveprim sinergjik në kuadër të një komunikimi politik të strukturuar, sidomos gjatë fazave të draftimit të ligjeve nga qeveria dhe futjes së tyre në proces legjislativ në Kuvend, është i nevojshëm, sidomos për ato ligje që materializojnë premtimet thelbësore për luftën kundër korrupsionit dhe informalitetit. Është e vështirë të thuhet se në cilën masë shoqëria civile dhe shoqëria politike komunikojnë sot me njëra-tjetrën, pasi nuk janë zhvilluar ende indikatorë që të mund të matin nivelin e ndërveprimit mes tyre. Si rregull, protestat antikorrupsion të shoqërisë civile duhen konsideruar si opsioni i fundit për t'i dërguar mesazhe politikës. Komunikimi politik i parë pikësëpari si dialog institucional nuk ka pse të përjashtohet nisur vetëm nga fakti se në vitet 2000 ai nuk dha rezultat. Gjithashtu komunikimi konstruktiv nëpërmjet medias si një lokus ndërveprimi midis aktorëve të politikës dhe shoqërisë civile nuk ka pse të përjashtohet. Ai duhet rikonceptuar dhe riformatuar për të dhënë rezultat para se të krijohet nevoja për protestë (ose që kjo e fundit të mos degjenerojë në një "show" duke mos qenë rrjedhimisht "impact-oriented").

Konkluzioni (... një tezë e re ...)

Media është një mjet i fuqishëm komunikimi. Për fat të keq, vetëm pak përfaqësues të shoqërisë civile ia kanë dalë mbanë deri tani që të komunikojnë me efikasitet mesazhet e tyre në adresë të vendimmarrësve politikë apo publikut. Prej aktorëve të shoqërisë civile kërkohet më shumë fleksibilitet në perceptimin e shpejtë të dinamikave politike sikurse edhe kapacitete të rritura për një reagim imediat, në mënyrë që të jenë të "sintonizuar" me median që pasqyron aktualitetin. Në këtë mënyrë rriten shumë shanset për të maksimizuar impaktin në publik si dhe monitorimin ose/dhe presionin

ndaj qeverisë në realizimin e objektivave të saj të shpallura. Në një lloj kuptimi, është fat për shoqërinë civile që në Shqipëri tranzicioni demokratik dhe mandej vetë konsolidimi i demokracisë ndodh në epokën e mediave elektronike. Sot shumë vëzhgues të proceseve të demokratizimit argumentojnë se demokracitë e sotme gjithmonë e më tepër janë duke u kthyer në media-demokraci. Në një kuptim më të ngushë, media mund të lehtësojë (facilitojë) gjithashtu një lloj qasjeje sintetike sa i përket adresimit të korrupsionit të vendimmarrësit politikë dhe të përfaqësuesit e ekzekutivit prej aktorëve të shoqërisë civile dhe ekspertëve vendas duke u krijuar më shumë hapësirë këtyre të fundit. Praktika të bën të përsosur, edhe kur bëhet fjalë për perfeksionim të teknikave të komunikimit në media. Edhe skeptikët më të mëdhenj të rolit konkret të shoqërisë civile në proceset e demokratizimit nuk mund të mohojnë dot se media ka qenë përgjithësisht e mbyllur ndaj këtyre përfaqësuesve, nisur edhe nga një lloj stigmatizimi i padrejtë që përfaqësues të caktuar të medias kanë ndaj sektorit të tretë. Sigurisht, për dikë që punon në media, sidomos në një media agresive sikundër është ajo në Shqipëri, «bed news is good news». Në këtë logjikë, një protestë në rrugë kundër kryeministrit tërheq i shumë më tepër kamerat, nga ç'do të tërhiqte një studio televizive një përfaqësues të shoqërisë civile para se të puna të shkonte deri te protesta si opsion i fundit. Në njëfarë mënyre mediat dhe parafytyrimi i tyre mbi procese të komunikimit politik ndikojnë drejtpërsëdrejti në qasjet që shoqëria civile bën ndaj problemeve të caktuara, që lindin në një shoqëri me dinamika të forta, me aktorët politikë dhe civilë të cilët janë të përfshirë në procese legjislative intensive. Media e hapur ndaj tyre dhe e kthyer në këtë mënyrë në një lokus bashkëkohor ndërveprimi mes tyre mund të influencojë pozitivisht në rigjetjen e sinergjive të munguara dhe në optimizimin e komunikimit politik mes shoqërisë politike dhe shoqërisë civile duke u dhënë shans të jashtëzakonshëm proceseve demokratike integruese dhe pro-

aktive. Kjo do të reduktonte domosdoshmëritë për protesta si mjete ekstreme të komunikimit politik në një shoqëri të hapur dhe do të krijonte avantazhe të vyera në rikuperimin dhe përshejtimin e ritmeve të konsolidimit institucional, sidomos në kuadër të proceseve legjislative.

Synimi i studimit

Ky studim i realizuar nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, me financim nga USAID-i, merr përsipër të adresojë pikërisht këtë problematikë, sikurse është shpjeguar në "Deklarimin e problemit":

1. duke identifikuar mundësi për akses të shtuar në media të përfaqësuesve të shoqërisë civile, me synimin që të krijojë mundësi për përmirësim të kapaciteteve komunikuese të aktorëve të shoqërisë civile për të adresuar publikisht shqetësimet dhe rekomandimet e tyre për përfaqësuesit e shoqërisë politike;

2. duke sjellë në vëmendje të parlamentarëve dhe zyrtarëve qeveritarë argumente specifike dhe probleme konkrete të identifikuara dhe të adresuara në media nga aktorë të shoqërisë civile, duke përdorur median si një mjet të fuqishëm ndërveprimi në publik;

3. duke zhvilluar disa indikatorë specifikë për të matur kapacitetin e përfaqësuesve të shoqërisë civile për të adresuar drejt nëpërmjet medias problemet e identifikuara, sidomos sa i përket luftës kundër korrupsionit, sikurse edhe kapacitet e tyre reaguese, kur bëhet fjalë për çështje që janë të një interesi të madh publik (edhe pse këto mund të jenë jashtë kuadrit të projekteve që mund të jenë duke implementuar);

4. duke zhvilluar disa indikatorë specifike për të matur kapacitetin absorbues të përfaqësuesve të shoqërisë politike ndaj atyre që janë shqetësime të ngritura dhe të artikuluar në media nga përfaqësues të shoqërisë civile. (Pra, në ç'masë problemet – antikorruption ose edhe më gjerë - e identifikuar nga ekspertë të shoqërisë civile njihen (acknowledge) si shqetësim publik nga përfaqësuesit e politikës dhe ndërfuten në axhendën e diskutimit politik apo të vendimmarrjes politike.)

DY FJALË HYRËSE LEXUESIT

Nga gazetaria televizive te paraqitja e shkruar e ideve, debateve, pozicioneve politike ka një hapësirë të tërë për të mbushur, çka nuk mund të bëhet pa vështirësitë e veta. Thuhet kjo qysh në fillim, sepse në televizion mendohet se përballë gazetarit, përpara ekranit të vogël, qëndron telespektatori. Ndërsa këto rreshta, përkundrazi, i drejtohen lexuesit i cili mund t'i ketë parë programet dhe emisionet për të cilat do të flasim, por edhe mund të mos i ketë parë ato. Në të dy rastet ndodhesh përpara së njëjtës vështirësi. E shkruara duhet të rikrijojë imazhin televiziv, zërin dhe kryesisht figurën.

Mbi cilën metodikë bazohet studimi në fjalë, në çfarë aspekti konkret media analizohet si një lokus ndërveprimi, cilat programe konkrete janë mbajtur në fokusin e studimit dhe në çfarë këndvështrimi duhen analizuar ato?

Janë dy emisione televizive të prodhuara dhe të transmetuara nga News 24, një nga kanalet televizive më të ndjekura në Shqipëri. Nga sondazhet e bëra për të matur teleshikueshmërinë, del se telespektatori vlerëson te ky kanal televiziv informacionin e shkurtër dhe të freskët, që ndryshon dhe rinovohet nga çasti në çast përgjatë

gjithë ditës. Nëntitrat shoqërojnë figurën dhe zërin duke dhënë informacione të pavarura. Profesor Artan Fuga thotë se e parapëlqen këtë formë për shkak se ajo realizon atë që profesionalisht quhet «polifoni e mesazhit televiziv». Njëkohësisht mund të transmetohen parametrat e klimës për ditën në vazhdim, reklama produktesh, lajme të shkurtra të përkthyer në anglisht, deklarata liderësh politikë, njoftime të subjekteve të ndryshme, ndërkohë që figura mund të transmetojë një intervistë në studio apo edhe një bisedë për çështje të aktualitetit.

Në një televizion si *NEWS 24* informacioni jo vetëm është shumë i shpejtë, i dendur, por edhe i gjithfarëlojshëm, nga lajmet më sensacionale politike, deri tek aktualiteti ndërkombëtar; nga ngjarjet sociale të ditës, deri te deklaratat më të forta të personazheve dhe aktorëve të jetës politike vendase. Gjithçka shoqërohet me nëntitrat që "kompozojnë" një informacion i cili u drejtohet të gjitha shqisave duke stimuluar një vëmendje të veçantë nga ana e telespektatorit për të kapur gjithçka që transmetohet në ekran.

Si gazetar televiziv je i detyruar, madje i shtrënguar, që të mbash parasysh këtë specifikë edhe kur drejton, animon, koncepton emisione të tilla si *Studio 24*, apo *Vila 24*, sikurse është rasti për emisionet për të cilat do të flasim. Atje ku telespektatori ynë është mësuar që të ndjekë lajme flesh, të shpejta, të dendura, që kalojnë para syve të tij, shpejt, pothuajse rrufeshëm, pikërisht atje, është dashur të konceptohen dhe transmetohen edhe biseda në studio.

Nuk është e lehtë të integrosh biseda në studio në një televizion ku lajmi i shpejtë dhe shumë dinamik «e ka stërvitur» telespektatorin e tij për të qenë disi i paduruar ndaj trajtimeve të gjata. Duke u mbështetur te një filozof strukturalist, specialist i sociologjisë së komunikimit, Pierre Bourdieu, profesor Artan Fuga thotë se televizioni është media e «mendimit të shpejtë» dhe e formulave të gatshme. Televizioni është media e «fast thinkers», e atyre që mendojnë rrufeshëm. Ky është kyçi. Në televizion nuk ka kohë.

Si të bësh që edhe mendimi të jetë i shpejtë, por edhe i thellë?
Si ta bashkosh shpejtësinë e një lumi me thellësinë e tij?

Nga njëra anë fluksi i pafund i lajmeve që shfaqen me anë të titrave të shkruara në të gjitha anët e ekranit. Nga ana tjetër, në qendër të tij, transmetohet një bisedë apo një intervistë televizive, e cila sado dinamike që të jetë, kërkon sidoqoftë njëfarë thellimi të argumentit.

Shpeshherë ritmi i bisedës nuk varet prej gazetarit. Ka të ftuar që flasin rrjedhshëm dhe shpejt, por ka të tjerë që kanë nevojë të mendohen më shumë. Ka nga ata që i qëndrojnë temës së debatit për të cilën janë ftuar, por ka prej tyre që në zjarrin e polemikave e braktisin temën e përzgjedhur dhe shkojnë shumë larg saj, në horizonte të tjera, interesante, por gjithsesi që nuk mund të trajtohen të gjitha njëherësh. Ka të ftuar që të shikojnë në sy dhe janë gati ta kuptojnë se gazetari kërkon të nxjerrë në pah diçka tjetër, kërkon të respektohet koha, kërkon të artikulohej përjasje më konkrete dhe të zhdërvjellëta, sepse edhe koha nuk premt. Duke «skaduar» koha në dispozicion të «të ftuarit» skadon edhe oportuniteti për të komunikuar një mesazh në publik apo që në mënyrë më specifike i adresohet një procesi ligjvënës, që sapo ka nisur dhe që mbart defekte për t'u trajtuar nën presionin e kohës që gjithashtu edhe në qeveri apo parlament vetëm ikën.

Vila 24 u konceptua si një bashkëbisedim në formë interviste në studio mes gazetarit dhe të ftuarve të tij. Ndërsa *Studio 24* është një cikël emisionesh televizive, ku transmetohen biseda në studio, të cilat si rregull tentojnë të prodhojnë debat dhe ku protagonistë janë kryesisht politikanë, aktorëve të shoqërisë civile, njerëz të shkencës, të artit, etj, gjithmonë në funksion të aktualitetit politik të vendit.

Ajo që do të marrim në analizë lidhur me këto programe televizive lidhet me një temë madhore debatesh, reformash, propagandash, veprimesh dhe ligjesh që janë artikuluar së fundi, pra ka të bëjë me çështjen e madhe dhe të gjerë të luftës kundër korrupsionit.

Duke filluar nga muaji dhjetor i vitit të kaluar dhe përgjatë gjithë gjysmës së parë të vitit në vazhdim, në këto dy emisione janë ftuar personalitete të ndryshme të jetës politike në vend, drejtues shoqatash joqeveritare, aktorë të shoqërisë civile, politikanë, deputetë, ministra, etj, pikërisht për të debatuar midis tyre lidhur me çështjen e korrupsionit dhe luftës kundër tij me synim ndërmarrjen e reformave efikase, bërjen e ligjeve cilësore që rrjedhin nga një proces demokratik konsultimesh mes aktorëve të ndryshëm të interesuar dhe mbi të gjitha që të mund të jenë të implementueshme.

Përgjatë gjithë kësaj kohe, emisionet televizive në fjalë kanë «përplasur» rreth kësaj teme të madhe disa lloje aktorësh.

Më së pari, aty ka qenë i pranishëm gazetari, gazetari që animon emisionin, gazetarë të ftuar, apo gazetarë nga "Gazeta Shqiptare", të cilët kanë ndërhyrë me konsideratat e tyre, si edhe kryesisht, sikurse është detyra e tyre, me pyetje drejtuar të pranishmëve të tjerë.

Kanë qenë të pranishëm politikanë nga shumica parlamentare, deputetë të këtij krahu politik, pra të së djathtës së sotme shqiptare, sikurse ministra, por edhe deputetë, politikanë të opozitës.

Ekuilibrimi i kohës televizive midis së ftuarve të ndodhur në kahe politike të kundërta ka qenë një kërkesë deontologjike e mbikëqyruar dhe e respektuar me shumë kujdes nga prodhuesit dhe transmetuesit e emisioneve.

Por, ajo për të cilën dëshiroj të tërheq vëmendjen dhe çka përbën një karakteristikë të fortë të këtyre dy emisioneve është fakti se aty kanë qenë të pranishëm, në të njëjtin panel me vendimmarrësit politikë, përfaqësuesit më të shquar të shoqërisë së sotme civile, pra nga drejtuesit më të suksesshëm të organizatave joqeveritare që punojnë në vendin tonë. Një pjesë e mirë e tyre janë të përfshirë në koalicionin shqiptar të luftës kundër korrupsionit, ACAC, të mbështetur financiarisht nga qeveria amerikane, nëpërmjet USAID-it.

Në këtë botim do të mundohemi t'i analizojmë emisionet televizive në fjalë. Mbi të gjitha na intereson të paraqesim se cili ka qenë

kontributi i shoqërisë civile, domethënë, në këtë rast, kontributi i organizatave joqeveritare të angazhuara me projekte në procesin e luftës kundër korrupsionit, cilat janë kapacitet e tyre për ta mbështetur këtë ndërmarrje të madhe dhe të ndërlikuar nëpërmjet komunikimit në media, cilat janë avantazhet dhe kufizimet e tyre, sikurse edhe për të nxjerrë në pah se sa dinë ato t'i bëjnë oponentë politikës duke zhvilluar në shoqëri kulturën e debatit dhe të diskutimit publik.

I kthehemi edhe një herë faktit se midis veprimtarisë së gazetarit televiziv dhe hartuesit të këtyre radhëve, ndonëse është i njëjti njeri, ka dallime thelbësore, të cilat duhen mbajtur në konsideratë. Në pozicionin e gazetarit ndodhesh në një situatë kur vepron, sigurisht pasi je menduar njëqind herë, por veçanërisht kur je në transmetim direkt, ka pak kohë për të rimenduar, e ndoshta s'ka vend fare për të bërë refleksione të gjata. Atje më shumë bën dhe më pak mendon, kurse kur nis e reflekton për atë që ke prodhuar në studio dhe i ke paraqitur telespektatorit, pra në çastin kur formulon mendimin kritik për emisionet e tua, ke kohë të mendosh. Por, asgjë nuk ndryshon më.

Ajo që është bërë nuk zhbëhet më.

Është sidoqoftë një përvojë që grumbullohet për një rast tjetër.

Pastaj, nuk duhet harruar që çdo imazh, gjest, fjalë e thënë – të konsideruara si fakte empirike – mund të interpretohen në mënyra të ndryshme, por asnjëherë në mënyrë shteruese. Tani mund t'i jepet një kuptim i caktuar asaj që ka ndodhur në emision, por ky kuptim është sidoqoftë relativ dhe krejtësisht i përafërt. Çdo gjë që ndodh në studio është një fakt, kurse tani, rikthimi tek ai fakt, qoftë edhe në mënyrë shumë besnike duke iu rikthyer vizionimit të kasetave ku janë regjistruar emisionet, nuk është veçse objekt i një reflektimi. Janë forma të kuptimit të asaj që kanë ndodhur në studio, por që çdokush mund t'i interpretojë lirshëm sipas logjikës së tij. Emisionin në njëfarë mase e ka në dorë gazetari, kurse interpretimin e emisionit, pra edhe të vetes, nuk e ka më në dorë ekskluzivisht ai.

Pa konsulencën shkencore të profesor Artan Fugës, ky studim do të ishte në rastin më të keq pothuajse i pamundur dhe në rastin më të mirë larg objektivitetit.

Asnjë emision televiziv nuk mund të marrë jetë, nëse ai nuk realizohet si një bashkëpunim solidar, ndoshta shpeshherë edhe i tendosur, midis gazetarit dhe të ftuarve të tij.

Prandaj, sa vlerë ka paraqitja e asaj që kanë thënë dhe kanë transmetuar të ftuarit me qëndrimet, gjestet, fjalën, mimikën e tyre, po aq rëndësi ka edhe loja e gazetarit, strategjia e tij, mënyra sesi ai e kupton dhe e realizon rolin e tij brenda asaj kohe marramendëse që është koha televizive.

Dhe së fundi, interesi i veçantë ka qenë për të nxjerrë në pah me përparësi sjelljen dhe artikulinin gjuhësor të përfaqësuesve të shoqërisë civile – pjesëmarrës në të gjitha emisionet kushtuar luftës kundër korrupsionit.

Para se të hyjmë në thelb të analizës, dëshirojmë të ndalemi edhe te një aspekt tjetër që mendojmë se do ta lehtësojë leximin e këtij materiali.

Tematika e luftës antikorrupsion në media, veçanërisht në median televizive nuk mund të kapet ashtu sikurse bëhet në fusha të tjera të veprimtarisë intelektuale apo administrative.

Në një gjykatë fjala vjen, gjykimi i një afere korruptive bëhet nëpërmjet ballafaqimit të fakteve dhe vënies së personave përgjegjës përballë kërkesave të ligjit. Strategjitë antikorrupsion në një mjedis tjetër, për shembull në procesin legjislativ marrin forma të tjera. Aty bëhet fjalë për të përpunuar ato norma ligjore që ia ngushtojnë fushën e veprimit veprimtarive korruptive. Kurse në gazetari, veçanërisht në gazetarinë televizive, situata është krejt ndryshe. Aty kemi të bëjmë me një aspekt të dyfishtë. Nga njëra anë gazetari duhet të mbajë parasysh sferën ku është strukturuar veprimtaria antikorrupsion që trajtohet në emision apo në shkrim. Nga ana tjetër i duhet të tregohet shumë i kujdesshëm, sepse në televizion trajtimi i

çështjeve antikorrupsion duhet të lidhet me informacionin e ditës, me problemet e aktualitetit, me shqetësimet e përditshme të shoqërisë dhe të vetë audiencës, me ngjarjet e vrullshme që ndodhin.

Televizioni nuk është aspak një klasë shkolle ku u mësohet dhe shpjegohet fëmijëve se çfarë është një dukuri e caktuar në mënyrë akademike. Gazetaria televizive kërkon që trajtimet të vendosen in situ, pra brenda një konteksti të caktuar kohor, brenda një radhe konkrete ngjarjesh dhe mbi të gjitha, të pleksura me një informacion të bollshëm faktologjik. E gjitha kjo ka bërë që të jemi të kujdesshëm për të bërë që të gjitha këto anë të mos shkëputem nga njëra-tjetra, sepse po të ndodhte kështu, atëherë ky dokument do t'i ngjante më shumë një leksioni, që sado i mirë të ishte, nuk do të kishte të bënte fare me atë që ka ndodhur realisht në studio.

SA E PENGON SJELLJEN POLITIKE KORRUPTIVE LIGJI ELEKTORAL?

Periodha që kap fundin e vitit 2000 dhe muajt e parë të vitit 2007 përfaqëson një moment të veçantë në jetën politike dhe shoqërore të vendit. Përgatiten zgjedhjet e reja për pushtetin lokal. Këto zgjedhje marrin në këtë kohë një rëndësi të posaçme për disa arsye.

Së pari, Partia Demokratike dhe aleatët e saj kërkojnë ta ripërsërisin fitoren në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2005. Nëpërmjet një fitoreje të mundshme koalicioni i partive në pushtet kërkon të legjitimojë (certifikojë) me votë elektorale atë që e quan drejtësi dhe sukses të reformave të marra dhe që kanë të bëjnë ngushtë edhe me strategjinë antikorrupsion të cilën qeveria "Berisha" e ka vendosur në themel të veprimit të vet politik, të reformës administrative dhe institucionale.

Së dyti, edhe opozita, domethënë partitë e krahut të majtë janë të vendosura për fitore. Sipas tyre, koalicioni qeverisës përgjatë këtyre dy vjetëve i ka zhgënjyer shqiptarët, ndërsa lufta kundër korrupsionit është kthyer thjesht në një parullë ideologjike të kapërcyer nga koha, një propagandë e mbështetur vetëm në fjalë.

Së treti, lufta politike arrin kulmin për shkak se kryetari i sapozgjedhur i Partisë Socialiste, Edi Rama, ndodhet personalisht i ndërfitur në një garë elektorale për Bashkinë e Tiranës me kandidatin

e Partisë Demokratike dhe të aleatëve të saj, Sokol Olldashin.

Mbi këtë bazë, marrëdhënia midis ligjit elektoral dhe sjelljes elektorale të aktorëve politikë bëhet një nga çështjet më të debatuar në media dhe në opinionin publik të vendit. Duke filluar nga mesi i dhjetorit deri në javët e para të janarit, një bllokim institucional gati sa nuk çon në kolaps procedurën demokratike të zgjedhjeve pasi partitë politike nuk bien dakord për datën e zgjedhjeve si edhe për kushtet që duhet të përmbushë ligjërish procedura e identifikimit të çdo zgjedhësi përpara se ai ta hedhë votën e tij në kutinë e votimit. Partitë e koalicionit qeverisës si dhe qeveria argumentojnë se zgjedhësi mjafton të identifikohet me anë të certifikatave të vjetra, kurse opozita kërkon siguri të tjera, që sipas saj do t'u presin rrugën manipulimeve gjatë votimit dhe numërimit të votave. Pikërisht atëherë kur përditë e më tepër bëhej e pamundur përgatitja e një infrastrukture zgjedhore, e cila do të garantonte standardet e pretenduara edhe nga faktori ndërkombëtar kryhen zgjedhjet lokale të 18 shkurtit 2007, të cilat konfirmojnë fitoren e opozitës në Bashkinë e Tiranës si dhe në pjesën më të madhe të bashkive në qendrat më të mëdha urbane të vendit, me përjashtim të Shkodrës, dhe një fitore të Partisë Demokratike dhe të aleatëve të saj në pjesën më të madhe të komunave që mbulojnë administrativisht zona të gjera rurale të vendit.

Mbi 50 intervista dhe debate kanë përcjellë në publik nga studioja e *Vilës 24* dhe më pas *Studios 24* këtë problematikë kaq komplekse, e cila vuri në një nga provat më të vështira në të gjithë historinë e tranzicionit jo vetëm komunikimin politik mes aktorëve politikë, por edhe procedurën demokratike të zgjedhjeve në Shqipëri.

Standardet zgjedhore dhe korrupsioni

Çdo shmangie nga kuadri normativ i hap rrugën informalitetit dhe për pasojë bëhet burim dukurish korruptive. Nisur prej këtej,

marrëdhënia midis aktorëve politikë në procesin elektoral është kërkuar të mbështetet në një ligj elektoral dhe në procedura elektorale të mirëfillta demokratike dhe sipas kulturës së shtetit ligjor.

Shpallja e dekretit presidencial për të fiksuar si datë zgjedhesh 20 janarin e vitit 2007 nuk pati asnjë vijimësi, sepse ai nuk u zbatua. Partia Socialiste dhe aleatët e saj konsideruan se kjo datë nuk mund të ishte e përshtatshme për arsye se ende nuk ishin krijuar ato kushte juridike dhe administrative për të organizuar zgjedhje korrekte dhe të ndershme. Opozita po linte të kuptohej se nuk do të mernte pjesë në zgjedhje.

20 janari po afronte.

Konsensusi i bazuar në ligj

Në këtë kontekst, në emisionin Vila 24 të datës 12 janar 2007 vjen si i ftuar Kristaq Kume të cilin e paraqes si ish-kryetar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në të vërtetë ai është edhe drejtor ekzekutiv i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve. Pra, një aktor i njohur i shoqërisë civile.

Negociatat midis partive politike rivale kanë ngrirë në atë mes dimri. Pyetja që të vjen natyrshëm ndër mend është: Kush e ka fajin?

Kristaq Kume është një specialist i zoti i fushës. Jurist me përvojë në këtë lëmë. Tani duhet të japë edhe gjykime politike. Kontributi i tij në media për të bërë publike mendimet e shoqërisë civile është i padyshimtë. Pak a shumë gjykimi i tij është si më poshtë: Kjo situatë e bllokuar politike lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve dhe hartimin e aprovimin e një Kodi Zgjedhor të saktë është produkt i klasës sonë politike, e cila nuk ka arritur të kuptojë ndryshimet që kanë ndodhur pas 3 korrikut 2005.

Ideja është e saktë dhe e plotë, por ndoshta telespektatori i

pavëmendshëm, ose pa përvojën dhe formimin e duhur profesional herë-herë mbase nuk e kupton në thellësi.

Mbase nuk e ka kuptuar se çfarë do të thotë se "kanë ndodhur ndryshime pas 3 korrikut 2007". Dhe përfaqësuesi i shoqërisë civile shpjegon se Kodi Zgjedhor është, si të thuash, një ligj që përcakton rregullat e lojës. Garistët, shprehet ai, duke përdorur një metaforë sportive, duhet të hyjnë në garë në kushte të barabarta. Për këtë gjë duhet konsensus.

Gjuha e tij është shumë e kujdesshme. Ai nuk bën fajtor në mënyrë të dukshme asnjërin nga forcat politike kundërshtarë. Sidoqoftë le të nënkuptohet shumë. Sipas tij, duhen së paku 84 vota që ligji i zgjedhjeve të ndryshojë. Shumica e dikurshme socialiste përgjatë legjislaturës së mëparshme, pra para 3 korrikut 2005, i kishte këto vota, mund t'i bënte ato, kurse e sotmja nuk i ka. Ajo është e detyruar të plotësojë kërkesat e opozitës. Duket sikur përgjegjësia i lihet shumicës, por nuk është kështu. Gjithçka është e peshuar dhe e ekuilibruar. Sepse Kristaq Kume thekson se herë pas here shumica parlamentare bën lëshime, por opozita politike duke e ditur se pa pëlqimin e saj Kodi i ri Zgjedhor nuk mund të hyjë në fuqi, sapo merr një lëshim, nis e kërkon një tjetër.

Përfaqësuesi i shoqërisë civile është në rolin që shoqëria civile duhet të luajë shpesh, në atë të një arbitri të paanshëm, që vë në dukje gabimet e secilit lojtar në fushën e ndeshjes politike.

Për teleshikuesin dhe opinionin publik në përgjithësi është e domosdoshme që një arbitër i tillë i paanshëm të ekzistojë. Përndryshe shpesh nuk kuptohet asgjë. Secila palë politike hedh akuza ndaj tjetrës duke lavdëruar qëndrimin e vet. Telespektatori nuk e ka të lehtë të ndajë shapin nga sheqeri. Kristaq Kume është krejt i paanshëm dhe nxit që secila palë të reflektojë. Ai e kupton shumicën parlamentare, kur kërkon që të mbahet 20 janari si datë e zgjedhjeve të ardhshme. Fundja është një datë e përcaktuar nga dekreti presidencial dhe qeveria apo shumica qeverisëse nuk ka

asnjë kompetencë për ta anuluar atë. As e ka propozuar ajo atë datë dhe as e ka në dorë që ta anulojë atë. Ndërkaq edhe opozita kërkon të realizohen dhe të sigurohen disa standarde. Po cilat standarde? Është vështirë që të krijohen standarde si ato perëndimoret, sepse mungojnë shumë kushte. Duhet mbajtur parasysh edhe kushtet politike dhe juridike të vendit, vështirësitë e tij. Fundja edhe më parë janë bërë zgjedhje në këto kushte dhe rezultatet janë njohur si të vlefshme.

Deri ku do të shkojë kërkesa për standarde në këtë luftë nervash?

Kjo është pikëpyetje që ngiti drejtori ekzekutiv i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve atë ditë janari në studio.

Është serioze ndërhyrja e tij. Duket si një krizë pa zgjidhje. E folura e tij është në përputhje me gjendjen që duket e pashpresë. Është si një thirrje për të dalë nga bataku ku kanë ngecur të dy palët. Zëri i tij është i qetë. Asnjë eksces tingullor. Edhe fytyra duket e vrenjtur. Gjithçka është në përputhje me mesazhin që përçohet. Është ora e vetëpërmbytjes së madhe përpara se të mos ndodhë e keqja e pariparueshme, kapërcimi i afatit ligjor të mbajtjes së zgjedhjeve. Të mos ndodhë drama e nxjerrjes jashtë legjitimitetit ligjor dhe administrativ e pushtetit lokal.

Dy divanet

Emisioni *Vila 24*, sikurse është vënë tashmë në dukje, ndërtohet si një intervistë me një të ftuar të cilin aktualiteti e ka nxjerrë në pah për të thënë diçka të rëndësishme për publikun. Ndonjëherë ndodh që të jenë edhe dy të ftuar, por rrallë. Ora e këtij emisioni shpesh ka lëvizur dhe kjo ka sjellë një zhdërvjelltësi dhe mundësi më të mëdha për t'iu përgjigjur aktualitetit në çastin që ai ndodh. Por duhet thënë se u përgjigjet më mirë dhe lehtë edhe disponibiliteteve kohore të të ftuarve.

Sigla e emisionit është krejt e veçantë. Mbi një ekran të zi lëvizin silueta njerëzish në ngjyrë të verdhë. Plane që ndërpriten dhe në lëvizje. Dikush nga figurat paraqet dikë që lexon një gazetë, dikush bën një veprim tjetër. Krijohet ideja se është njeriu në jetën e tij të përditshme në lidhje me mediat që paraqitet. Është një lloj simbolizimi i opinionit publik dhe i komunikimit të tij me veten dhe mediat. Ndërkaq pak pjerrtas shkruhet po me ngjyrë të verdhë dhe germa të mëdha: AKTUALITET.

Janë dy divane që formojnë një kënd të drejtë midis tyre, të cilët shihen në ekran. Në njërin qëndrojnë unë, ndërsa në tjetrin i ftuari. Të dy në cep të secilit divan. Secili në këndin ku njëri divan puqet me tjetrin. Afër e afër. Në këtë mënyrë krijohet një hapësirë intime. Duket sikur jemi jo në një studio televizive, por në një mjedis shtëpie. Pamja e studios krijon një ambient të ngrohtë. Ai plotësohet edhe për faktin se duke qenë afër e afër, gazetari dhe i ftuari i tij flasin qetë dhe me zë paksa të shtruar. Fakti që pjesa tjetër e secilit divan qëndron pothuajse bosh, bën që të dalë edhe më në pah fakti se gazetari dhe i ftuari i tij janë në një takim *tête à tête*, çka rrit bindshëm besueshmërinë e emisionit të lexuesi.

Divanet të sjellin ndër mend kabinetet e psikanalizës.

Cili kërkon të bëjë psikanalizën e tjetrit?

Shpesh emisioni është transmetuar në orët e para të mëngjesit. Edhe të ftuarit duken ende si të përgjumur. Ndonjëherë kjo dallohet te sytë paksa të fryrë. Tualeti i zonjave është krejt i paprishur, i freskët, fjalët nganjëherë mezi dalin, ndërsa fytyrat nuk e kanë atë stresin që vjen nga lodhja dhe intensiteti i marrëdhënieve që krijohen në një qytet kaotik si Tirana. Gazetari bën pyetjet e tij dhe i ftuari përgjigjet. I duhet nxjerrë vërtet ajo që mendon. Përtej ngurrimeve, njëfarë kujdesi të tepërt për të ruajtur paanësinë, sidomos kur është fjala për të intervistuar një përfaqësues të shoqërisë civile. Ndërsa në lidhje me një politikan, ka vend të bëhen pyetje që ai të ketë mundësinë të vërë njëfarë pikëpyetjeje dhe ta bëjë paksa relative bindjen e vet.

I duhet shërbyer qytetarit që kërkon të dijë se çfarë ka pas një lloj egocentrizmi të atij që flet dhe që në njëfarë mënyre është i pashmangshëm.

“Shqiptarët e hanë mirë politikën”

Biseda me Kristaq Kumen rrjedh qetë edhe për arsyen e thjeshtë se i intervistuari është shumë i kujdesshëm në prononcimet e veta. Konsulenti shkencor i këtij projekti, profesor Artan Fuga është i mendimit se kjo ndodh edhe me të intervistuar të tjerë që vijnë nga radhët e shoqërisë civile. Sigurisht, pohon ai, jo me të gjithë, por sidoqoftë ka përshtypjen se ndodh me shumicën.

Veç kujdesit që kanë përfaqësuesit e shoqërisë civile për të mos rënë në njëanshmëri politike dhe për të mos adaptuar një këndshikim partiak dhe partizan, ka edhe arsye të tjera që e shpjegojnë këtë kujdes. Organizatat joqeveritare nuk e kanë forcën dhe prapavijat organizative, materiale, financiare dhe njerëzore të partive politike. Kjo shpjegon deri në njëfarë mase se përse partitë politike janë përgjithësisht të ashpra në qëndrimet që mbajnë ndaj njëra-tjetrës për probleme të ndryshme, kurse drejtuesit e organizatave joqeveritare janë shumë herë më të kujdesshëm.

Presioni i politikës mbi ta është më i fuqishëm dhe ata mund ta përballojnë këtë vetëm me forcën e tyre të karakterit.

Radhët e anëtarësisë së tyre janë fare të kufizuara dhe të rralla.

Deputeti – politikan është i imunizuar nga përndjekja e ligjit, kurse përfaqësuesi i shoqërisë civile nuk ka asnjë mbrojtje të tillë. Shumë politikanë kryesorë, ministra e ish-ministra, kanë roje dhe mjete sigurie, kurse përfaqësuesi i shoqërisë civile është shumë herë më i kujdesshëm, sepse e kupton se atij i duhet t’i bëjë ballë të gjitha sfidave që parakupton iniciativa për të artikuluar një zë të pavarur në sferën publike.

Në jetën e tij personale përfaqësuesi i shoqërisë civile ka një mijë varësi nga shteti, administrata dhe politika që e drejton atë. Shpeshherë edhe karriera e tij politike dhe profesionale do të varet nga po ata vendimmarrës politikanë, të cilëve duhet t'u rezistojë si përfaqësues i opinionit publik.

Profesori Artan Fuga është i mendimit se në atë emision jam treguar disi i ashpër me të ftuarin tim, ndonëse nuk e vë në dyshim se i kam respektuar dhe kam treguar nderim për arsyetimet e tij.

Kur i ftuari shpjegon idenë e tij racionale se klasa politike nuk e ka kuptuar se nuk mund të sillet më sikurse sillej përpara 3 korrikut, pyetja ime kërkon sqarimin:

"Pra, ju i drejtoheni më shumë mazhorancës e cila sillet sikur t'i kishte 84 votat për ta aprovuar e vetme Kodin Zgjedhor?"

Pyetja bëhet konkretisht dhe qartëson atë që i ftuari e kishte thënë në mënyrë delikate.

Kristaq Kume përshkruan në mënyrë teorike marrëdhënien e krijuar midis shumicës parlamentare dhe opozitës, kur është fjala se sa herë shumica bën lëshime, opozita paraqet kërkesa të tjera, çka sjell një situatë që i ngjan asaj kur secili "kërkon të duket më i fortë se tjetri".

Gjej rastin për ta bërë të kuptueshme në mënyrë të përmbledhur këtë shpjegim krejt të drejtë.

Them:

Pra, secili kërkon të tregojë «muskujt politikë».

Dëshira për të qenë konkret është pjesë e subjektit të gazetarit, prandaj dhe gjeta rastin të theksoj:

Kërkoj arsye materialisht të prekshme, të perceptueshme nga shqisat.

Në fakt, gazetarit këtë nuk ia kërkon shija e tij, por ia kërkon mjeshtëria, ia kërkon audienca e tij, përndryshe ajo largohet nga ekrani. Këtu, zanati i gazetarit, pritshmëritë e audiencës dhe njëfarë artikulumit i ligjërimit bërë prej përfaqësuesve të shoqërisë civile hyjnë në një kontradiktë, ose midis tyre krijohet një lloj tensioni.

Audienca i kërkon gazetarit të jetë i qartë, konkret, provokues, të nxjerrë anët e fshehta të marrëdhënieve politike. Votuesi i ardhshëm do të dijë se kush ka të drejtë dhe kush nuk ka, kërkon të merret një anë e caktuar. Kurse përfaqësuesi i shoqërisë civile nuk ka përse ta ketë këtë shqetësim. Ai e di se gazetari po e shtyn disi me përdhunë drejt konkretësisë dhe gjuhës së zhveshur nga çfarëdolloj përkujdesjeje maturie, por ai nuk është gjithmonë gati ta ndjekë këtë pistë. Dhe ka të drejtë.

Nga njëra anë, ai është i shtrënguar t'u bindet presioneve të gazetarit, sepse e di që është gazetari ai që ia jep ose ia merr kohën televizive. Çdo gazetar e ka pothuajse në dorë që t'ia mbyllë apo t'ia hapë derën e televizionit të vet një të ftuari nga shoqëria civile. Por, ky i fundit është edhe i detyruar të ndjekë vijën e vet strategjike të një përkujdesjeje për t'í thënë gjërat në mënyrë të paanshme dhe disa herë në një kuadër të përgjithshëm.

Debati i çasteve të fundit me Kristaq Kumen duket si një shembull ilustrues i njëfarë tensioni midis gazetarit dhe përfaqësuesit të shoqërisë civile.

I ftuari lë të nënkuptohet se debati midis forcave politike lidhur me plotësimin e standardeve që Kodi Zgjedhor duhet të realizojë nuk është thjesht një përpjekje për të stabilizuar një kuadër ligjor të besueshëm dhe që përjashton sjelljen elektorale informale, manipulimet, korrupsionin politik, por përbën më tepër një lloj synimi për t'iu imponuar palës kundërshtare.

Ndërkohë ndërhyj:

Pra, ju po thoni se mirëqenia e liderit është (duhet kuptuar) si mirëqenie e shoqërisë. Këtë po thoni?

I ftuari përgjigjet përsëri me delikatesë:

Është për të ardhur keq, nëse do të ishte vërtet kështu.

Gazetari: A ka kuptim kjo që po themi ... «Shqiptarët e hanë mirë politikën, e kanë ushqim të përditshëm.»

Politika dhe administrata

«Keni marrë mandatet tona, zhvilloni përgjegjësitë tuaja!»

Sipas profesor Artan Fugës, problemet që ngre Kristaq Kume lidhur me infrastrukturën ligjore të zgjedhjeve janë të rëndësishme dhe kapitale. Ato tregojnë rëndësinë e integritit në debatin shoqëror të konsideratave të prejardhura nga bota e profesionalizmit.

Është e pamohueshme, sikurse e tregojnë edhe seancat e emisioneve të *Vilës 24* dhe *Studios 24* (janë rreth 30 intervista dhe debate me përfaqësues të shoqërisë civile dhe politike të realizuara në këto dy emisione televizive mbi këtë argument, shih shtojcën 1), se organizata joqeveritare dhe jofitimprurëse mbajnë në vetvete kapacitete të fuqishme intelektuale, pra kërkues shkencorë, pedagogë, individë me një përvojë të madhe teorike dhe praktike.

Në njëfarë mënyre të ky kontingjent njerëzor qëndron forca e tyre emancipuese, por edhe kufizimet që ata kanë.

Shoqëria civile në Shqipëri është e strukturuar më shumë sipas organizatave joqeveritare dhe jo aq shumë sipas grupeve të interesit. Grupet e interesit tani sapo kanë hyrë në fazën e konsolidimit të profilit të tyre, duke grumbulluar vetëdije lidhur me ndikimin specifik që mund të ushtrojnë në procesin e votimit apo të vendimmarrjes politike. Sa i takon shoqërisë civile, forca e tyre numerike është relativisht e vogël dhe ka pak peshë në procesin e votimit. Edhe fuqia e tyre për të ushtruar presion më shumë mbështetet te forca e argumentit dhe më pak te një vullnet politik masiv që grumbullon masa të gjera njerëzish.

Në emisionin *Vila 24* të ditës së mërkurë, datë 20 dhjetor 2007, të transmetuar drejtpërdrejt pak minuta pas orës 13 të drekës, kanë qenë të ftuar sërisht Kristaq Kume dhe Greta Meta si drejtore ekzekutive e Shoqatës për Kulturë Demokratike, për të folur përsëri

për krizën politike lidhur me datën, standardet e zgjedhjeve dhe përpilimin e Kodit Zgjedhor.

Konteksti në të cilin zhvillohet intervista është aktual, në funksion të lajmeve dhe të ngjarjeve të ditës duke i dhënë një freski axhendës së diskutimit mediatic.

Të dy të ftuarit e radhës janë në studio, sepse ata sapo kanë dalë nga një konferencë shtypi dhënë në emër të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë në ambientet e "Hotel Tirana International".

Gerta Meta sqaron se ka një lidhje midis këtij koalicioni dhe problemit të krizës politike që pengon procesin e hartimit të Kodit të ri Zgjedhor dhe organizimin e zgjedhjeve lokale. Sipas Gerta Metës, shoqatat që bëjnë pjesë në koalicion përfaqësojnë të gjithë shoqërinë civile, prandaj për to nuk janë të huaja edhe çështjet e zgjedhjeve lokale.

Këtë radhë të dy të ftuarit vijnë nga një deklaram publik. Ata u janë drejtuar politikanëve me thirrjen:

«Ju që keni marrë mandatet tona, zhvilloni përgjegjësitë tuaja!»

Në njëfarë kuptimi shoqëria civile vendoset kështu në rolin e një pale që kërkon respektimin e një kontrate të pashkruar midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të politikës.

Gazetari pyet: - Zonja Meta, ose më mirë Gerta, të flasim më nga afër me emër ... - e theksoj këtë afërsi për t'i krijuar një mjedis sa më të ngrohtë.

- Po Gerti ..., - e pranon propozimin e ftuara.

Gerta Meta nis e trajton çështjen për të cilën është ftuar. Në një çast të caktuar, duke iu referuar të ftuarit tjetër, ajo i drejtohet atij si «Profesor Kristaqi». Kështu marrëdhëniet midis një gazetari dhe të ftuarit nga shoqëria civile, si edhe midis dy të ftuarve transformohen dhe bartin edhe përmasa të tjera marrëdhëniesh. Pra, humb barazia që gazetari duhet medoemos të vendosë me të ftuarin e tij, me qëllim që biseda të ecë mbarë.

Kaq është Shqipëria.

Një shoqëri ku pothuajse të gjithë e njohin njëri-tjetrin. Shtohet marrëdhënia miqësore midis gazetarit dhe të ftuarve nga njëra anë. Nga ana tjetër vendoset një marrëdhënie profesor – studente midis dy të ftuarve. E gjithë kjo konjunkturë marrëdhëniesh të shumëfishta nxit vendosjen e një fryme besimi midis aktivistëve të shoqërisë civile dhe medias televizive. Po edhe njëfarë tensioni midis të gjitha palëve, ndoshta, do të ishte edhe ai i mirëpritur.

Sidoqoftë, kur në studio ka vetëm përfaqësues të shoqërisë civile, tensioni psikologjik është më i ulët, sesa në rastin kur të pranishëm janë edhe politikanë të të gjithë krahëve.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile kërkojnë një mjedis më konsensual për t'i zhvilluar projekte e tyre, kurse politikanët veprojnë në një mjedis më konfliktual.

Ndërkohë që Kristaq Kume është duke zhvilluar një argument, bie zilja e celularit të tij. I mbetur disi keq ai e mbyll menjëherë, por nuk e lë t'i shpëtojë ky rast.

«E latë celularin hapur. Kam përshtypjen se duhet mbyllur një herë e mirë.” (Tregoj me gisht nga celulari duke aluduar mbi një fushatë të ndërmarrë në verë të 2006-ës nga ACAC me sloganin «Celulari dëmton rëndë xhepin”, në të cilën Kristaq Kume dhe unë kemi qenë aktivë si anëtarë të bordit drejtues të ACAC-së.)

E pyes: - U mbyll një herë e mirë?

- Po – përgjigjet i ftuari im i sjellshëm dhe simpatik.

- Është fleksibiliteti i *Vilës 24*, këtij institucioni mediatik, - vijoj ta çoj deri në fund përdorimin e detajit që m'u krijua krejt rastësisht - që në fakt ...(Pasi e ndërpres këtu, konstatoj se koha po ikën në mënyrë marramendëse, prandaj me vërtik tentoj të kthehem te tema e lënë për gjysmë).

- Ne vijmë, - nis të them, por i ftuari më ndërpret; ka të tijën ai, duke vazhduar refleksionin për zilen e telefonit.

I ftuari nis të thotë:

- Atëherë ne vijmë sikur të ishim në shtëpi, në shtëpi e mbajmë

celularin hapur, kështu që ...

Dhe unë detyrohem të përsëris:

- Sikur jemi në shtëpi, sigurisht.

Kolltuku bosh

Nga bisedat e bëra në studio, në kuadrin e emisionit *Studio 24*, ndër më të gjallat ka mbetur pa dyshim ajo kur të ftuarit e mi ishin Nard Ndoka, Skënder Gjinushi dhe Erion Braçe. Prisja të vinte edhe deputeti Preç Zogaj, por ai më lajmëron në minutën e fundit se ishte vonuar në fushatën elektorale për zgjedhjet e pushtetit vendor në zonën e tij elektorale.

Ishte vonë. Mendova një herë ta heq njërin nga kolltukët, por nuk ishte punë që bëhej. Simetria e studios prishej krejt. Do të më duhej pastaj të ndryshoja gjithë pozicionin e kolltukëve ku do të uleshin të ftuarit e emisionit. Ishte e vështirë, pothuajse e pamundur. Edhe koha nuk premtonte aspak. Ndërkohë shpresoja se i ftuari që mungonte mund edhe të vinte në mes të emisionit. Më në fund, më shkrepri një ide. Pamundësinë për të ndryshuar diçka ta ktheja në një gjetje televizive. Dhe aty me lindi ideja për ta lënë kolltukun bosh.

Sidoqoftë nuk ma merrte mendja se gjatë emisionit ai boshllëk do të kthehej në një gjetje, ku të ftuarit do të ndaleshin shumë.

I ftuari, kur është inteligjent, atë që ka mangësi apo avantazh çdo detaj i emisionit, e përdor në të mirë të tij. E çfarë mund të bëjë në këtë rast gazetari, kur ndodhet në transmetim të drejtpërdrejtë? Pothuajse asgjë, veçse ta moderojë, ta zbusë, ta bëjë sa më profesionale atë që ndodh jashtë kontrollit të tij.

Erion Braçe dhe Skënder Gjinushi e transformojnë atë që thashë dhe shprehen se pritej dhe nuk kishte ardhur Lefter Xhuveli, ministër i Mjedisit në qeverinë "Berisha", kryetar i Partisë Agraro-ambientaliste. Duket se e kanë merak të ballafaqohen me të, por rastin nuk e kanë.

Ai mungon.

Teleshikuesi sigurisht nuk e ka kuptuar mirë nëse pritej Preç Zogaj sikurse lajmërova unë, apo Lefter Xhuveli sikurse thanë të ftuarit.

Kolltuku fliste, por edhe heshtte me boshllëkun e tij.

E kishin të fiksuar të merreshin me Lefter Xhuvelin dhe unë e kuptoja se përse.

Kishin qenë dikur në aleancë politike qeverisëse, kur vendin e administronte qeveria e Fatos Nanos. Pas 3 korrikut 2005, ndërkohë që formohet një shumicë tjetër qeverisëse dhe socialistët me aleatët e tyre kalojnë në opozitë, Lufter Xhuveli ndërron në të drejtë të tij kamp politik dhe rifutet në qeverinë e kundërshtarëve të tij politikë të dikurshëm. Edhe Nard Ndoka nuk është shumë i dashur me të, ndonëse supozohet se bën pjesë tashmë në të njëjtën aleancë politike. Është ende i pakënaqur, sepse nuk po e merr një post ministror, ndërkohë që Lufter Xhuveli e ka një të tillë. Nard Ndoka ka nevojë të hapë vende të reja vakante ministrorë. Lufter Xhuveli, dikur i sulmuar nga Sali Berisha për korrupsion ka një post ministror, kurse Nard Ndoka nuk e ka një të tillë. Lufta politike i njeh këto rivalitete sikurse të tjera.

Skënder Gjinushi dhe Erion Braçe tregojnë me gisht nga kolltuku bosh, a thua sikur aty të kishte njeri. Edhe Nard Ndoka hyn në këtë marrëdhënie gjestikulacioni. Të parët në një çast i thonë të dytit se nuk kanë ardhur fare për të debatuar me të, por për t'i thënë nja dy fjalë publikisht ish-aleatit dhe mikut të tyre politik. Disa herë e ndërpres emisionin për të transmetuar reklama. Në këto raste hapësira publicitare është shpëtimtare. Të bëjmë detyrimin tonë, them, por në fakt është edhe një mjet për ta ftohur pak atmosferën e emisionit.

- Ku është ai? – pyet Erion Braçe. - Apo te ndërmarrja e tij e gomave që ndot edhe ambientin? – artikulon pak a shumë.

- E ka çuar lopën te PD-ja, se është mësuar me lopë ai, - luan me fjalë Skënder Gjinushi.

Biseda vazhdon vullshëm. Nard Ndoka tregon se në kohën e qeverisjes socialiste korrupsioni ishte kthyer në sistem. Ndërkohë, vazhdon ai, qeverisja aktuale, po bën çmos dhe po merr të gjitha masat për ta luftuar atë. Janë shënuar arritje të rëndësishme në dogana, në polici, në arsim, nëpër dikastere. Ministrat nuk janë më të përfolur për korrupsion.

E gjitha kjo sigurisht nuk u shkon për shtat të dy të ftuarve të tjerë. Akuzës për korrupsion i përgjigjen flakë për flakë. Për një kohë të gjatë është e pamundur të ndërhyj.

Erion Braçe nis t'i drejtohet Nard Ndokës në një mënyrë që do të vinte në siklet edhe më gjakftohtët. Përmbajtja e ligjërimit të tij është shumë e ashpër, kurse forma me anë të së cilës ai i drejtohet rivalit të vet politik është shumë miqësore. Pas çdo shprehjeje të artikuluar në formë pyetjeje, ai nis një tjetër, pa pushim. Është e pamundur të ndalohet, megjithëse përpjekjet për ta ndërprerë nga ana e moderatorit shtohet, pasi fjala duhet shpërndarë pothuajse njësoj nga pikëpamja kohore të të gjithë të ftuarit. Para çdo shprehjeje Erion Braçe vendos fjalët miqësore e që tregojnë afërsi humane brenda distancës politike që i ndan: «O Nardi!»

Duket sikur i drejtohet një shoku a miku të afërt. Nard Ndoka nuk e ndërpret. Ndoshta gjykon se i ka thënë tashmë fjalët e tij. Ndoshta e respekton tjetrin, kur ka radhën për të folur.

Erion Braçe ndjek taktikën e kundërakuzës për korrupsion drejtuar administratës aktuale dhe ndaj vetë kryetarit të qeverisë.

U tha se nuk do të kishte tenderime të drejtpërdrejta, por tenderime të tilla po bëhen shumë. Për familjen e tij, vazhdon Erion Braçe, nuk pranoi hetim për pasuri shumë herë më të mëdha, kurse të tjerët i ka çuar në hetim. Berisha, hidhet në kundërsulm Erion Braçe, në '94, '95, '96 theu embargon, nuk punoi për këtë ditë fitoreje për Kosovën. Ai del dhe e pranon vetë këtë. Nuk gjobiten televizione që tani bëjnë «krim elektoral». Kush është ndëshkuar për humbjet e KESH-it? – vazhdon Erion Braçe duke e shoqëruar edhe

me lëvizje elegante të duarve fjalën e tij.

Në njërin gisht i dallohet një unazë me gur të madh, e cila bën kontrast me shije me gishtat e tij të hollë.

Vendimi i qeverisë, (O Nardi!) kundër nepotizmit nuk është zbatuar për familjen e kryeministrit.

A ka konflikt më të madh interesi (O Nardi!), kur kryeministri është pronar (!!!) i portit të Durrësit, kunati i tij është anëtar i këshillit administrativ të portit?

Këtu nuk po e riprodhohj të gjithë këtë ligjërim të gjatë dhe të gjallë. Ajo që dalloja ishte se akuzës për korrupsion të formuluar nga goja dhe pena e përfaqësuesve të shumicës parlamentare, opozita po i përgjigjej me një akuzë përsëri për korrupsion, këtë radhë drejtuar simetrikisht akuzuesve të saj.

Profesor Artan Fuga ka mendimin se termi «korrupsion» deri tani nuk është përkthyer në ndonjë realitet të prekshëm, por ka qenë vetëm një fjali me të cilën shprehet gjuha e sotme politike.

Ku janë të korruptuarit të shënjuar si të tillë nga drejtësia?

Ku u bë korrupsioni dhe si vërtetohet ai me fakte?

Skënder Gjinushi shprehet përgjatë emisionit se vjedhësit e vegjël dënohen, kurse ata të mëdhenjtë zënë ndonjë vend në ndërtesat e bulevardit «Dëshmorët e Kombit».

Nuk ka kohë të ndalem këtu dhe ta pyes nëse e ka fjalën për tani, apo për gjithë kohërat.

Ritmi i bisedës është shumë i shpejtë.

Duke u mbështetur te filozofia e veprimit me anë të fjalëve, Xhon Searl, apo edhe te filozofia neopragmatike amerikane, sidomos te Riçard Rorty, profesor Artan Fuga më thotë se kur një fjalë nuk shoqërohet sa duhet me një përmbajtje reale konkrete, por mbetet disi flu dhe e vagëlluar, përsëri ajo ka një realitet tjetër dhe një dobi tjetër shoqërore. Ajo është një fjalë pa objekt, por asnjëherë nuk ka një lidhje korrespondence mekanike midis një fjale dhe një objekti. Sikurse nuk ka një lidhje mistike midis një njeriu dhe emrit me të

cilin e kanë quajtur dhe ne e thërrasim. Në këtë rast fjala është një mjet komunikimi, bosh, vetëm kaq, por si e tillë ajo ka një rol shumë të madh në jetën shoqërore, sepse bëhet një shtyllë e fuqishme e të folurit shoqëror.

Ka pasur rende të tëra shoqërore, sisteme të tëra politike, të cilat janë mbështetur te ideologjia fetare, te teologjia. Por asnjeri nuk e provon dhe nuk e ka provuar dot nëse fjala «Zot» ka përmbajtje reale, apo është një shpikje e njeriut. Por kjo nuk ka fare rëndësi, – vazhdon profesor Artan Fuga. Çështja është gjetiu. Fjala «Zot» ishte një lloj fjale e pranuar në njëfarë mënyre me anë të një kontrate gjuhësore të futur në veprim në mënyrë spontane dhe të pakuptuar, me anë të përsëritjes, ose të forcës, me anë të propagandës dhe të edukimit.

Kështu edhe fjala «korrupsion».

Nuk është se nuk ka korrupsion real. Puna është se në politikë ajo është kthyer në një kontratë gjuhësore e të folurit të përditshëm dhe ka zëvendësuar të gjitha të tjerat. I ka shtyrë fjalët e tjera jashtë dhe përtej, sikurse themi ne në filozofi, fushës semantike dhe simbolike të gjuhës. Nuk dëgjohen fjalë të tjera çelës, sepse gjithë struktura e të folurit politik mbështetet në pak fjalë e midis tyre në fjalën kyç «korrupsion». Fjala «korrupsion» është si fjala «Zot» dikur në Mesjetë. E vlefshme për të folurit politik, për të ndërtuar strategji politike, për të ndërtuar shtet, për t’u pasuruar, për të hyrë në Europë, për të kompaktësuar trupën e militantëve, nëpunësve dhe deputetëve, për t’u kuptuar, për të mos u kuptuar, për të shkuar në zgjedhje, për të tërhequr elektoratin në votime, për të bërë marrëveshje me rivalët dhe aleatët në minutën e fundit, për të zgjedhur presidentin konsensual, për gjithçka.

Ajo është një fjalë magjike.

Ajo është fjala-çelës e ligjërimeve politike. «Ti je i korruptuar.»
«Jo. Je ti ai që është i korruptuar.»

Unë jam i korruptuar.

Ti je i korruptuar.

Ai është i korruptuar.

Ne jemi të korruptuar.

Ju jeni të korruptuar.

Ata janë të korruptuar.

Gjithçka aty rrotullohet. Nuk është e rastit që kjo fjalë vendoset në qendër të të folurit politik dhe përpiket të legjitimojë praktika politike.

Pikësëpari, në realitet dukuritë e korrupsionit janë të shtrira gjithandej. Pastaj fjala «korrupsion» është shumë bazike.

“I korruptuar” është njëfarë ekuivalenti me fjalën «hajdut» ose «vjedhajdut» që fëmijët kanë qejf ta përdorin qysh në moshë të njomë, kur grinden dhe shajnë, apo luajnë me njëri-tjetrin. Është e thjeshtë fare dhe me shumë përdorime si ata robotët japonezë, që mund të përdoren si për të drejtuar avionët, ashtu edhe për t’u shërbyer pensionistëve.

Si fjala «degjenerim». Edhe kur dikush vonohet në një takim, tjetri nuk mungon t’i thotë «E degjenerove fare!».

Edhe ai që vjen vonë në një takim mund të thirret “i korruptuar”.

Pastaj nuk duhet harruar se është një fjalë që pëlqehet nga shqiptarët dhe i shkon shqipes. Bashkëtingëllorja «rr», e fortë, por edhe që mund të përforcohet edhe më shumë, sa të dojë folësi, tingëllon bukur në veshët e shqiptarit. Përvetësohet shpejt. Sharjet e mëdha në shqip janë gati të gjitha me dy «r». Edhe nëse nuk janë të gjitha, mund të gjenden sinonime «rrërore» të tyre.

Skënder Gjinushi lëshon një fjali gjatë emisionit: «Korrupsioni si kalë beteje».

Megjithatë, informaliteti dhe korrupsioni në të gjitha format e tij është real në shoqërinë e sotme shqiptare. Në 12 intervista me politikanë gjatë programit *Vila 24* dhe në 5 panele debat në programin *Studio 24*, pothuaj të gjithë politikanët e ftuar pyetjes

nëse «korrupsioni ndëshkohet me votë apo me forcën e ligjit» iu përgjigjen «me votë». Përrjashtim bëjnë vetëm Edi Rama, kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe kreu i Partisë Socialiste dhe Sokol Olldashi, kandidati zyrtar i mazhorancës së djathtë për postin e kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Në intervistat e tyre ekskluzive në *Studio 24* gjatë ditëve të fushatës elektorale ata iu përgjigjën së njëjtës pyetje me fjalët «ndëshkohet edhe me votë, edhe me ligj». Përgjithësisht, juristët e ftuar në këto panele debati në *Studio 24* (Kreshnik Spahiu, Genti Imbrahimi, Ilir Panda, Ylli Manjani, Spiro Peçi apo ndonjë tjetër), së njëjtës pyetje i janë përgjigjur pa hezitim se «korrupsioni ndëshkohet me votë».

PUSHTETI LOKAL DHE KORRUPSIONI

Përgjatë periudhës kur janë zhvilluar emisionet, duke qenë një periudhë fushate elektorale dhe zgjedhesh për pushtetin lokal, vend qendror në to ka pasur problemi i funksionimit të pushtetit lokal dhe marrëdhënia midis këtij funksioni dhe korrupsionit. *NEWS24*ka arritur ta trajtojë këtë problem në gjerësinë e vet duke u ndalur në pikat e tij më të nxehta. Parë kështu, në studio janë ftuar protagonistët kryesorë të kësaj fushate zgjedhore, politikanë kryesorë të partive politike kundërshtare, deputetë të angazhuar në fushatat elektorale për zgjedhjen e kryebashkiakëve në qendrat urbane kryesore të vendit, kandidatët për postin e kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Edi Rama për Partinë Socialiste dhe Sokol Olldashi për Partinë Demokratike, si dhe janë ftuar të komunikojnë me ta përfaqësues të shoqërisë civile, pra anëtarë dhe drejtues të disa shoqatave jofitimprurëse, anëtare aktive të koalicionit antikorrupsion.

Në këtë mënyrë, televizioni *NEWS 24* është përpjekur, sidomos nëpërmjet emisionit të vet *Studio 24*, të krijojë një hapësirë publike ku nga njëra anë t'u krijohet mundësia aktorëve politikë të shprehin dhe shpalosin projektet e tyre për pushtetin lokal, t'iu përgjigjen pyetjeve dhe akuzave të ndryshme që qarkullojnë në opinionin

publik për një shkallë të lartë korrupsioni në nivelin e administrimit të pushtetit lokal, si dhe të bëjë të mundur artikulumin mediatic të zërit të aktorëve të shoqërisë civile dhe ballafaqimin e tyre me përfaqësuesit e politikës apo kandidatët për kryetarë bashkish, e gjitha kjo si një paraqitje e tyre përpara një audience të gjerë televizive si pjesë e opinionit publik të vendit.

Sigurisht që gazetari në këto raste detyrohet të jetë i ndërgjegjshëm për dy anë disi kontradiktore. Nga njëra anë ai e di se duhet të përfitojë sa të jetë e mundur nga mundësia që televizioni ku punon i jep për të arritur realizimin e misionit të tij. Në këtë pikë nuk mund të mos thuhet se në këtë rast shansi ka qenë i spikatur dhe duhej përdorur në të mirë të një fushate mediatike kundër korrupsionit dhe për promovimin e projekteve të shoqatave jofitimprurëse në kuadrin e luftës antikorrupsion.

Zgjedhjet për pushtetin lokal e rithërrisnin këtë problematikë duke krijuar mundësinë për ta lidhur atë me një proces dhe ngjarje të ditës.

Por, nga ana tjetër gazetari ka për detyrë të tregohet realist, sepse duhet të pranojë se gjatë rrugës së realizimit të idesë së tij televizive do të ndeshë vështirësi dhe pengesa që vijnë nga burime nga më të ndryshmet, të cilat duhet t'i pranojë si kufizime të natyrës profesionale.

Jo për t'u dorëzuar përpara tyre, por për të mos u ligështuar.

Korrupsioni dhe pasojat e tij ekonomike mbi publikun

Një pjesë e problematikës për të cilën po flasim ka dalë në pah gjatë një seance të emisionit *Studio 24*, datë 7 shkurt 2007, tamam dhjetë ditë përpara ditës së votimeve, e cila u transmetua drejtpërdrejt në orën 21:00, pikërisht atëherë kur supozohet se është audience më e madhe televizive.

Biseda në studio me të ftuarin special të radhës, Sokol Olldashin, zgjati dy orë dhe pati si objekt paraqitjen përpara publikut të ideve dhe projekteve të tij si kandidat për postin e kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Në këtë pozicion, ai sigurisht që pritej të trajtonte në mënyrë shumë kritike edhe nivelin e korrupsionit në përgjithësi dhe veçanërisht në shfaqjet e tij në kuadrin e lokal.

Dy kolltukët

Le të flasim pak për formën e organizimit të emisionit, sidomos për mënyrën e vendosjes së gazetarit dhe të të ftuarit në studio, si dhe për mënyrën e pjesëmarrjes në emision të pjesëtarëve të shoqërisë civile.

Profesor doktor Artan Fuga këmbëngul se sipas teorive bashkëkohore të komunikimit dhe të informimit vendi që zë dhe pozicioni që i propozohet çdo të ftuari në studio nuk është aspak i rastësishëm. Duke iu referuar filozofit të mediave, Pierre Bourdieu, ai thotë se pozicionimi në hapësirë i të ftuarve në studio dëshmon në fakt për një raport të caktuar pushteti midis tyre, tregon një lidhje të caktuar midis tyre, shpreh një hierarki të dhënë, e cila influencon së tepërmi edhe në debatin që zhvillohet në studio.

Në fakt, duke analizuar me kujdes vendndodhjen e çdo të ftuari në studio mund të kuptosh edhe paraprakisht thelbin e bisedës që do të bëhet, qëndrimin që do të mbajnë palët e ndryshme në debatin televiziv, ose së paku përfytyrimin që ka regjia apo edhe vetë gazetari lidhur me mendësinë dhe konceptimet me të cilat priten të vijnë të ftuarit në emision.

Pozicioni në hapësirë i të ftuarve përbën në njëfarë mënyre një lloj parapërgatitje për atë që do të shpaloset në emision.

Forma e vendosjes së njerëzve në studio është e ndryshme

përgjatë seancave ku janë ftuar kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe pastaj rivali i tij për këtë post, kandidati i Partisë Demokratike, Sokol Olldashi. Ajo nuk i ngjan as vendosjes së të ftuarve dhe gazetarit në emisionin *Vila 24*, as vendosjes së tyre në emisione të tjera të programit *Studio 24*.

Në mes të studios janë vendosur dy kolltukë elegantë, jo fort, të gjerë, bash përballë njëri-tjetrit. Ngjyra e tyre është rozë. Për ngjyrën e kolltukëve nuk mund të thuhet sa ndikon ajo në perceptimin që teleshikuesi i bën emisionit. Sidoqoftë, supozon profesor Artan Fuga, kandidati demokrat do të kishte dashur ndoshta që kolltukët të kishin ngjyrën e preferuar të partisë së tij, pra ngjyrën blu.

Dy kolltukët janë vendosur përballë njëri-tjetrit me profil nga kamera. Teleshikuesi percepton pamjen anësore të tyre si dhe të gazetarit dhe të ftuarit të tij në studio. Në fakt, ky pozicionim i jep një shkallë barazie gazetarit me të ftuarin e tij, sado i rëndësishëm qoftë ky në sytë e teleshikuesit. Gjithçka në planin hapësinor është simetrike duke krijuar gjithashtu edhe një përqendrim të dy pjesëmarrësve në intervistë, pra të gazetarit dhe të ftuarit të tij, te njëri-tjetri. Distanca midis tyre nuk është e konsiderueshme në krahasim me këtë lloj distance në emisione të tjera të transmetuara në këtë televizion apo në televizione të tjera. E gjitha kjo ndikon së tepërmi për t'i dhënë bisedës një natyrë më intensive, sepse fraza e secilit shkon te tjetrit dhe kthehet si përgjigje me shpejtësi dhe pa pasur nevojë për të përshkruar simbolikisht një distancë të madhe fizike.

Sokol Olldashi ka një veshje dhe një shprehje fytyre jo fort entuziaste dhe një gjestikulacion duarsh dhe mimike të moderuar e të përmbajtur. Kostumi dhe kollarja e tij kanë pak a shumë të njëjtën ngjyrë në ekran. Nga pikëpamja e ngjyrave ato nuk bëjnë kontrast me njëra-tjetrën.

Ndërsa Edi Rama, kur vjen në emisionin, mban një kollare ku përziehet ngjyra jeshile me një të verdhë të zbehtë.

Të dy kostumet rivalët i kanë me jaka të gjera, gati sikur duket të kenë veshur rroba që imitojnë togat klasike që vishnin sindikët e dikurshëm të kohëve klasike.

Të gjitha palët rrinë këmbë mbi këmbë, ulur në kolltukët e tyre. Këmbë mbi këmbë Sokol Olldashi në emisionin e tij përballë gazetarit, po këmbë mbi këmbë edhe Edi Rama më pas në emisionin e tij përballë gazetarit. Edhe gazetari është i detyruar të mbajë të njëjtin pozicion për të mos qëndruar në një pozicion inferior. Pozicioni këmbë mbi këmbë shpreh pushtet, siguri, vendosmëri, por edhe dëshiron të japë pamjen e një sigurie të brendshme. Duket edhe si një pozicion rehati dhe luksi.

Sokol Olldashi ka një shprehje mimike disi të trishtuar dhe një pamje serioze, që shkon në përputhje me fjalët e tij të cilat shprehin njëfarë revolte ndaj gjendjes urbane në Tiranë, sipas tij në kufijtë e katastrofës.

Nga ana tjetër, kur Edi Rama vjen në studio dhe ndodhet ai tashmë përballë pyetjeve të gazetarit, është më i çlirët, herë pas here buzëqesh nën zë dhe shoqëron edhe me duar fjalët e tij. Në dorë i duket një unazë me një gur të stërmadh. Duket sikur simbolizon futjen e një Tirane në hullitë e qëndrueshmërisë dhe të luksit. Të paktën sipas mendimit të tij.

Në të dy emisionet ndërhyrjet e përfaqësuesve të shoqërisë civile futen në formën e inserteve. Ata kanë të drejtë t'u bëjnë pyetje kandidatëve.

Profesor Artan Fuga thotë se nga njëra anë kemi të bëjmë me një risi televizive, e cila është për t'u përshëndetur. Pa dyshim. Por, shton ai, në njëfarë mënyre përfaqësuesit e shoqërisë civile janë vendosur në një pozicion disi inferior në krahasim me politikanët që vijjnë sipas radhës në të dy emisionet që iu kushtohen. Përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë të drejtën e pyetjes, por duke qenë se janë të regjistruar, ata e kanë vështirë të bëjnë komente rreth përgjigjes që japin të pyeturit. Pra, fjala e fundit u lihet politikanëve. Nga kjo

pikëpamje shfaqet e saktë ideja e Pierre Bourdieu-t, sipas së cilës është gazetari që e kontrollon fjalën e lirë në studio duke qenë ai zoti i shpërndarjes së radhës së të folurit, ndërhyrjeve që bën te njëri a te tjetri, apo te komentet që ndërton pas fjalës së gjithsecilit.

Sidoqoftë duhen mbajtur parasysht - kundërshtoj unë - edhe disa elemente të tjera. Është disi e vështirë që teknikisht të realizohet në çdo çast një lidhje direkte midis studios dhe atyre që ndërhyjnë në emision drejtpërdrejt.

Edhe faktori kohë ndikon.

Kur dikush është i gatshëm në atë çast, një tjetër nuk është.

Duhen shpërndarë kamerat njëkohësisht në pika të ndryshme të qytetit.

Nga ana tjetër, po të ftoheshin përfaqësuesit e shoqërisë civile në studio, kjo do të ndryshonte tipologjinë e emisionit. Tjetër peshë ka një bisedë tek për tek e gazetarit me një kandidat për postin e kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe krejt tjetër peshë ka një bisedë në studio, ku ai të ndodhet midis të tjerëve në një bisedë të zakonshme.

Pastaj, a pranojnë vallë kandidatët të marrin pjesë në këto biseda ku të ftuarit e tjerë të jenë të lirë të bëjnë komentet e tyre të pakontrolluara mbi ta, çka do të kishte një impakt mbi elektoratin?

Vështirë ta pranojnë një sfidë të tillë.

Në çdo rast pyetjet e përfaqësuesve të shoqërisë civile janë të forta, vendimtare dhe kyçe për të sqaruar disa çështje që debatohen në opinionin publik.

Nga kjo pikëpamje mund të thuhet se funksioni shoqëror i përfaqësuesit e shoqërisë civile është edhe të luajë rolin e pazëvendësueshëm të një aktori të ndërmjetëm.

Profesor Artan Fuga shpjegon se e gjen tepër interesant faktin që përfaqësues të shoqatave jofitimprurëse bëhen interpretues dhe zëdhënës të opinionit të përgjithshëm shoqëror. Lidhur me këtë ai sjell në vëmendje refleksionet e përfaqësuesve të shkollës së

Kolumbias, të njohur në historinë e teorive të komunikimit dhe të informimit, si Paul Lazarsfeld dhe Elihu Katz, të cilët gjykojnë se edhe në shoqërinë moderne opinionin publik nuk është realiteti pa një strukturë të caktuar organizimi. Sipas tyre, mund të krijohet përshtypja e gabuar, iluzioni pra, se shoqëria bashkëkohore është një realitet i atomizuar, i individualizuar, ku lidhja shoqërore është, si të thuash, shumë e fragmentuar dhe se marrëdhëniet midis individit, shumësisë së individëve dhe mediave duken nganjëherë si të drejtpërdrejta. Duket sikur çdo individ, në veçantinë dhe individualitetin e vet ndodhet përballë mesazhit të mediave dhe lirshëm, sipas shijes dhe mendjes së vet, e interpreton këtë mesazh. Por këta autorë mendojnë se nuk është kështu. Sado moderne të jetë një shoqëri, sado individualiste që të ketë prirjen të bëhet shoqëria e sotme bashkëkohore, në asnjë rast ajo nuk mundet të dalë përtej një organizmi të caktuar. Është fjala kryesisht për atë që çdo minigrup shoqëror drejtohet nga disa influenca mbizotëruese, që vijnë nga persona që zënë në shoqëri vende relativisht të privileguara. Të privileguara jo nëpërmjet statuteve të tyre administrative, por më tepër për shkak të statusit të tyre moral, intelektual, psikologjik, për shkak të faktit se grumbullojnë dije, informacione që të tjerët nuk i kanë, për shkak të kontaktit të tyre më të shpeshtë me mediat dhe shoqërinë në përgjithësi, sikurse edhe për disa cilësi që ata zotërojnë, të njohura publikisht, sikurse janë sensi i së drejtës, i arsytimit logjik, i nderit dhe i respektit të të tjerëve. Pra, janë ata që quhen si liderë të opinionit, të cilët luajnë rolin e një hallke të ndërmjetme midis publikut të gjerë dhe mediave. Ata, si të thuash, bëhen ndërmjetës midis gazetarit dhe opinionit publik.

Gazetari, sikurse është edhe rasti i emisioneve për të cilat po flasim, mbështetet në opinionet dhe pyetjet e tyre për të ditur se çfarë mendon publiku i gjerë dhe më anë tjetër, masa e opinionit publik arrin që nëpërmjet gojës së vet të përmbledhë në mënyrë të sintetizuar mendimet dhe opinionet që ka.

Vështirë se mund të thuhet që do të mund t'i drejtoja aq pa siklet Sokol Olldashit në emisionin e parë dhe pastaj Edi Ramës në emisionit e dytë, ato pyetje që përfaqësuesit e shoqërisë civile, lirshëm, në mënyrë të drejtpërdrejtë, pas skrupuj, u drejtuan atyre.

Në gojën e gazetarit këto pyetje do të kishin tingëlluar shumë irrituese për dy të intervistuarit. Parë në këtë këndvështrim, bashkimi i lirë i medias që sidoqoftë njeh disa kufizime, me lirinë dhe autonominë e shoqatave jofitimprurëse, të cilat edhe ato njohin kufizimet e tyre të natyrshme, sjellin në hapësirën publike një liri më të madhe.

Sikurse thotë studiuesi i sotëm Dominik Wolton, pohon profesor Artan Fuga, duke qenë ndërmjetëse mediat kanë nevojë të ndërmjetësohen, pra të përfitojnë nga kontributi i gazetarit dhe i liderëve të opinionit publik.

Korrupsioni dhe plani rregullues i qytetit

Pyetja ime ndaj kandidatit demokrat për postin e kryetarit të Bashkisë së Tiranës është drejtpërdrejt dhe menjëherë e lidhur me problemin e korrupsionit. Jo vetëm sepse kjo pyetje më interesonte direkt, por edhe sepse vetë i intervistuari e kishte prekur gjerësisht këtë tezë në qëndrimet e tij kritike ndaj kryetarit ekzistues të bashkisë.

Keni vendosur të luani kartën e korrupsionit. Ç'garanci jepni ju për veten?

Sokol Olldashi nuk i përgjigjet pjesës së dytë të pyetjes, por shpalos qëndrimin e tij kritik lidhur me gjendjen e pushtetit lokal në Tiranë. Ai thekson se Tirana si qendër urbane nuk ka ende një plan rregullues. Ndarja e tokave të ndërtueshme nga tokat e pandërtueshme dhe ekzistenca e një plani rregullues do ta kthente dhënien e lejeve të ndërtimit në një akt administrativ duke ia hequr

këtë kompetencë kryetarit të bashkisë.

Në fjalën e tij Sokol Olldashi përmend edhe dëshmitë që ndërtuesi Fratari dhe drejtuesi i firmës "Lura" kanë dhënë lidhur me sistemin administrativ të pushtetit lokal të Tiranës, ku për dhënien e lejeve të ndërtimit kërkohet të jepen, sipas tyre, rryshfete të përmasave shumë të mëdha.

Sipas Sokol Olldashit, korrupsioni administrativ në dhënien e lejeve të ndërtimit kundrejt shumave të majme të rryshfetit veç të tjerave ka rënduar edhe xhepat e qytetarëve, sepse është reflektuar në çmimet shumë të larta për metër katror ndërtim banese.

Nga ana tjetër, ai ka dëmtuar funksionimin normal të qytetit, si dhe ka krijuar lobin më të fuqishëm ekonomik të qytetit: ndërtuesit.

Në emision vjen një pyetje nga Zef Preçi, drejtor ekzekutiv i Institutit për Kërkime Ekonomike.

Nëpërmjet një monitori ai i shtron pyetjen kandidatit Sokol Olldashi:

Keni thënë se nuk do të përfitoni vetëm nga taksat lokale, por edhe nga buxheti i qeverisë qendrore. A nuk e komprometon kjo kritikën tuaj se bashkia ka marrë nga qeveria fonde jashtë planifikimit, aq më tepër që qeveria mund të bjerë në gjysmën e mandatit tuaj?

Sokol Olldashi përgjigjet se me rritjen e fondeve nuk do të kuptonte ndonjë rritje të tyre në mënyrë artificiale nga qeveria, për qëllime thjesht elektorale, sikundër ndodhi në vitin 2003, por nënkuptonte një rritje të buxheteve në bazë të parimeve moderne, sipas të cilave pjesa kryesore e vjeljes së tatimeve t'u ngelej pushteteve lokale.

Këtu kandidati Olldashi, në përgjigje të përfaqësuesit të shoqërisë civile, thekson edhe një çështje tjetër që e lidh informalitetin me problemet ekonomike dhe financiare të qytetit. Sipas mendimit të tij, të ardhurat e qytetit do të rriteshin edhe nga hipotekimi i mijëra apartamenteve ende të pahipotekuara dhe që tashmë ishin blerë nga qytetarët pa mundur që këta të fundit t'i regjistronin ato si pronë të tyre.

Pyetja e dytë vjen nga Kliton Zguri që prezantohet si përfaqësues i Zyrës së Mbrojtjes së Qytetarëve:

Që nga viti 1991 Tirana ka kaluar disa modele qeverisjeje, nga të cilat dy demokrate, si mund të krahasohen ato?

Pyetja nënkupton se krahasuar me modelet demokrate të qeverisjes, modeli i qeverisjes socialiste është shoqëruar me zhvillime urbane më të dukshme. Një pyetje që duket se e favorizon disi kryetarin aktual të bashkisë.

Ndërkohë Sokol Olldashi është i përgatitur për të dhënë një përgjigje mbi logjikë historike. Sipas tij, fakti që përgjatë qeverisjes lokale të Tiranës zhvillimet urbane pothuajse kanë qenë inekzistente, kurse në mandatet socialiste të qeverisjes lokale të Tiranës ato kanë qenë të ndjeshme, nuk lidhet me ngjyrën politike të pushtetit lokal; lidhet më shumë me faktorë konjunkturorë dhe me kontekstin historik. Përgjatë mandatit të parë të kryebashkiakut demokrat Sali Kelmendi, vendi sapo kishte dalë nga regjimi totalitar dhe e kishte pothuajse të pamundur që të promovonte një model pushtetit lokal për të qenë. Vendi ishte i varfër dhe mjetet financiare dhe ekonomike mungonin. Edhe përvoja e autonomisë sikurse kuadri juridik në mbështetje të kësaj autonomie dukeshin fare në fillimet e tyre. Kurse për sa i përket mandatit të kryebashkiakut të dytë demokrat, z. Brojka, Sokol Olldashi thekson se ai u vështirësua dhe pothuajse u bë i pamundur nga kriza e viteve '97 dhe '98.

Përballë akuzave për korrupsion: dinamikat urbane

Një javë pas bisedës me Sokol Olldashin, pikërisht më 13 shkurt 2007, në *Studio 24* përballë meje do të ishte Edi Rama. Një emision po aq i gjatë, pothuajse maratonë, prej dy orësh.

E njëjta skenë.

Pozicioni i Edi Ramës në kolltukun rozë ndryshon nga ai i rivalit

të tij. Edi Rama duket i mbështetur fort në shpinën e kolltukut, flet ngadalë, paraqitet me një zë të trashë dhe flet shkurt e më ngadalë se i pari. Regjia ka vendosur që prezantimi i Edi Ramës në sutitra të jetë: *Edi Rama, kreu i Bashkisë Tiranë*. Asgjë e jashtëligjshme, veçse përpara teleshikuesit duket si një fat i parathënë për të mbetur në të njëjtin post.

Dallimi midis fjalës «kryetari» dhe «kreu» është i jashtëzakonshëm, thotë profesor Artan Fuga, duke sjellë në analizën tonë refleksionet e një prej themeluesve të semiotikës moderne, Roland Barthes. Sipas tij, me gjuhë nuk do të kuptohet thjesht sistemi gjuhësor i mirëfilltë, por çdo sistem shenjash, pra edhe objekte të cilat në vetvete kanë edhe ato kuptimin e tyre. Nga pikëpamja e kësaj teorie, gjuha e mirëfilltë nuk është veçse një nënsistem të shprehuri brenda një sistemi më të gjerë dhe universal i përbërë nga gjithçka që përmban një kuptim të caktuar për njeriun, qoftë ky një publicitet, një shkrepimë rrufeje në ajër, një vizatim primitiv në një shpellë, një tingull, zëvendësimi i një fjale me një sinonim të pjesshëm të saj, një mimikë fytyre, etj.

Parë në këtë këndvështrim, edhe zëvendësimi i fjalës «kryetar» me fjalën «kreu» flet jashtëzakonisht shumë. Fjala e parë është e saktë politikisht dhe administrativisht, e dyta, ndonëse duket si sinonim i së parës, është jo vetëm e gabuar dhe e pasaktë, por edhe e mbarsur me doza emocionale. Fjala shqipe «kreu», vazhdon profesor Artan Fuga, nuk është vetëm «kryetari», por edhe koka, maja, pushteti sipëror.

Duket sikur Edi Rama në televizion po tenton të kandidojë për një post që tashmë i është akorduar. Një luftë semantike ka kohë që ka filluar midis të folurit mediatic të shumicës qeverisëse të krahut të djathtë dhe opozitës. Opozita flet për kryetarin e bashkisë dhe për kryetarin e Partisë Socialiste duke i bashkuar këto dy ofiqe në një, kur është fjala për të folur për Edin Ramën.

Duket sikur në këtë mënyrë ajo e ka gjetur sloganin politik të

nëndheshëm që i dërgon subkoshencës së elektoratit të vet. Nuk është fjala për të votuar thjesht Edi Ramën si kryetar bashkie, është fjala për shumë më tepër se kaq, për ta riafirmuar atë si kryetar i Partisë Socialiste duke e mbrojtur nga sulmet e së djathtës si edhe të rivalëve nanoistë në parti, të cilët kërkojnë të përmbysin kryetarin e zgjedhur nga kongresi.

Ndërkaq, në ligjërimin mediatik të krahut të djathtë Edi Rama titullohet «ish-kryetari i Bashkisë së Tiranës». Edhe ky etiketim gjuhësor ka kuptimin e vet të madh. E quajnë *ish-kryetari i bashkisë* për të sensibilizuar elektoratin apolitik të Tiranës. Ideja është se Edi Rama duke hyrë në Partinë Socialiste dhe aq më tepër duke u bërë kryetar i kësaj partie, nuk është më ai kryebashkiaku simpatik dhe apolitik i ardhur nga shoqëria civile, i mandatit të parë kur sapo erdhi në këtë post. Është tashmë militanti i parë socialist.

Së dyti, duan të thonë se i ndarë mes partisë dhe bashkisë, i zënë më shumë me hallet e tij në parti, Edi Rama nuk ka më kohë t'i kushtohet bashkisë.

Së treti, krerë të ndryshëm të krahut të djathtë shprehen me bindje se Edi Rama do t'i humbasë zgjedhjet. Është një bindje e verbër, e mbështetur tek ideja se dy mandate e kanë ezauruar dhe gërryer elektoratin e tij të mërëzitur, shpresohet, nga zhurmat, trafiku, ndotjet, gjendja e disa rrugëve urbane, fjalët që qarkullojnë për lidhje korruptive midis pushtetit lokal, apo segmenteve të tij të ndryshme dhe botës së biznesit të ndërtimeve. Të gjitha këto mblidhen te parashtesa «ish», së cilës i del përpara etiketa që del në ekranin televiziv, kur prezantohet Edi Rama në studio.

I bëj një pyetje në mënyrë të drejtë, duke e legjitimuar atë nisur nga të dhënat e opozitës dhe të kandidatit rival. Shumë korrektësisht. Pyetja është pak a shumë se fakti që nuk ekziston një plan rregullues, thonë se vjen për shkak se kështu i lihet rrugë e lirë korrupsionit.

Sa e vërtetë do të ishte kjo?

Përgjigja e Edi Ramës vjen e shpejtë dhe përqendrohet në një fjalë:

«Broçkulla!»

Duhet analizuar paksa kjo fjalë e vetme.

Përse një fjalë e vetme?

Duket se është një fjalë e menduar qysh më parë. Nga pikëpamja fonetike ajo ka po aq kuptim, sa edhe nga ana kuptimore. Është një fjalë që nis me «B», zakonisht ironike. Pastaj derisa arrin te germa «ç» dhe dëgjuesi nuk ka arritur të shkojë më tej, fjala e jep edhe një kuptim tjetër fonetik: «Broç...». Ajo germa «ç» është po aq neglizhuese në fund të një fjale të shkurtër.

Një fjalë e vetme edhe për faktin se shqiptuesi i saj duket sikur thotë se nuk ka ndër mend të japë argumente të gjata ndaj akuzës që i bëhet për korrupsion. Dihet se psikologjikisht sa më shumë mbrohesh, aq më shumë jep përshtypjen se ke nevojë të mbrohesh, pra në njëfarë mënyre vetakuzohesh.

«Broçkulla» do të thotë se niveli i akuzës është kaq i ulët, sa nuk ia vlen të merresh aspak me të.

Por në fund kemi të bëjmë edhe me një përgjigje disi paralajmëruese për gazetarin, për të mos hyrë në këto ujëra, sepse përndryshe do të marrë të tilla përgjigje që në fakt e përmbyllin shpejt intervistën dhe bisedën në studio.

Edi Rama i përgjigjet pyetjes lidhur me shkallën e korrupsionit në nivelin e pushtetit lokal që ka administruar prej disa vitesh duke shtjelluar pozitivisht sukseset e dinamikave urbane. Ai bën krahasimin midis këtyre dinamikave në zonën urbane të Tiranës, ku prej vitesh administrojnë socialistët dhe ngërçit urban në disa zona qytetesh dhe qytete të tëra ku kanë qeverisur demokratët.

Për Edi Ramën dallimi është midis modelit të ndërtimit dhe modelit të shkatërrimit.

- Shkoni, – thotë ai, – matanë Tiranës, në Kamëz a gjetiu dhe do t'i bëni fare mirë dallimet.

Përballë akuzave për korrupsion, vjen përgjigjja e mbështetur në dinamikat urbane tepër të gjalla. Në fakt, rezultatet e zgjedhjeve

lokale në Tiranë në favor të koalicionit të krahut të majtë, që e kontrollon pushtetin atje prej dy mandatesh tregoi se opinioni publik është më pak i ndjeshëm ndaj akuzave për korrupsion, sesa është i interesuar për dinamika të fuqishme urbane.

Në këtë pikë ka nevojë të shtrohet pyetja se përse ndodh kështu?

Pra, përse ka kaq pak reagim nga ana e opinionit publik shqiptar ndaj dukurive të tilla sikurse janë bakshishi, korrupsioni, fitimet nën dorë, etj?

Lidhur me sa më sipër mund të thuhet se shpeshherë lufta ndaj korrupsionit është politizuar jashtë mase. Gjëja e parë që bëjnë partitë politike dhe kundërshtarët politikë është ta sulmojnë tjetrin si të korruptuar. Dhe shpesh kjo ndodh që bëhet pa prova të natyrës gjyqësore. Mbi këtë bazë fjala «i korruptuar» ka pësuar njëfarë nënvleftësimi dhe inflancioni semantik.

Pastaj mbi këtë bazë është krijuar edhe psikoza kolektive se të gjithë vjedhin. Këtë e konfirmojnë edhe anketat e shumta, të cilat realizohen shpesh nga duar jo fort profesionale, që krijojnë imazhin publik se çdo nëpunës apo aktor shoqëror ka vetëm një moral, atë të zhatjes sa më shumë, në rrugë të drejtë apo të padrejtë, nga shoqëria dhe nga të tjerët.

Gati është bërë një postulat i pathënë, por i nënkuptuar, se e tillë, korruptive është vetë natyra e njeriut. Duket sikur kemi të bëjmë me konstatime radikale, por që në radikalitetin e tyre prodhojnë njëfarë stagnacioni moral dhe administrativ. Përderisa të gjithë janë të korruptuar dhe të korruptueshëm, atëherë përse duhet të mbahet në konsideratë përmasa e të qenit i pakorruptuar?

Në shumë drejtime mund të themi se korrupsioni dhe ryshfeti e bakshishi lulëzojnë në një kontekst social dhe administrativ, kur sistemi i shërbimeve sociale është ende i pazhvilluar apo përjeton një krizë të thellë. Sidomos vuajnë prej kësaj sistemi i administratës i specializuar për doganat, tatimet, si dhe sistemi i arsimimit, i

shëndetësisë, etj., pa përmendur këtu gjykatat.

Atë që qytetari nuk e plotëson dot si shërbim në mënyrë të rregullt detyrohet ta paguajë për një shërbim më të mirë, më të shpejtë dhe të privilegjuar.

Kush pyet për shumën e dhënë nën dorë në shkëmbim të një ndërhyrjeje të mirë kirurgjikale që shpëton një jetë?

Ndërkaq zakoni i rryshfetit dhe i bakshishit përbën atë shtresë zakonore mbi të cilën gjen mbështetje edhe korrupsioni i përmasave të mëdha. Ky mjedis rryshfeti karakterizon ato shoqëri që sapo kanë dalë nga një shtrëngesë mallrash konsumi, sikurse ishte Shqipëria gjatë periudhës totalitare, kur një kilogram mish, qumësht, apo disa kokrra vezë hapnin shumë dyer të administratës dhe të shërbimeve.

Nuk duhet harruar se shoqëria shqiptare ndodhet në një proces akumulimi fillestar kapitalesh, ku vlera e pasurimit dhe përgjithësisht ato që quhen vlera materialiste kanë një përparësi të dukshme ndaj vlerave shpirtërore dhe politike sikurse për shembull vlera e drejtësisë dhe barazisë sociale.

Kush pasurohet, ai është më i zoti – kështu mendojnë shumë njerëz, ndërsa për rrugët e pasurimit nuk duket se tashmë ka vërtet një gjykim të rreptë, që të ndajë atë që është e rregullt dhe e pranueshme nga ajo që konsiderohet si jo e moralshme.

Duke u kthyer te fjala «broçkulla» me të cilën përgjigjet Edi Rama, ritheksoj se ajo përmban edhe një pakënaqësi indirekte ndaj meje.

Dhe pak më pas, pakënaqësia ndaj gazetarit rishfaqet hapur, sepse atij i thuhet se "ju keni rënë në të njëjtat gracka si të tjerët duke e konsideruar planin rregullues si një plan të ngrirë rrugësh, ndërkohë që qyteti është një organizëm i gjallë, që ndryshon dhe modifikohet çdo ditë".

Taktikisht, kështu ndiqet një strategji debati, e cila e vendos bashkëbiseduesin në një situatë fajësimi.

Ndoshta Edi Rama e ushtron këtë strategji me të gjithë formuluesit e pyetjeve që vijnë nga shoqëria civile. Kur Zef Preçi, drejtor ekzekutiv i Institutit për Kërkime Ekonomike e pyet për kompetencat që do të mund t'u kaloheshin minibashkive dhe nëse do t'i njihte tapitë e legalizimeve që Berisha kishte nisur t'u jepte të ardhurve, Edi Rama është po aq i prerë:

“Këtë të dytën nuk e kuptova” – thotë ai.

Nënteksti është se po i bëhet një pyetje pa kuptim. Dhe pastaj vazhdon e thotë se e gjithë kjo historia e ndarjes së tapive dhe e legalizimeve nuk është veçse «tallja e radhës e Sali Berishës, sepse sipas tij legalizimet kanë nisur dhe do të mbarohen «prej nesh». Pra, pyetja jo vetëm nuk ka kuptim, por edhe përgjigja e paraqet gjendjen si të mbështetur në një akt talljeje të dikujt tjetër.

Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, nëpërmjet zërit të Kliton Zgurit bën pyetjen:

Kundërshtarët ju akuzojnë për miliona euro në llogaritë tuaja. Ne jemi skeptikë për këto të thëna, por ndërkaq ju shohim se jetoni në mënyrë luksoze me shumë shpenzime duke marrë parasysh rrogën tuaj modeste si kryetar bashkie. Çfarë mund të thoni për këtë gjë?

Pyetja sa është e drejtpërdrejtë, aq duket edhe disi «e trembur», le të themi e kujdesshme, çka i jep dorë kryetarit të bashkisë të përgjigjet sipas mënyrës së tij.

Pyetja u referohet kundërshtarëve të tij, pra që këtu duket e hedhur poshtë, sepse presupozohet që kundërshtarët atë punë kanë, të akuzojnë.

Aq më shumë që formulohet një pyetje për të cilën thuhet se «jemi skeptikë» për vërtetësinë e saj. Duket se përfaqësuesi i shoqërisë civile ka gjetur një mënyrë për ta legjitimuar pyetjen duke mos e marrë përsipër autorësinë e saj dhe duke mos i besuar këtij sulmi për korrupsion që i bëjnë kundërshtarët Edi Ramës. Taktikë që e mbron atë. Por, nga se e mbron? Nga ai që pyetet. Kështu semantikisht pyetësi vendoset në një pozicion disi të ndrojtur përpara atij të cilit

i shtrohet pyetja.

Aq më shumë që forma e pyetjes do t'i shkonte një gazetari që kërkon të mbledhë të dhëna dhe jo një aktivisti i cili hedh në debat fakte dhe nuk bën supozime.

Pjesëmarrja në hapësirën publike televizive e ka këtë rrezik për aktorët e shoqërisë civile. Ata herë pas here mund të ngatërrojnë rolet duke marrë staturën e gazetarit që pyet dhe jo të grupit të interesit që kërkon dhe shpreh vendime apo vullnete politike.

Aq më shumë se konstatimi se «ju bëni një jetë me shumë shpenzime» e rrjedh ujin e debatit në një kanal disi të rrëshqitshëm, sepse nënkupton sikur kryetari i Bashkisë së Tiranës është vrojtuar nga afër për një kohë të gjatë për ta parë se sa shpenzon ai.

Duke qenë një pyetje paksa evazive, çdokush do ta kishte më se të lehtë të përgjigjej:

«Jo, nuk bëj një jetë të kushtueshme, me se e provoni një gjë të tillë? »

Dhe në fakt, Edi Rama përgjigjet duke e çuar bisedën drejt përvojave të jetës së tij personale. Një shans i paparë për të përfituar nga koha televizive dhe për të bërë promocion për vete.

«Jeta ime e përditshme është shumë e thjeshtë» – përgjigjet ai fare lehtësisht dhe askush nuk ka mundësi ta kundërshtojë në këtë pikë.

«Më parë, - nis e tregon ai, - pra qysh në kohën e regjimit totalitar kur nuk kishte veshje cilësore, dizenjon e rrobave të mia e bëja vetë.»

Informacion simpatik për mijëra të rinj.

Kryetari i bashkisë ka pasur idenë interesante të bëjë dizenjon e rrobave të tij që dihet se kanë qenë gjithmonë të veçanta!

Dihet se teleshikuesi e pëlqen për kiamet këtë lloj të foluri që tërheq. Piktur, kryetar bashkie, disenjator veshjesh, rrobaqepës, dikush që nuk konformohet me fatalitetin e shijes së keqe nëpër njësitë e shitjeve, që u shpëton standardeve mediokre.

Përgjigja e pyetjes tjetër, formuluar nga Kliton Zguri në emër të Zyrës së Mbrojtjes së Qytetarit, është edhe më e shkurtër. Pyetet se mos është duke ecur drejt modelit të një «monologu demokratik», meqë nuk ka pranuar debat televiziv me kundërshtarit e tij në fushatë. Edi Rama përgjigjet se me akuzat që ka bërë, akuzat të pambështetura, ai, pra kundërshtari i tij, nuk e meriton këtë debat.

Ndërkaq, përgjigja ndaj pyetjes së Gerta Ramadanit shkon në kufijtë e neglizhencës. Ajo vjen me pyetjen e saj si përfaqësuese e shoqatës «Gratë mbështesin gratë». Nuk dihet fort qartë se cili është kuptimi i emërtimit të kësaj shoqate. Gjithsesi pyetja është formuluar qartë, më tepër është një vërejtje:

«Bashkia e Tiranës nuk ka pasur një strategji për dhunën në familje si një shërbim ndaj grupeve vulnerabël.»

Për t'i dhënë edhe më shumë peshë pyetjes së bërë, e paraqes autoren si ish-*Mis Albania*. Në fund të fundit, një ish-*Mis Albania* mbetet një figurë publike, sikurse mbetet i tillë një ish-ministër, një ish-deputet, një ish-sportist, e kështu me radhë.

Ndërkohë Edi Rama e kap situatën dhe ndërhyr me një batutë të shpejtë:

«Ajo është *Mis Albania*, nuk është ish-*Mis Albania*.»

Ndërhyrja është e ndërlikuar në përmbajtjen e vet kuptimore. Nga njëra anë duket si një ndërhyrje vlerësuese. Vlerësohen po ato cilësi të një gruaje që konsiderohet se është në po në atë nivel sikurse ka qenë edhe në çastin kur është shpallur *Mis Albania*. Por brenda ka edhe një moment nënvlerësimi, sepse titulli «*Mis Albania*» merr prioritet mbi etiketën me të cilën Gerta Ramadani ka ardhur në monitor, pra si përfaqësuese e një shoqate, aktore e shoqërisë civile. Për këtë arsye Gerta Ramadani reagon më pas në gazetë për etiketimin që atë natë i bën në televizion Edi Rama.

Ka një nëntekst sipas të cilit:

«Jo, ju nuk mund të jeni përfaqësuese e shoqërisë civile, ju kanë zgjedhur si *Mis Albania*.»

Dhe pastaj Edi Rama nis të përgjigjet duke e filluar fjalinë e tij përsëri me të njëjtën etiketë:

«*Mis Albania* është e painformuar ...»

Ai nuk heq dorë nga e tija. Përballë quan se ka një *Mis Albania* dhe jo një aktiviste të shoqërisë civile, e cila është në gjendje t'i bëjë pyetje që të kenë një lloj vlere. Dhe vetë përgjigja e tij nuk korrespondon fare me pyetjen që sapo i është bërë. Pyetja është: Cilat janë strategjitë dhe shërbimet e Bashkisë së Tiranës lidhur me gratë në gjendje të vështirë psikologjike ose familjare? Kurse përgjigja është e lidhur me pjesëmarrjen e grave në politikë. Edi Rama pohon se Partia Socialiste ka «hapur epokë», kur ka vendosur që në listat e kandidatëve për këshilltarë në pushtetin lokal 50% të jenë gra.

KORRUPSIONI, MES POLITIKËS DHE DREJTËSISË

Një nga emisionet më interesante në kuadrin e *Studios 24* duket se është ai i datës 31 janar 2007, i cili nisi të transmetohet drejtpërdrejt duke filluar nga ora 21:00 dhe që vazhdoi gjallërisht për plot dy orë.

Tema e emisionit ishte "Demokracia si procedurë dhe shteti ligjor".

Në të merrnin pjesë Aldo Bumçi, në atë kohë ministër i Drejtësisë, Fatmir Xhafaj, ish-ministër i Drejtësisë, Ilir Panda, nënkryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe Kreshnik Spahiu, drejtor ekzekutiv i Zyrës për Mbrojtjen e Qytetarëve.

Si gjithmonë skema e vendosjes së të ftuarve në studio i përmbahet së njëjtës logjikë hapësinore. Në krah të djathtë të ekranit, afër meje qëndron Aldo Bumçi, përballë tij Fatmir Xhafaj dhe pastaj më poshtë, në krah të Fatmir Xhafës qëndron ulur Kreshnik Spahiu e përballë tij Ilir Panda. Pra, në qoshen e studios, në vendin më të dukshëm është ulur një politikan i shumicës qeverisëse, një ministër, përballë tij rivali i vet opozitar, kurse shoqëria civile në përfaqësimin e Zyrës së Mbrojtjes së Qytetarëve dhe pastaj përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë vijnë në një nivel të dytë, më larg gazetarit,

por sidoqoftë virtualisht më afër telespektatorit.

Sikurse duket edhe nga tema e emisionit, pritej të trajtoheshin çështje të rëndësishme që lidhen me marrëdhëniet midis ligjit dhe demokracisë. Pra, sa është në gjendje shteti i sotëm shqiptar të respektojë normat ligjore, procedurat, duke u bërë një shtet ligjor i vërtetë, përballë shfaqjeve të arbitraritetit, shkeljes së ligjeve, informalitetit dhe korrupsionit.

Qysh në fillim shpresa ime ka qenë për një emision cilësor duke parë vetë cilësinë e të ftuarve dhe përvojat e tyre të spikatura si në luftën politike, ashtu edhe në aftësitë retorike, apo edhe në pozicionimin e tyre origjinal në skenën politike të vendit. Duket se tema e emisionit, sa e zgjedhur aq edhe e gjerë, krijonte mundësi për të rrahur një larmi tematikash. Dhe në fakt kështu ndodhi. Ndër to më kryesoret do të ishin tema e shfaqjeve të korrupsionit përgjatë fushatës zgjedhore për pushtetin lokal, e cila ishte në kulmin e saj, tema e korrupsionit në pushtetin gjyqësor dhe rrugëdaljet prej situatës së krijuar, shfaqjet e korrupsionit në veprimtarinë e pushtetit lokal si dhe ndikimi mbi të i korrupsionit të përfaqësuesve të këtij pushteti me ngjyra politike të ndryshme, tema e një procesi votimi ligjor, korrekt, të drejtë dhe të mbështetur mbi rregullat kushtetuese, jashtë përpjekjeve për manipulime që përbëjnë një nga shfaqjet më të rënda të korrupsionit politik.

Nga analiza e këtij emisioni ka gjasa të dalin në pah disa nga tiparet e opozicionimit të politikës së sotme shqiptare lidhur me luftën kundër korrupsionit si dhe disa marrëdhënie tepër të ndërlikuara midis botës së politikës dhe botës së shoqërisë civile.

Gjendja dhe niveli i korrupsionit

NEWS 24 ka filluar të «hajë» djathtas

Emisioni filloi me një pyetje të cilën e bëra papritur dhe shumë konkrete, nga ato pyetje me të cilat politikanët shqiptarë nuk janë mësuar t'u bëhen prej gazetarëve.

Ca sepse midis gazetarit dhe të intervistuarit vendoset shpesh një kontratë e pashkruar për ta mbajtur bisedën në nivele disi mesatare, jo fort të nxehta, sepse përndryshe i ftuari mund të mos vinte fare në emision.

Por shpesh edhe sepse koha e gjatë në kontakt ndodh që krijon edhe marrëdhënie familjariteti midis të dy palëve.

Gazetari për të bërë një pyetje ta quajmë të fortë, ndodh që duhet të përballojë lloj-lloj presionesh që vijnë nga anë të ndryshme.

Pyetja e fillimit ishte:

«A mund t'i thërrasë në zyrën e tij për t'iu dhënë këshilla e udhëzime prokurorëve Presidenti i Republikës?»

Pyetje tepër aktuale, sepse pak ditë më parë kishte ndodhur pikërisht ngjarja për të cilën po shtrohej pyetja.

Në një këndvështrim tepër strikt të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nuk e ka këtë kompetencë dhe dihet se atij po Kushtetuta i ndalon që të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që teksti kushtetues i ka akorduar.

Nga vizionimi i kasetës kuptohet lehtë se pyetja e gazetarit, thotë profesor Artan Fuga, i ka lënë paksa të çuditur të ftuarit dhe i ka vendosur përballë një problemi tepër konkret. Dihet se kur është fjala për t'u pozicionuar konkretisht, larg parimeve të përgjithshme, përgjigjet janë të vështira.

Duket se Aldo Bumçi e ka të vështirë të përgjigjet, sepse nga njëra anë ai është ministër i një qeverie që në kohën e emisionit njihete një marrëdhënie tepër të tensionuar me presidentin, por ndërkohë,

si ministër i Drejtësisë ndodhej gjithashtu në një marrëdhënie pune të ngjeshur me Presidentin e Republikës. Ai gjen një përgjigje të mbështetur në një argument juridik:

«Përderisa Presidenti i Republikës i emëron prokurorët, ai edhe mund t'i thërrasë.»

Por argumenti juridik i dhënë nuk duket shumë bindës, sepse Presidenti i Republikës emëron edhe personalitete të tjera të shtetit, për shembull kryeministrin, por nga kjo nuk rrjedh vetiu e drejta e tij për ta thërritur në zyrë dhe për t'i dhënë udhëzime.

Sidoqoftë, edhe Fatmir Xhafaj, ndonëse opozitar me Bumçin, ka të njëjtin mendim. Kuptohet se argumenti i tij juridik, i njëjtë me atë të Aldo Bumçit është në koherencë edhe me qëndrimin politik të opozitës socialiste në mbështetje të Presidentit të Republikës përgjatë marrëdhënieve të tensionuara mes tij dhe kreut të qeverisë. Duket se Fatmir Xhafaj nuk e priste që kjo pyetje të bëhej në studion e televizionit *NEWS 24*, prandaj nuk mungon që të lëshojë një fjali të shpejtë shumë domethënëse, e cila mund të kuptohet edhe si një paralajmërim i largët dhe paraprak për gazetarin që ka ndërtuar këtë pyetje. Ai thotë:

«Pyetje e çuditshme.»

Ndërkohë që nuk është veçse një pyetje dhe një pyetje nuk mund të jetë kurrë e çuditshme në vetvete.

Pak më pas duket disi i pakënaqur nga rrjedha e pyetjeve dhe e vetë emisionit; Fatmir Xhafa nuk mungon ta formulojë me terma më të qarta dhe të drejtpërdrejta pakënaqësinë e tij. Ai thotë:

«Ka filluar edhe *NEWS 24* të *hajë* djathtas?»

Nënteksti është i qartë. Duket si një çudi, po të mbahej parasysht se ky televizion ishte gjobitur nga hallka të administratës që merren me rregullimin ligjor të veprimtarisë së mediave televizive e që gazetarë të ndryshëm e quajnë të influencuar nga qarqet qeveritare. Konstatimi ironik do të thotë se si është e mundur që një televizion që ka pasur probleme me qeverisjen e djathtë të fillojë të

«hajë» djathtas! Është një prekje në sedër, një lloj paralajmërimi dhe tërheqje vëmendjeje në planin etik për të mos rënë në pozita servilizimi.

Duhet kuptuar mirë shprehja dialektologjike «të hajë».

Mbi të gjitha nuk duhet ngatërruar me foljen «me ngrënë» ose «me hangër». S'është pra fjala se televizioni në fjalë ishte duke ngrënë (ushqim) nga e djathta, pra se po ushqehet nga e djathta. Jo. Kuptimi i kësaj shprehjeje është krejtësisht tjetër. «Të hajë djathtas» do të thotë të ketë një prirje për t'u drejtuar nga ana e djathtë. Pra, sikurse një timon biçiklete ta zëmë, priret nga e djathta nëse ai lihet në gjendje të lirë, kur në boshtin e tij ka një defekt që e pengon të jetë në ekuilibër.

Ndërkohë që edhe ndaj Kreshnik Spahiut, në një çast të caktuar të bisedës, pikërisht kur ky i fundit i konsideron si të porealizueshme kërkesat e Partisë Socialiste për ta detyruar votuesin që të paraqitet para kutisë së votimit me një sërë dokumentesh, Fatmir Xhafaj i drejtohet atij duke i thënë:

«Përse nuk keni ngritur zërin më parë që qytetarët të pajiseshin me letërnjoftim?»

Sigurisht që nuk është një llogari që mund t'i kërkohet një përfaqësuesi të shoqërisë civile.

Por kështu e kanë bisedat e zjarrta në studio.

I kujt është faji për nivelin e korrupsionit?

Në këtë emision, debati midis përfaqësuesve të krahëve të ndryshëm të politikës u përqendrua edhe për të gjetur shkaqet, format dhe shkaktarët e nivelit të korrupsionit në shoqërinë shqiptare.

Sigurisht që interpretimet janë të kundërta dhe konfliktuale.

Sipas ministrit Aldo Bumçi, ardhja në pushtet e Partisë Demokratike dhe aleatëve të saj ka shënuar edhe fillimin e reformave dhe të

zbatimit të politikave antikorrupsion, të cilat sipas tij kanë qenë rezultat i një qeverisjeje defektoze të mëparshme nga ana e Partisë Socialiste. Në analizën e tij, ai paraqet edhe disa nga arritjet në këtë fushë në këto vite qeverisjeje nga ana e koalicionit të djathtë. Doganat dhe shërbimi i tyre janë vënë në drejtim të mbarë dhe ndalimi i kontrabandës ka bërë që të ardhurat prej tyre të rriten në mënyrë të ndjeshme. Forcat e rendit kanë arritur të zbulojnë dhe vënë në gjendje arresti shumë krerë bandash që për një kohë të gjatë kanë vepruar pa mundur të goditen. Janë vendosur në Regjistrin e Tregtisë shumë biznese që për periudha të gjata kohe kanë qenë informale dhe nuk kanë paguar taksa. Kjo ka sjellë që edhe të ardhurat nga taksat të njohin një rritje. Një hop ka shënuar edhe zbatimi i Maturës Shtetërore, e cila përbën një mekanizëm të fuqishëm për të parandaluar dhe kufizuar korrupsionin në pranimin e kandidatëve për t'u regjistruar në shkollat e larta. Në disa raste janë goditur nga forca e ligjit dhe janë vendosur përpara drejtësisë edhe pushtetarë lokalë, si për shembull kryetari i komunës së Golemit dhe Velipojës.

Në analizën e tij Aldo Bumçi konstaton se ndërsa pushteti aktual po bën një luftë kundër korrupsionit, në atë pjesë të pushtetit lokal që drejtohet nga socialistët janë vënë re shkelje të natyrës korruptive. Pikërisht këtu ndërhyr Fatmir Xhafa i cili gjykon se ky konstatim nuk është i vërtetë. Vetë fakti që pushtetarët lokalë që janë dënuar nga drejtësia kanë qenë kandidatë të Partisë Demokratike dëshmon se janë ata që i kanë nxitur dhe s'i kanë luftuar praktikën korruptive në administrim. Sipas tij, atje ku ka pushtetarë të suksesshëm dhe këta janë kryesisht socialistë, nuk ka praktika korruptive, sepse financat janë administruar si duhet dhe në të mirë të zhvillimit të dinamikave të suksesshme urbane.

Nga analiza e emisionit duket qartë se secili aktor politik mbron ngjyrat e partisë së vet dhe të gjitha akuzat për veprimtari korruptive ia «faturon» palës kundërshtare. Prej këtej dalin disa përfundime.

Së pari që demokracia duke i ballafaquar aktorët politikë përbën një mekanizëm të fuqishëm për të bërë transparente politikat e qeverisjes. Në përballjen midis tyre, kundërshtarët politikë janë të prirur të nxjerrin në pah defektet e njëri-tjetrit.

Por më anë tjetër, analiza e çdo dukurie, pra në rastin konkret analiza e korrupsionit, merr një përmasë të spikatur politizimi. Secila palë i kërkon gabimet dhe dështimet te pala tjetër dhe nuk pranon asnjë të metë te vetja. Opinioni publik rrezikon të mbetet në një gjendje kaotike dhe të paqartë pa mundur që të nxjerrë të vërtetën. Në çdo rast dhe për çdo problem dëgjon dy versione shpjeguese të kundërta. Shpesh, qytetari i thjeshtë nuk di kujt t'i besojë. Më keq akoma, arrin të mendojë se politika, ashtu e përçarë sikurse është, nuk është në gjendje të bëjë një analizë realiste të problemit dhe të japë një zgjidhje konstruktive për ta shëruar këtë plagë të mahisur shoqërore sikurse është korrupsioni.

Qytetari i krijohet bindja se secila palë e lufton korrupsionin të kundërshtarët e vet, por nuk është në gjendje ta çrrënjosë atë te vetja, pra të pastrojë radhët e veta.

Profesor Artan Fuga sqaron se këto janë disa kufizime që ka debati politik dhe mediatic në hapësirën publike demokratike. Kjo hapësirë publike ka epërsi të padiskutueshme në krahasim me të kaluarën totalitare ku censura e shtetit ideologjik mbyllte çdo analizë të mbështetur në mendimin e lirë. Por kjo e vërtetë e padiskutueshme nuk na bën që të mos njohim edhe kufizime të ndryshme, të cilat e rrethojnë disi debatin dhe diskutimin publik në kushtet e reja. Duke u mbështetur te filozofi i sotëm gjerman Jürgen Habermas, ai thekson se ka një prirje që hapësira publike e diskutimit të shndërrohet në një hapësirë publicitare. I gjithë ligjërimi politik udhëhiqet nga logjika e reklamës. Jo vetëm për shkak se mediat financohen nga bota private, e cila nuk mund të krijojë një liri debati pa kufizime. Por edhe sepse sipas shpirtit të reklamës, ligjërimi i çdo aktori politik tenton vetëm të lavdërojë veten, sikurse çdo spot televiziv reklamues

nuk bën tjetër veçse lavdëron, i thur himne, ngre në qiell, produktin, mallin, reklamën e të cilit e ka paguar financuesi i spotit publicitar.

Secili prej aktorëve politikë mund të shkojë pra deri në gjysmën e analizës dhe asnjëherë nuk arrin ta bëjë të plotë atë. Nxin dhe zmadhon përgjegjësitë e të tjerëve, të kundërshtarëve të vet dhe minimizon ose injoron çdo përgjegjësi të vetën, duke i akorduar vetes vetëm suksese dhe arritje.

Avantazhet e analizës së aktorëve të shoqërisë civile

Në këtë emision spikat ndërhyrja e drejtorit ekzekutiv të Zyrës për Mbrojtjen e Qytetarëve, Kreshnik Spahiu, tamam në kohën kur midis dy rivalëve dhe kundërshtarëve politikë po debatohej se cilat janë më të korruptuar, pushtetet lokale të drejtuara nga socialistët apo pushtetet lokale të drejtuara nga demokratët?

Në fakt, Kreshnik Spahiu e kishte marrë fjalën lidhur me problemin e korrupsionit edhe pak më parë. Mbi të gjitha ai mban qëndrimin se korrupsioni dëmton të drejtat e qytetarëve dhe se format e shprehjes së tij duhen kuptuar në një plan shumë të gjerë. Kudo ku ka shkelje të ligjit, atje ka edhe shfaqje korrupsioni, edhe dëmtim e cunim të të drejtave dhe lirive qytetare.

Ligjërimi i tij është konkret, me shembuj të spikatur dhe me ton të gjallë. Ndoshta është nga të vetmit aktorë të shoqërisë civile që në ndërhyrjet e tij publike arrin të mbajë tonin e një përfaqësuesi të një grupi interesi, pra të një aktori që përfaqëson dhe kërkon të mbrojë të drejtat qytetare. Pa anësi dhe pa ndonjë kujdes të tepërt për të mos u tensionuar me përfaqësuesit e politikës.

Pyetjes së parë të gazetarit nëse ka apo nuk ka të drejtë Presidenti i Republikës për të thirrur në zyrën e tij prokurorët, vetëm Kreshnik Spahiu i bën një analizë të thelluar. Ai shpreh mendimin e tij se sigurisht që Presidenti i Republikës ka të drejtë të thërrasë

prokurorët në zyrën e tij, por problemi nuk është këtu. Problemi i vërtetë qëndron te fakti se presidenti është kujtuar për këtë, për veprimin e duhur të drejtësisë në fund të mandatit të tij. Ai i thërret prokurorët – shprehet Spahiu – për një çështje që nuk përbën ndonjë problem real, me gjithë rëndësinë e vet parimore (garantimi i autenticitetit të dokumenteve të identifikimit të qytetarëve), dhe nuk i ka thirrur asnjëherë në këtë mënyrë më parë, kur ka qenë fjala për shkelje të rënda të ligjit dhe madje të përmasave masive. Ai nuk i ka thirrur për shembull për të shqyrtuar dhe hetuar ta zëmë masakrën urbane, kaosin urban që mbretëron sidomos në disa qendra të mëdha. Kanë ndodhur krime të rënda në Shqipëri dhe presidenti nuk ka vepruar.

Shkeljet e normave të shtetit ligjor janë shprehje të korrupsionit. Kreshnik Spahiu ngre problemin pse nuk u zbatua dekreti i presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve më 20 janar 2007. Kjo përbën një shkelje të Kushtetutës. U dhunua Kushtetuta e Shqipërisë.

Duke treguar shembuj të tjerë konkretë se lufta kundër korrupsionit ka nevojë të vihet në shinat e duhura, Kreshnik Spahiu konstaton se jemi shumë larg një transparence të vërtetë. Ai thotë se fshihen burimet e financimit të fushatave elektorale që janë duke u bërë. “Dhe nuk duhet harruar se janë fushata luksoze, të cilat vetëm në Tiranë, nga të dy kandidatët - vazhdon Kreshnik Spahiu - kapin shifrën prej 1 milion eurosh. Duhet deklaruar ku janë marrë këto para” – përfundon ai.

Ndërkaq Kreshnik Spahiu krijon një version tjetër parashtimi lidhur me atë se çfarë ngjyre politike ka korrupsioni – një debat i politizuar dhe i pakuptimtë.

“Nuk ndahen në engjëj dhe djaj bashkiakët sipas ndarjeve politike” – thotë ai në mënyrë të vendosur. “Ne kemi bërë studime lidhur me këto. Ka korrupsion, - konstaton ai, - edhe kur nuk ka akoma plane të rregullimit urban, te prokurimet publike, te mbledhja e taksave, te procedurat e dhënieve të lejeve të ndërtimit. Të

gjitha këto veprimtari janë burim korrupsioni. Është një gjë fare e qartë që nuk ka nevojë për ndonjë vërtetim që një pjesë e madhe funksionarësh të shtetit nuk jetojnë vetëm me rrogat e tyre. Gjendja e qyteteve është kthyer në një katastrofë urbane. Pushteti gjyqësor është pasiv dhe ka lejuar që të ndodhë kjo gjë.”

Shoqëria shqiptare ka nevojë për të tilla analiza që janë të paanshme dhe që vijnë nga aktorë të shoqërisë civile. Ato i shkojnë analizës deri në fund dhe nuk përmbajnë politizime. Ato nuk mungojnë të kritikojnë si qeverisjen, cilado qoftë ajo, ashtu edhe opozitën për qëndrimet e saj aktuale apo qëndrime kur ka qenë në pushtet. Jashtë një logjike gare politike. Jashtë një lloj ligjërimi elektoralist. Përtej një demagogjie të drejtuar andej nga fitohen votat. Të çliruar nga interesat e ngushta politike, por që mbajnë në qendër të vëmendjes interesin e përgjithshëm shoqëror.

Pa dyshim që të tilla analiza janë shumë efikase në planin intelektual, por ato rrezikojnë të izoloohen, sepse pikërisht aty ku duket se gjendet forca e tyre emancipuese ndodhet edhe pafuqia e tyre. Aktorët e shoqërisë civile që udhëhiqen nga paanësia në kritikën ndaj fenomeneve negative, duke përfshirë edhe dukuritë e korrupsionit në mijëra shfaqjet e tyre, rrezikojnë të mbeten të izoluar nga faktorët politikë të vendit. Ka rrezik të gjenden të vetmuar në përpjekjet e tyre, sepse ata mund të ngjallin edhe ftohtësinë e pushtetit, por edhe pakënaqësitë e opozitës. E në këtë mënyrë edhe rrethi i tyre i komunikimit (politik) vjen duke u ngushtuar pikërisht nga politika. Hapësira e tyre ngushtohet edhe në media, në administratë, në mjedisin shoqëror, gjithkund ku ndihet e pranishme influenca e politikës.

Duket sikur ndodhesh përpara një paradoksi të madh. Sa më ligjërim objektiv, të paanshëm dhe të vendosur të ketë një aktor i shoqërisë civile, aq më shumë ndihet i vetmuar, i braktisur, i shqetësuar nga aktorët politikë. Përkundrazi, mund të ndodhë që të promovohen më shumë aktorë të shoqërisë civile, të cilët kanë

njëanshmëri politike në qëndrimet e tyre. Por vlera e tyre si aktorë shoqërorë është tepër e kufizuar. Agjenda e veprimit të këtyre të fundit është e njëjtë me atë të forcave politike që ato mbështesin apo i mbështesin. Edhe mënyra e shtrimit të problemeve. Prandaj brenda një kohe të shkurtër duket sikur këta aktorë të shoqërisë civile në fakt nuk janë veçse zgjatime të veprimtarëve politikë. Paraqiten si parti politike me një vello paanësie që rripet shpejt. Pavarësisht se përkrahja e tyre nga politika është e konsiderueshme si nga opozita, ashtu edhe nga shumica qeverisëse, pavarësisht se individët e këtyre organizatave shpesh katapultohen si të suksesshëm në politikë apo në administratë, pavarësisht se ata përfitojnë fonde dhe bashkëpunime në të cilat administrata është partnere, besueshmëria e tyre në publik nis edhe bie.

Sa më e madhe të jetë fushata e tyre e publicitetit, aq më i vogël për rrjedhje bëhet impakti i tyre mbi opinionin publik.

Në emisionin që sapo analizuar shkurtimisht ndodhi diçka që e vërteton katërçpërisht këtë analizë. Pasi Kreshnik Spahiu kishte shpalosur idenë e tij se korrupsioni nuk ka ngjyra të veçanta politike, se ai është i pranishëm edhe mes administratorëve të majtë dhe administratorëve të djathtë, nisi reagimi i përfaqësuesve të politikës kundër tij.

E vërteta është se atë nuk e kundërshton përfaqësuesi i shumicës, ministri Aldo Bumçi, por përfaqësuesi i opozitës. Kjo është edhe më kuptimplotë për të treguar se kur analiza bëhet objektive dhe godet të dy krahët e politikës, ndodh jo rrallë që më ashpër ndaj kritikave reagon krahu opozitar, cilido qoftë ai. Opozita mendon ndonjëherë se ka vetëm të drejtën të kritikojë, por jo edhe detyrën për të dëgjuar kritikën. Sipas një mentaliteti vendas, duket se kush kritikon opozitën është servil i pushtetit. Opozita kritikon, por nuk kritikohet.

Fatmir Xhafaj, një politikan me profil të fortë prej juristi, që njihet për elokuencën e tij dhe tolerancën në debat, e kishte ndërprerë pak më parë Kreshnik Spahiun lidhur me çështjen e dokumenteve

të identifikimit të votuesve. Kur ky i fundit kishte argumentuar se qytetari i thjeshtë, ai që në shtëpinë e tij nuk ka madje asnjë fletë të bardhë për të shkruar, nuk ia ka ngenë të harxhojë kohë për të nxjerrë certifikata pas certifikatash dhe se do të ishte dashur që prej kohësh të prodhoheshin letrat e njoftimit, Fatmir Xhafaj ndërhyr e i thotë:

«Përse nuk e ngritët zërin ju për të bërë presion te qeveria që këto letra njoftimi të prodhoheshin?»

Ndërsa lidhur me korrupsionin, Fatmir Xhafaj përsëri i ndërhyr Kreshnik Spahiut duke i thënë se duhet të ketë kujdes kur akuzon çdo njeri që merret me politikë si i korruptuar.

«Të heqim dorë, – kërkon ai – nga fajësia kolektive.»

Asnjë kritikë me emër nuk kishte bërë Kreshnik Spahiu. As përgjithësime të tipit se «çdo njeri që merret me politikë është i korruptuar» nuk kishte bërë.

Por, jashtë analizës së rrjedhës së debatit, se në fund të fundit ishte i kulturuar, sado intensiv, sikurse duhet të jetë një debat politik, një problem del përsëri në pah.

Aktorët e shoqërisë civile e kanë të vështirë që të përballen me korrupsionin në mënyrë konkrete dhe me emra. Ata mund të merren me problemin disi në përgjithësi, disi në mënyrë abstrakte, por jo të vënë gishtin në plagë konkretisht. Për ta bërë këtë ata duhet të kenë një imunitet dhe një status social që nuk e kanë dhe sikurse duket nuk mund ta kenë. Për këtë duhet të bëjnë investigime të bazuara në ligj, çka është pothuajse jashtë mundësive të tyre.

As në thashetheme nuk mund të mbështeten dhe as në anketa, kur është fjala për ta përballuar korrupsionin në rrafsh konkret dhe si shfaqje e lidhur me veprimtarinë e një individi të caktuar. Sapo ta bënin këtë do të ndodheshin përballë dy zjarreve të papërballueshme. Nga njëra anë do të ndodheshin përpara akuzave të ngritura prej atyre që iu përmendet emri, të cilët do ta çonin çështjen në gjyq duke kundërakuzuar palën e shoqërisë civile për shpifje dhe cenim

të personalitetit.

Një i korruptuar ende i pazbuluar mbrohet nga rregulla dhe norma që kanë fuqi ligjore.

Po ka edhe një problem të dytë po aq serioz. Në rast të analizave të përgjithshme, për aq kohë sa ende nuk përmendet ndonjë emër konkret dhe i personalizuar, për aq kohë sa nuk bëhen analiza personale, askush nuk kundërpërgjigjet. Të gjithë bëjnë sikur ajo që trajtohet në media a në opinionin publik nuk ka të bëjë me ta. Edhe akuza e ndërtuesit kundër Bashkisë së Tiranës për haraçe shumash të majme nën dorë të kërkuara kundrejt marrjes së lejeve të ndërtimit mbeti krejt e përgjithshme. Asnjë person zyrtar nuk u shënjua si i tillë, pra si i korruptuar.

Por nëse dikush preket personalisht, atëherë aty fillon rreziku, sepse presioni shoqëror, sikurse edhe ai ligjor mbi akuzuesin ka prirje që të rritet shumë. Ai rrezikon hakmarrjen, presionet, dëmtimet fizike ose financiare etj, që askush që punon në shoqatat jofitimprurëse nuk ka ndër mend t'i përballojë kundrejt një page të ulët nëpunësi, të marrë nga të ardhurat e projekteve të financuara prej të huajve. Vështirë se luftohen me sukses korrupsioni nga nëpunës të paguar me rrogë, aq më tepër me status social dhe administrativ të dobët dhe të punësuar përkohësisht dhe me kontratë nga shoqatat e shoqërisë civile, sikundër e quajnë veten.

Përballë një të korruptuari si vështirë e ka të kundërqëndrojë një nëpunës me status kontraktual të përkohshëm dhe pa asnjë mbrojtje apo imunitet ligjor.

GJYQËSORI – INSTRUMENTI ANTIKORRUPSION I AKUZUAR PËR KORRUPSION

Reformim nga jashtë apo nga brenda?

Në të njëjtin emision të datës 31 janar 2007 preket edhe çështja e reformës në pushtetin gjyqësor. Sikurse duket qartë përgjatë zhvillimit të emisionit, këtu problemi trajtohet në mënyrë të dyfishtë.

Problemi mbetet i ndërlikuar.

Nga njëra anë pushteti gjyqësor është një instrument juridik shumë i rëndësishëm për të luftuar korrupsionin, sikundër administrata e shtetit, doganat, policia, institucionet e mbledhjes së taksave dhe të tatimeve.

Por pikërisht këtu fillon e ngatërrohet problemi, shkruan profesor Artan Fuga.

Kush do ta ruajë policin i cili ka si detyrë të kapë kriminelin, se mos ai bëhet vetë kriminel?

Nëse segmente të caktuara të shtetit korruptohen, pikërisht ato që janë të specializuara për të luftuar korrupsionit, cilat institucione do të luftojnë korrupsionin tek organet e luftës kundër korrupsionit?

Përmendet teoria strukturaliste e Mishel Fukosë i cili në një studim të famshëm të tij shpjegon se midis dy grupeve të ndara, pra midis

atyre që shkelin ligjin, pra edhe të korruptuarve, dhe atyre që janë paguar për të mbrojtur dhe zbatuar ligjin ndodhet një grup i tretë, i ndërmjetëm, që përzier tiparet e dy grupeve të para.

Një grup ku mbrojtësi i ligjit është njëkohësisht edhe shkelës ligji dhe shkelësi i ligjit është gjithashtu edhe një instrument për ta mbrojtur ligjin. Më konkretisht Fukoja shpjegon, sipas profesor Artan Fugës, se ka një pjesë të caktuar të mbrojtësve të ligjit, si policë, prokurorë, gjykatës, të cilët nën presionin e botës së kimit, trafikeve ilegale, rrjeteve të drogës, kriminelëve të ndryshëm, botës informale, etj, hyjnë vetë në këtë vorbull qoftë nëpërmjet joshjes, qoftë nëpërmjet ndonjë presioni e shantazhi që iu bëhet nëpërmjet mjeteve të ndryshme. Disa prej mbrojtësve të ligjit nën presion, nën trysinë e ngasjes për t'u pasuruar në rrugë të lehta, apo të shantazheve të ndryshme bëhen shkelës të ligjit.

Dhe nga ana tjetër disa prej shkelësve tradicionalë të ligjit, vjedhës, trafikantë, delinkuentë, nën presionin e policisë bëhen bashkëpunues të saj dhe shndërrohen në vegla të ruajtësve të ligjit në kuadrin e ushtrimit të detyrës së tyre formale.

Ka policë që bëhen vjedhës, thotë Fuko, dhe ka vjedhës që luajnë më së miri rolin e policit.

Sipas opinionit publik, por edhe shumë aktorëve të shoqërisë civile apo të politikës që kalojnë në studion televizive, rezulton se ka edhe gjykatës, noterë apo përbarues të korruptuar.

Kjo çështje bëhet edhe më e koklavitur, sepse në sprovë vihet problemi i marrëdhënieve midis pushtetit legjislativ dhe atij gjyqësor, që është një problem i mprehtë dhe ende përfundimisht i pazgjidhur edhe për demokraci më të vjetra dhe të përparuara sesa demokracia në Shqipëri.

Ku qëndron kjo kontradiktë për të cilën po flasim?

Është e qartë se legjitimiteti i sovranitetit u kalon përfaqësuesve të popullit, deputetëve, të cilët bëjnë ligjet në Kuvend. Por ata nuk janë politikisht të paanshëm. Përkundrazi, ata u takojnë partive

të ndryshme politike. Sidoqoftë duke qenë se legjitimiteti del nga populli dhe u kalon deputetëve, prej andej duhet të dalë edhe pushteti gjyqësor. Përndryshe, po qe se pushteti gjyqësor do të ishte i pavarur nga ai i ligjvënësve, atëherë do të rrezikonim të shihnim të krijoheshin rrethanat për të rreshqitur drejt «republikës së gjykatësve», pra ku në fund të fundit pushtetin do ta kishin gjykatësit.

Por nga ana tjetër, nëse pushteti gjyqësor do të varej nga Kuvendi, a nuk do të humbte ai paanësinë që duhet të karakterizojë drejtësinë duke rënë pre e presioneve politike?

Brenda këtij qerthulli kontradiktash luhatet mendimi politik në Shqipëri. Në fakt, çështja e debatuar merr një natyrë kontradiktore pikërisht për shkak të politizimit të saj, sepse në të vërtetë kudo dhe kurdoherë gjenden ekuilibra të ndërmjetëm.

Ministri i Drejtësisë, Aldo Bumçi, (i ardhur në politikë nga radhët e shoqërisë civile), duke mbështetur idenë programatike të Partisë Demokratike dhe të qeverisë së saj, flet për një situatë kur midis gjykatësve ka të korruptuar. Por për këtë nuk ka reaguar si duhet vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Ai shpreh pakënaqësinë e tij ndaj opozitës e cila çdo përpjekje për reformë në pushtetin gjyqësor, që do ta spastronte atë nga dukuritë korruptive dhe individët e padenjë, e konsideron si një përpjekje për të ndërhyrë politikisht atje dhe për të goditur paanësinë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Për Aldo Bumçin faktet tregojnë se pushteti gjyqësor nuk mund të reformohet nga vetë punonjësit e tij, pra nga gjyqtarët. Oponencat brenda sistemit janë të dobëta. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas tij, nuk ka pasur as forcën e duhur për të goditur në mënyrë efikase dukuritë e korrupsionit të gjyqtarët, çka ka bërë që opinioni publik, qytetarët ta humbasin besimin e tyre të drejtësisë. Por edhe për probleme që lidhen me vetë figurën e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë sistemi nuk është treguar i ndjeshëm duke shfaqur solidaritete të brendshme tepër të ngurta. Për ministrin e Drejtësisë së kohës kur

transmetohej emisioni, sistemi gjyqësor ka mundësi të reformohet vetëm nga jashtë, nëpërmjet veprimeve energjike të Kuvendit.

Kësaj teme, por në një këndvështrim tjetër i përqaset në emision edhe socialisti Fatmir Xhafaj, ish-ministër i Drejtësisë përpara 3 korrikut 2005. "Ne nuk japim mbështetje që qeveria të kontrollojë pushtetin gjyqësor, ta përdorë këtë pushtet si derivat të saj, në funksion të mbajtjes së pushtetit" – shprehet prerë dhe qartë ai. "Nëse shumica parlamentare dëshiron të ndërmarrë reforma, ne i mbështesim ato, sikurse kemi bërë deri më tani. Kryesor është përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe strukturore të sistemit të pushtetit gjyqësor."

Midis të dyve ndërhyh Kreshnik Spahiu si përfaqësues i Zyrës së Mbrojtjes së Qytetarëve. Analiza e tij paraqitet e saktë, por e ka të vështirë sidoqoftë të japë një formulë përfundimtare se si mund të reformohet realisht pushteti gjyqësor.

Marrëdhëniet midis aktorëve politikë duken tepër konfliktuale. Pozicionet e tyre paraqiten në mënyrë antagoniste.

Çfarë mund të bëjë në këtë rast përfaqësuesi i shoqërisë civile?

Ai ka një rol të kufizuar brenda statusit të tij social dhe ligjor, sepse fuqia e tij për të ndërmarrë nisma ligjore, për më tepër të rangut të reformave që kërkojnë votim me shumicë të cilësuar në Kuvend, pra rrjedhimisht me konsensusin e të dy palëve, mazhorancë dhe opozitë, është pothuajse e pamundur.

Sidoqoftë bën përshtypje se qëndrimi i Kreshnik Spahiut mbetet tepër i ekuilibruar dhe me shqetësimin për të ruajtur një pavarësi mendimi të spikatur në krahasim me përfaqësuesit e forcave politike të pranishëm në emision. Këtu nuk duhet harruar se ai ndodhet midis dy personave më të rëndësishëm të partive politike kryesore në lëmin e jurisprudencës. Njëri ish-ministër i Drejtësisë në qeverinë e Fatos Nanos, njëri me përvojë tashmë të madhe në çështjet e drejtësisë, tjetri ministër i kohës në qeverinë e Sali Berishës, person me sensin e arsyetimit juridik.

Megjithatë ndërhyrjet e Kreshnik Spahiut janë të guximshme.

Ai sjell në vëmendje të audiencës dhe të ftuarve të tjerë në *Studio 24* se sipas një pyetësi të kryer nga një agjenci e huaj sondazhesh sociologjike, rezultojnë se 94% e shqiptarëve nuk kanë asnjë besim te gjyqësori dhe sistemi i drejtësisë në përgjithësi. Në këtë mënyrë autori i kësaj fjalie që sjell një rezultat sociologjik në studio, legjitimon shqetësimin e shumicës qeverisëse për gjendjen në të cilën ndodhet sistemi i gjyqësorit në raport me detyrën e tij. Ideja e përhapur shprehet sociologjikisht duke mbështetur besimin kolektiv se ka shumë gjyqtarë që në vend t'i zgjidhin çështjet sipas normave ligjore, i trajtojnë ato në funksion të parimit të njohur se «të drejtën e merr ai që paguan më shumë».

Mirëpo ai lë të nënkuptohet se rregullimi i problemeve të pushtetit gjyqësor dhe spastrimi prej tij i atij mishi të huaj që përbëhet nga gjyqtarët e korruptuar nuk është një çështje heqjeje e thjeshtë personash nga postet që mbajnë. Lipset në çdo rast të respektohen procedurat ligjore demokratike. Kreshnik Spahi nuk është as për një reformë të normativizuar me ligje që nuk gjejnë mbështetje në Kushtetutë. Sipas tij, duhet ndryshuar vetë Kushtetuta, në mënyrë që ajo të afrohet me nevojat e vendit dhe të përmirësimin e sistemit të saj shtetëror.

Duket se përfaqësuesi i shoqërisë civile nga njëra anë e kupton mirë se kuadri ligjor dhe empirik mbi të cilin vepron sistemi i drejtësisë shqiptare është i ngushtë dhe i pamjaftueshëm, por nga ana tjetër, e di shumë mirë se kjo reformë e kërkuar nuk mund të mbështetet veçse në një ndryshim kushtetues, që kërkon një vullnet politik nga një shumicë e cilësuar deputetësh, pra nuk mund të kryhet veçse nga një konsensus i gjerë i forcave politike të vendit.

Përse media televizive është më e hapur ndaj shoqërisë civile sesa mediat e tjera?

Duke sjellë në televizion të tilla të dhëna sociologjike, përfaqësuesi i shoqërisë civile na lejon të shprehim disa mendime lidhur me karakteristikat e organizatave jofitimprurëse në rolin që ato dëshirojnë të luajnë si aktorë kolektivë të shoqërisë civile.

Së pari, del se përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile vihen në rolin e burimit të një informacioni të specializuar në fushën e tyre, informacion i cili kalon pastaj nga ata te mediat e ndryshme. Në këtë mënyrë krijohet në qelizën bazë të shoqërisë një solidaritet dhe bashkëpunim midis shoqatave jofitimprurëse dhe mediave, apo televizionit në përgjithësi.

Në cilat media drejtohet më tepër ky informacion që vjen prej shoqërisë civile?

Nga cilët faktorë varet më shumë drejtimi i rrugës së këtij informacioni duke privilegjuar më shumë një media sesa një tjetër?

Fakti që kemi një drejtim informacioni që anon bollshëm të shkojë drejt televizionit *NEWS 24* na lejon të mbërrijmë në disa përfundime.

Ky informacion shkon shumë rrallë te mediat e partive politike sikurse janë gazetatat partiake. Shoqatat joqeveritare dhe jofitimprurëse bëjnë kujdes që ta tregojnë paanësinë e tyre edhe në këtë pikë. Edhe përpara donatorëve të huaj ato përpiqen të jenë të kujdesshme në këtë plan.

Ky informacion shkon me përparësi drejt mediave televizive. Më shumë se tek ato radiofonike, madje edhe më shumë se te shtypi i shkruar. Televizionet janë një media e përshtatshme për të bërë edhe promocionin e vetë personave që drejtojnë dhe animojnë organizatat joqeveritare dhe jofitimprurëse. Në këtë plan edhe avantazhi personal nuk mund të injorohet. Autori i një shkrimi në gazetë ka pak shanse që të mbahet mend si fytyrë edhe si karakter

psikologjik. Kurse ai që del në ekran përpara teleshikuesit, pas disa paraqitjesh bëhet një personazh publik.

Profesor Artan Fuga, duke u mbështetur te studiuesi klasik i teorive të komunikimit dhe informimit, Marshall Mc. Luhan, thekson se dalja në televizion bën që personi i shfaqur të memorizohet lehtë nga psikologjia kolektive. Televizioni e ka forcën e pakrahasueshme në krahasim me të gjitha mediat e tjera që ta rrënjosë personalitetin e personazhit si dhe imazhin e tij në mendjen e publikut. Një forcë të tillë nuk e ka as media e shkruar, e cila e drejton vëmendjen te përmbajtja më shumë se te autori i asaj që shkruhet, bile nuk e ka në këtë shkallë as kinemaja sado që edhe ajo është një media vizive.

Përpos këtyre faktorëve, që informacioni të shkojë drejt mediave televizive më shumë se drejt mediave të shkruara ndikon edhe fakti se është më lehtë të komunikosh një informacion në televizion, pra ta thuash disi spontanisht atë, sesa ta shkruash duke përgatitur për këtë qëllim një shkrim të tërë që duhet hedhur në letër, redaktuar, e pastaj faqosur.

Shtypi i shkruar, më tej, i ka të kufizuara sipërfaqet e botimit. Ndonjëherë është shumë e vështirë për aktorë të shoqërisë civile, të rinj në moshë, që të gjejnë një vend në median e shtypur kryesore të vendit. Ndërsa televizioni është një makinë gjigande, që duhet të prodhojë informacion ndoshta njëzet e katër orë në ditë. Ai ka nevojë marramendëse për informacione. Aq më tepër që televizioni, ndryshe nga mediat e shkruara, ka nevojë për fytyra të reja që ta tërheqin publikun drejt tij; në televizion nuk ka rëndësi vetëm ajo që thua, por edhe mënyra e veshjes, moda e saj, sa simpatike është fytyra e folësit, sa tërheqëse janë gjestet e tij e kështu me radhë.

Ndërkohë bëhen edhe më tërheqëse për informacionet ose deklaratat e ardhura nga bota e shoqërisë ato media televizive të cilat transmetojnë gjatë gjithë ditës lajme të ndryshme ose ripërsërisin në ekran thënie apo formulime nga më të ndryshmet. I tillë është

për shembull edhe *NEWS 24*.

Sigurisht që në gjithë këtë kuadër kanë rëndësi edhe marrëdhëniet personale të gazetarit me ata që përbëjnë rrethin e të ftuarve të tij, përfaqësues të shoqërisë civile, intelektualë, artistë, shkrimtarë, pedagogë, drejtues të organizatave jofitimprurëse, etj.

Nuk është gjithmonë një sipërmarrje e lehtë që të bashkohesh në studio dhe të përballësh mes tyre politikanë dhe përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile. Gazetari në këtë rast ndodhet midis dy ekstremeve mes të cilave është i detyruar të luajë dhe të lëvizë me zhdërvjelltësi. Nga njëra anë atij i kërkohet dhe i intereson të bëjë një emision interesant. Fakti se sa mund ta tërheqë ai audiencën në orën e emisionit që ka konceptuar dhe drejton është - mirë a keq - treguesi themelor i punës së tij. Për ta bërë sa më tërheqës këtë emision, atij i intereson që debati midis të dy palëve të ftuarve të jetë sa më i zjarrtë. Por nga një këndvështrim i tillë nuk ka asnjë të keqe që përfaqësues të shoqërisë civile të cilët e konsiderojnë median elektronike tanimë një instrument të rëndësishëm në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të tyre, të tregojnë tipare të theksuara polemizuese, forcë argumentimi të mbështetura herë-herë edhe në tone të ngritura, gjithmonë në funksion të së vërtetës dhe të pakonjukturuar politikisht. Nëse për politikën dhe për median e vërteta shpeshherë konsiderohet si një perspektivë në ato që sot po konsiderohen si media-demokraci, kjo nuk ka pse të adoptohet si qasje edhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Nuk ka rëndësi nëse toni i përdorur në media nga një përfaqësues OJF-je është i ulët apo i lartë, mjafton që e vërteta për të cilën ai flet të mos e lejojë politikanin ta shndërrojë në një perspektivë, por t'i referohet është sikurse është: një e vërtetë.

A ka mundësi që të ftuarit të grinden deri në kufijtë e sherrit me njëri-tjetrin?

Nuk do të ishte keq.

Vendosja në hapësirë e të ftuarve ballë përballë, ku politikanët e

opozitës të jenë në sy të atyre të shumicës qeverisëse dhe ku pala e shoqërisë civile të vendoset dallueshëm në një shkallë më poshtë politikanëve dëshiron të provokojë në mënyrë vizive pikërisht këtë lloj efekti. Pastaj edhe çdo përfaqësues i shoqërisë civile ndodhet më afër atij politikani që është perceptuar si me pozicione më të afërta me të tijat. Në njëfarë mënyre kjo vendosje e të ftuarve në hapësirën e studios do të thotë veç të tjerave se edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile nuk janë krejt neutralë, ndonëse mund të jenë krejt të pavarur në marrjen e pozicioneve përkatëse. Të gjitha shoqatat joqeveritare më kryesore sigurisht që në periudha të caktuara, në mos përherë, shfaqin ndjeshmëri më të mëdha për këtë apo atë krah politik. Ato edhe janë privilegjuar në marrëdhëniet që kanë pasur me autoritetet partiake apo shtetërore.

Mirëpo gazetari nuk e ka të lehtë të luajë gjithmonë lirshëm me zjarrin. Ai nuk mund t'i shkojë sherrit deri në fund dhe është i detyruar të moderojë. Sikundër shkruan profesor Artan Fuga, duke cituar filozofin e sotëm gjerman Jürgen Habermas, sa herë që debatuesit ulen rreth një tryeze për të shkëmbyer mendimet dhe idetë e tyre, sado të ndryshme t'i kenë, që biseda të vazhdojë ata duhet të pranojnë diçka të përbashkët, duhet të bien dakord për diçka, pra kanë nevojë të respektojnë një konsensus minimal, që do të thotë ta pranojnë tjetrin si të ndryshëm. Konsensusi demokratik mbështetet tek ideja se emëruesi i përbashkët i një debati, themeli i tij është që të gjithë pjesëmarrësit në debat të bien në të njëjten mendje se të gjithë janë të ndryshëm dhe ta pranojnë njëri-tjetrin si të tillë.

Gazetarit në studio mund t'i ndodhë që në nxehje dhe në inat e sipër t'i ikë ndonjë i ftuar nga studioja. Ta lërë bisedën në mes. Kuptohet se kur kjo ndodh një herë të vetme – është diçka që i jep hijeshi emisionit. Por kur kjo përsëritet, atëherë vihet në rrezik vetë emisioni dhe karriera e gazetarit.

Rasti i largimit nga studioja është një shembull ekstrem, por

mund të ndodhin edhe gjëra që teleshikuesi nuk i sheh, por që bëhen të bezdisshme për gazetarin dhe e pengojnë punën e tij.

Pas një grindjeje apo një lloj sherri në emision, mund të ketë të ftuar që i thonë gazetarit, hapur ose tërthorazi, se nuk kanë më dëshirë të vijnë më në emisionin e tij, sidomos kur trajtohen probleme të mprehta si ato të llojit të luftës kundër korrupsionit. Ka edhe më keq. Herë të tjera të ftuarit e mundshëm pranojnë të vijnë në emision, por ata kanë vërejtje për të ftuarit e tjerë. Dikush nuk pranon të jetë në një bisedë me dikë tjetër. Disa me disa të tjerë. Për lloj-lloj qejfmbetjesh apo mërish personale. E gjitha kjo e kthen punën e gazetarit në një ferr të vërtetë, sepse ai nuk ka aq kohë sa kujtohet ndonjëherë për të harxhuar në kërkim të të ftuarve të tij në studio.

Shteti si korporatë biznesi

Ligjërimi i përfaqësuesve të shoqërisë civile ka aftësinë për t'i kapërcyer kufizimet e mendimit dhe të folurit politik. Ky i fundit, sado cinik dhe i ashpër të jetë, sidomos kur artikullohet nga ana e opozitës, përsëri ndërtohet mbi një terren që lejon vetëm një frymëmarrje të kufizuar. Baza e tij qëndron te mohimi pothuajse i çdo të mete, mosarritjeje, mangësie te veprimi politik i atij që flet dhe ngarkimi i të gjitha përgjegjësive palëve kundërshtarë.

Ligjërimi politik është dikotomik, ai e ndan botën sipas një kromatike bardh e zi.

Ndërsa ligjërimi i përfaqësuesve të shoqërisë civile, i çliruar nga nevoja dhe obsesioni për të mbledhur vota, mund të jetë shumë më modest, shumë më pak autolavdërues, shumë më i ndërlikuar dhe ka fuqinë të arrijë në analiza të cilat mendimi politik e ka të pamundura t'i arrijë.

Në këtë logjikë nuk është aspak e rastësishme që përqsasjet e

ardhura nga shoqëria civile mund të gjejnë një pikë të përbashkët me mendimin politik të atyre deputetëve të cilët janë shkëputur nga grupet e tyre parlamentare pas konflikteve me burime ideologjike dhe politike dhe ndjekin në Kuvend një linjë të pavarur aksioni politik.

Më datë 26 janar 2007 në studion e emisionit *Vila 24* ka qenë i ftuar një deputet me një profil shumë të veçantë, Spartak Ngjela. Dihet se Spartak Ngjela ka spikatur për bindjet e tij liberale për shtetin, ekonominë dhe shoqërinë. Prej kohësh ai është i distancuar nga një sërë politikash që ndjek Partia Demokratike në pushtet duke i quajtur ato në mospërputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe të liberalizmit politik.

Gazetari e ndërftoi Spartak Ngjelën në bisedë duke ruajtur tematikën e emisionit të tij. Flitet për korrupsionin dhe reformat institucionale. Por pavarësisht tematikës së rëndësishme duhet gjetur edhe një lidhje me aktualitetin bashkëkohor të ditës. Një lexim i "Gazetës Shqiptare" që bën pjesë në të njëjtin grup mediatik si edhe televizioni *NEWS 24* është ndoshta një hyrje e mirë që jep dorë për këtë emision. Gazeta ka botuar një rezolutë të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës lidhur me krizën ku është futur procesi i hartimit të Kodit Zgjedhor në Shqipëri.

Spartak Ngjela i cili paraqitet me nëntitra në ekran si deputet i «Partisë Demokratike» është shumë kritik në pikëpamjet që shtjellon. Pas disa hezitimesh dhe një periudhe prej pak sekondash të domosdoshme «për t'u ngrohur» ai e shtjellon pak e nga pak gjithë sistemin e mendimit të tij.

Sistemi korruptiv, sipas tij, nuk është as i jashtëm dhe as i rastësishëm në shoqërinë shqiptare. E gjitha kjo ka lidhje me mënyrën se si është ndërtuar sistemi politik shqiptar. Spartak Ngjela është nga të vetmit që paraqitet në studion e televizionit me një qëndrim koherent, i cili i ngjan një hipoteze shkencore lidhur me korrupsionin dhe prodhimet e krizave në shoqërinë shqiptare.

Për të, ka ndodhur që shteti dhe politika janë kthyer në «korporata

biznesi». Kështu, sipas tij, i ka ndodhur qeverisë, po kështu i ka ndodhur edhe sistemit gjyqësor. Korrupsionin në ushtrimin e detyrave administrative, ai e sheh të lidhur edhe me marrëdhëniet midis pushtetit ekzekutiv dhe atij të drejtësisë.

Konkretisht, sipas Spartak Ngjelës, nisur nga pesimizmi që kishte shkaktuar në janar kriza e mbajtjes së zgjedhjeve për pushtetin vendor, Shqipëria e ka vështirë të zhvillojë zgjedhje të lira dhe të ndershme, për më tepër në një periudhë të parakohshme. "Me mijëra certifikata të prodhuara nuk gjenden se ku janë – thotë avokat Ngjela – dhe po të ishte në situatë të shëndoshë, institucioni i prokurorisë duhet të bënte ndjekje penale dhe ta fuste në burg përgjegjësën e prodhimit të tyre". "I kam djegur" – justifikohet ky administrator, ndërkaq çështja është shumë serioze.

"Gjërat janë të lidhura" – insiston atë mëngjes me elokuencën e vet avokati. "Përderisa nuk ka zgjedhje të lira, nuk mund të ketë qarkullim të lirë të elitave. Elitat nuk vijnë e ikin lirshëm nga pushteti në funksion të votës së lirë të elektoratit. Votimet kanë qenë gjithmonë të manipuluar. Përderisa elitat politike shtrembërojnë vullnetin e lirë të popullit, atëherë kjo u jep atyre mundësinë pastaj për të kryer veprimtari korruptive, sepse e dinë që rreziku i ndëshkimit prej votës popullore është i kapërcyeshëm me anë të manipulimit të procesit të votimit. Mungesa e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme e kthen automatikisht qeverinë - flet avokat Spartak Ngjela - në një korporatë biznesi dhe administratorët që nuk ndruhen nga sanksioni i votës kanë prirjen të nxjerrin fitime nëpërmjet veprimtarive korruptive dhe një lidhjeje ilegale me botën e biznesit duke *i marrë* këtij të fundit shuma të mëdha në formë *gjobash*».

Por çështja nuk mbaron me kaq. Sipas Spartak Ngjelës, pas korporatës së biznesit që krijohet nga qeveria dhe administrata e saj, krijohet edhe një korporatë e dytë biznesi që krijohet nga pushteti gjyqësor. Duke e vënë gjyqësorin nën varësinë e politikës, pra të forcës politike që drejton qeverinë, kuptohet që kështu nuk është e

mundur që kjo gjykatë të ndeshet me korrupsionin në radhët e klasës politike qeverisëse. Gjyqësori i varur nga ti, nuk mund ta luftojë dot korrupsionin tënd dhe për rrjedhojë administrata fillon të shkojë drejt një lidhjeje të shkurtër me botën e aferave. Edhe vetë gjyqtari ka prirje të korruptohet, sepse sipas Spartak Ngjelës, gjyqtari nuk ka asnjë personalitet. Ai nuk e ka fuqinë për ta goditur korrupsionin, pra ndodhet nën presionin e këtij të fundit dhe për rrjedhojë ndodh që të mposhtet prej tij. Shikoni ndërtesën e Gjykatës së Tiranës - bën thirrje i ftuari - nuk ka asnjë «impozancë». Duket si një depo. Nuk ka një pallat drejtësie. Dhe duhet ta dini - përfundon ai - se kur u dënua Sokrati kishte 501 gjykatës.

Shpjegimi i avokatit është i thjeshtë, koherent dhe sistematik. Me anë të një elementi të vetëm shpjegohen të gjitha fenomenet e mbrapshta të shoqërisë shqiptare, pra edhe dukuritë korruptive brenda saj. Mungesa e zgjedhjeve të lira çon në mosqarkullimin e lirë të elitave në pushtet, nga pushteti në opozitë dhe nga opozita në pushtet, gjë që krijon stagnacion dhe shkëputje nga kritikata e opinionit publik, pra që sjell korrupsionin e shtetit.

Sidoqoftë, kështu duket se hyjmë sadopak në një qerthull të mbyllur, ndonëse nuk e ngacmoj këtë temë. Nuk kemi zgjedhje të lira, pra nuk kemi një shtet efikas dhe demokratik, por po aq mund të thuhet se pa pasur një shtet demokratik, si mund të kemi zgjedhje të lira?

POLICIA DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Policia na mbron ne, kush na mbron nga policia?

Fillimi i procedurave legjislative për projektligjin mbi Policinë e Shtetit në dhjetor të vitit 2006 u bë shkas për një seri intensive intervistash në televizionin *NEWS 24*, veçanërisht në emisionin *Vila 24*. Një fluks i vërtetë të ftuarish që nga krerë të lartë të Kuvendit (nënkryetari Fatos Beja dhe ligjbërës të tjerë nga forca të ndryshme politike), përfaqësues të Ministrisë së Brendshme si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Përgjatë këtyre emisioneve dolën në pah shumë probleme që lidhen me marrëdhëniet midis demokracisë, ruajtjes së rendit dhe luftës kundër korrupsionit në shoqëri dhe në gjirin e atyre që duhet t'i luftojnë praktikisht çdo ditë shfaqjet e korrupsionit në shoqëri, pjesëtarëve të Policisë së Shtetit. Projektligji për Policinë e Shtetit dhe procesi i draftimit së bashku me procesin legjislativ në të cilin kishte kaluar mund të konsiderohet pa hezitim si indikator më domethënës lidhur me atë që mund të konsiderohet cilësi e komunikimit politik në Shqipërinë e ditëve të sotme. Përgjatë këtyre emisioneve dolën në pah edhe disa tipare të funksionimit dhe të sjelljes të aktorëve të shoqërisë civile që në Shqipëri më së shumti

kuptohej si një rrjet shoqatash joqeveritare, jofitimprurëse, të financuara nga donatorë përgjithësisht të huaj, të cilët vepronë në partneritet me administratën e shtetit.

Gjithçka nisi në fillim të dhjetorit 2006, kur krejt rastësisht disa organizata joqeveritare, të cilat mbartin ndoshta ekspertizën më të mirë në vend sa i takon fushës së të drejtave të njeriut, mësuan se një projektligj i ri për Shërbimin e Policisë së Shtetit kishte hyrë në proces legjislativ në Kuvendin e Shqipërisë. Sikurse doli më vonë, draftimi i ligjit kishte nisur kohë përpara 3 korrikut 2005, kur në pushtet kishin qenë akoma socialistët. Ligji ekzistues për Shërbimin e Policisë së Shtetit, i cili kishte filluar të hartohej që në vitin 1999 me ndihmën e ekspertëve të huaj që asistonin qeverinë shqiptare nuk kishte prodhuar defekte në implementim deri në momentin kur u mor vesh se një ligj tjetër për Policinë e Shtetit ishte draftuar nga të njëjtët ekspertë. Për më tepër Kuvendit po i kërkohet të kalonte për miratim një ligj të plotë fillim-mbarim dhe jo të ndryshonte nene të veçanta të ligjit ekzistues. Sikur të mos mjaftonte kjo për të shkakuar habi dhe shqetësim në opinionin publik, rezultoi se ekspertët vendas, sidomos ata që vepronin në fushën e të drejtave të njeriut, nuk ishin thirrur nga askush për të integruar ekspertizën e tyre në proces draftimi. Madje një proces i tillë rezultoi të ishte mbajtur pothuaj i fshehur nga ana e qeverisë. Pakujdesi apo një veprim i qëllimshëm për të shmangur oponentin që mund të komprometonte një proces ligjberës delikat?

Një koalicion organizatash joqeveritare i përbërë prej Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut (GSHDNJ), që nga brenda ambienteve të selisë së Kryesisë së Kuvendit kërkoi vëmendjen e medias dhe nëpërmjet tyre të opinionit publik që ligjberësit të ndërprisnin procesin legjislativ në të cilin kishte hyrë «ilegalisht», sipas tyre, Ligji për Shërbimin e Policisë së Shtetit. Pretendimet e këtyre përfaqësuesve të shoqërisë civile u bënë publike ditën e hënë,

më 4 dhjetor 2005. Të nesërmen, teksa zv. ministri i Brendshëm Gjergj Lezhja mbronte projektligjin e Shërbimit të Policisë së Shtetit në komisionin parlamentar të ligjeve, në intervistën e mesditës në *Vila 24* vjen si i ftuar drejtori ekzekutiv i IDM-së, Sotirag Hroni, i cili në plot 30 minuta që iu vunë në dispozicioni renditi të gjitha ato që ai dhe kolegët e tij të organizatave të tjera i kishin konsideruar si probleme serioze në hartimin e këtij projektligji. Një ditë pas kësaj interviste, përfaqësuesit e këtyre organizatave paraqitën vërejtjet e tyre në një seancë dëgjimore në Komisionin e Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Në emisionin e datës 7 dhjetor 2006, i cili nisi të transmetohet drejtpërdrejt në orën nëntë të mëngjesit, me po të njëjtin intensitet vijoi të trajtohej argumenti në fjalë. Të ftuara ishin dy zonja: Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, si edhe Migena Leskoviku, drejtoreshë e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Diskutimi mori dimension publik dhe u trajtua në thellësi vetëm prej televizionit *NEWS 24*, kryesisht në edicionet informative të lajmeve dhe në programin *Vila 24*. Si rrjedhojë e sensibilitetit mediatic të krijuar, procesi legjislativ u ndërpre për të rifilluar sërish në muajin maj 2007, këtë herë pasi të ishte pasuruar edhe me sugjerimet e parashtruara nga ekspertët vendas.

Dallime midis shoqatës joqeveritare dhe grupeve të interesit

Por le të kthehemi tek emisioni i datës 7 dhjetor 2006. Profesor Artan Fuga, ndërkohë që e ndiqte këtë emision për ta studiuar, bëri komentin se i dukej e çuditshme që brenda një emisioni të strukturuar si intervistë të vinin njëherësh dy zonja që përfaqësojnë dy aktorë socialë, Komitetin e Helsinkit dhe Ministrinë e Brendshme, që në këtë rast specifik përbëjnë edhe dy palë në njëfarë konflikti. Aq më tepër

që ato, secila në kohën e vet të transmetimit, thonë pikëpamjet dhe opinionet e tyre, por nuk debatojnë dhe kundërshtojnë me njëra-tjetrën. Duken më shumë në marrëdhënie miqësore, e shumta mund të kenë ndonjë ndarje në nuanca konceptuale, por kurrsesi nuk duken si dy përfaqësuese të grupeve të ndryshme të interesit.

Këta po, ata «përplasen» për interesat e tyre dhe dëshirojnë, së paku në televizion, që të dallohen mirë në publik prej njëri-tjetrit. Është shumë e rrallë që në televizionet e botës së zhvilluar të ndodhë që dy aktorë konfliktualë interesi për një çështje të caktuar të vijnë në një orë mëngjesi, në një emision-intervistë, së bashku. Kjo dëshmon që grupet e interesit në Shqipëri, vazhdon profesor Artan Fuga, nuk e kanë përfunduar ende atë proces të domosdoshëm veçimi dhe konsolidimi. Parë nga kjo pikëpamje, jo thjesht nisur nga ky detaj televiziv, është e udhës të mendohet pak më thellë lidhur me një opinion të përhapur edhe nga media, sipas të cilit shoqëria civile, shoqatat joqeveritare, jofitimprurëse, që veprojnë me shumë përkushtim, shpesh edhe me efikasitet për forcimin e shtetit të së drejtës dhe të demokracisë, dhe grupet e interesit janë e njëjta gjë.

Midis një grupi interesi dhe një shoqate jofitimprurëse si aktor i rëndësishëm i shoqërisë civile ka një dallim shumë të madh. Jo medoemos një shoqatë jofitimprurëse është edhe një grup interesi. Një grup interesi është veçanërisht një bashkim vullnetar individësh të cilët në veprimtarinë e tyre sociale, në jetën e tyre të përditshme, në ushtrimin e të drejtave të tyre ekonomike, pronësore, fetare, etnike, etj, duke rrezikuar t'i shohin interesat e tyre të dëmtuara përpiken me të gjitha mjete dhe mënyrat demokratike të shndërrohen në grupe presioni, qendra promovimi mediatik apo subjekte nismash ligjore, sociale, etj, për t'i pohuar e zgjeruar këto të drejta.

Nisur nga ky përkufizim mund të thuhet se grupet e interesit shpesh nuk janë vetëm realitete institucionale, por përbëjnë edhe masa njerëzish të strukturuar nga një identitet i caktuar dhe me një organizim të caktuar. Në grupet e interesit liderët e tyre janë pjesë e

anëtarëve të grupit me identitet dhe status të drejtpërdrejtë që lidhet me atë interes. Kurse në një shoqatë joqeveritare e jofitimprurëse shpesh liderët e saj nuk janë të prekur drejtpërdrejt nga interesi që ata përfaqësojnë. Në këtë rast të fundit, ta zëmë, drejtuesja e një shoqate për mbrojtjen dhe integrimin shoqëror të grave të dhunuara si rregull nuk është vetë ajo një grua e dhunuar. Kurse po të ishte një grup interesi, në këtë rast kishte gjasa dhe do të ishte normale që një grua e dhunuar të ishte themeluesja dhe drejtuesja e një grupi interesi të përbërë nga gratë e dhunuara.

Për rrjedhojë, shumica e drejtuesve të shoqatave jofitimprurëse si aktorë të shoqërisë civile kanë prirjen të jenë intelektualë, përgjithësisht pedagogë, pra njerëz të dijes dhe të gojës, a të lapsit. Ata dinë të reagojnë intelektualisht, por kanë shumë më pak aftësi për të qenë militantë popullorë dhe prijës grupesh të vërtetë presioni. Orientimi i tyre në jetë përgjithësisht është me natyrë intelektuale, ndërsa liderët e grupeve të vërteta të interesit veprojnë edhe me forcën e zakonit, me presionin e pasionit, me qëndrueshmërinë e kujtesës kolektive dhe të vuajtjes, me vendosmërinë e mbrojtjes së interesave personale dhe të grupit. Veprimi i tyre është shumë radikal, shpesh edhe i manipulueshëm dhe i pakontrollueshëm.

Duke u rikthyer tek emisioni në fjalë, të cilin ia kisha kushtuar projektligjit të ri për Policinë e Shtetit, vihet re se përfaqësuesja e shoqërisë civile ngre problemin se projektligji ka vajtur në komisionin përkatës, atë të Sigurisë Kombëtare, pa u lajmëruar dhe thirrur në konsulta shoqatat dhe grupet e interesit që veprojnë në këtë fushë.

Në fakt është një shërbim i rëndësishëm që i bëhet shoqërisë, kur një rrjet shoqatash kryejnë me seriozitet dhe me përgjegjësi rolin e një antene që nuk lejon që çështje të rëndësishme të shoqërisë të kalohen disi në heshtje dhe jo në mënyrë transparente. Sot për sot në Shqipëri këtë rol nuk ka kush ta luajë tjetër. Edhe media shpeshherë vihet në alarm pikërisht prej këtyre organizatave joqeveritare.

Kur është fjala për Policinë e Shtetit, dhe kjo është karakteristike

e shqetësimit shoqëror, për policinë si një instrument për mbrojtjen e rendit publik dhe luftën kundër kriminalitetit, shoqatat joqeveritare, përpos interesimit që ajo të ketë kuadrin ligjor të nevojshëm për të vepruar në përmbushje të funksionit të saj, kanë edhe një merak tjetër, ndoshta më të madh. Është një merak që e kanë të gjithë aktorët civilë kudo në botën e zhvilluar. Është fjala që policia duke luftuar krimin të jetë e përmbajtur dhe të mos shkelë normat e jetës demokratike dhe të drejtat dhe liritë qytetare, as hapësirën personale dhe private të qytetarit dhe të familjes së tij. As të zëvendësojë pushtete të tjera sikurse janë drejtësia apo të kryejë veprime arbitrare dhe të pabazuar në ligj.

Duhet thënë se në vendet post-totalitare dhe me një edukatë jo shumë të qëndrueshme e të rrënjosur demokratike në radhët e policisë – rreziku i arbitraritetit policor është më i madh se gjetiu. Nuk është e tepërt të mendohet edhe për të drejtat e të dënuarve apo të ndaluarve që qëndrojnë nën administrimin e policisë, derisa paraqiten përpara organeve kompetente. Kanë arsye që interesohen lidhur me këtë temë, sepse askush nuk imagjionon dot që shteti nuk ka kujdes t'i japë policisë të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta luftuar kriminalitetin dhe ruajtur rendin publik. Ndërsa shoqëria ka vend të mendojë me përparësi për ta ruajtur veten nga ruajtësit e saj.

Në këtë kuadër qëndrimi i Vasilika Hysit, si dhe i nëntë organizatave të tjera në mbrojtje të të drejtave të njeriut është shumë dobiprurës.

Lidhur me policinë trajtimi i problemit të luftës kundër korrupsionit është tepër i ndërlikuar, sepse përmban një karakter të dyfishtë. Nga njëra anë qëndron problemi se si policia të jetë një instrument efikas për t'i goditur dukuritë korruptive apo që janë në themel të tyre si trafiket e ndryshme, vjedhjet, grabitjet, pa e dobësuar këtë luftë nën presionin e forcës së parasë.

Ana e dytë ka të bëjë me një problem tjetër. Si të luftohen shfaqjet e korrupsionit brenda vetë policisë. Dhe këtu nuk është fjala vetëm

për korrupsionin financiar, domethënë të rasteve kur punonjës të ndryshëm policie zhyten në korrupsion dhe blihen nga bota e krimit dhe e ilegalitetit. Por edhe lidhur me atë kur ata në kundërshtim me ligjin abuzojnë me kompetencat e tyre në dëm të lirive dhe të drejtave qytetare.

Nga njëra anë ka rëndësi lufta kundër krimit të organizuar, deklaroi Vasilika Hysi, por nga ana tjetër është me po aq rëndësi edhe respektimi i të drejtave dhe lirive qytetare.

Këtij qëndrimi në thelb parimor ajo i bashkëngjiti edhe vërejtjet e saj për tekstin e projektligjit të paraqitur për Policinë e Shtetit. Ka shumë nene, shprehet ajo, që lejojnë mundësi interpretimi të ndryshëm, çka sjell paqartësi dhe nesër mund të sjellë edhe keqkuptime të thella nga ana e punonjësve të policisë. Në disa nene ndihet prirja për të anashkaluar kërkesat e procedurës penale, e veçanërisht rolin e prokurorit, çka mund të bëhet vetëm në raste flagrante. Edhe kur është fjala për të reaguar ndaj arbitrariteteve që mund të kryejnë punonjës të ndryshëm policie, projektligji - kundërshton Vasilika Hysi - nuk duhet të parashikojë ankimim tek prori i tij, por në prokurori.

Kompetencat profesionale të aktorëve të shoqërisë civile

Le të kthehemi edhe një herë tek emisioni *Vila 24* i datës 5 dhjetor, ku i ftuar ishte Sotirag Hroni, drejtor ekzekutiv i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Është një nga aktorët më aktivë të shoqërisë civile. Ky institut ka bërë një sërë studimesh dhe promovimesh për probleme të pushtetit lokal dhe të decentralizimit të tij.

E pyes drejtpërdrejt duke e lidhur këtë emision me aktualitetin. Ai e nis duke thënë se sot, tani që jemi duke folur, zëvendësministri i Brendshëm, zoti Gjergj Lezhja, është duke mbrojtur projektligjin mbi policinë përpara Komisionit Parlamentar të Ligjeve.

Lidhje e menjëhershme me aktualitetin e ditës. Kjo është një detyrë për gazetarin. Nuk i shpëton dot. Kronika, lajmi, mundësisht edhe intervista apo biseda në studio ka vend që të jenë në një koherencë sa më të plotë midis tyre.

E pyes se sa e gjen Sotiraq Hroni të maturuar projektligjin për Policinë e Shtetit.

I ftuari bën një hyrje që duket se është plot politesë dhe modesti, por që në fakt, po ta shohësh nga këndvështrimi i analizave të bëra pak më sipër, del se aty paraqitet një problem i qenësishëm lidhur me punën e faktorëve dhe aktorëve të shoqërisë civile.

Sotiraq Hroni nis të thotë se ai nuk është ekspert për të kapur të gjitha aspektet e ligjit. Frazë interesante dhe e gjetur. Në mënyrë delikate ai i thotë audiencës se nuk është as polic dhe as specialist i punëve të policisë. Është një aktor i shoqërisë civile. Me sa duket kjo ka rëndësi për të, sepse kuptohet, që të paraqitet përpara publikut si pjesë e tij dhe jo e policisë – ka rëndësi të madhe.

Ai përfaqëson publikun dhe jo policinë.

Pastaj me këtë hyrje ai zgjidh edhe një problem tjetër, pra vendos një gardh mbrojtës përpara kritikëve që mund të kërkojnë përjasje profesionale prej tij. Mirëpo nuk është vetëm kjo anë. Ka edhe një pjesë të singertë e të drejtpërdrejtë në fjalët e të ftuarit. A ka mundësi që një shoqatë joqeveritare të ketë specializimin dhe profesionalizimin e mjaftueshëm për të përballuar çështjet që dëshiron të trajtojë dhe të marrë përsipër?

Shoqata që drejtohet nga Sotiraq Hroni është nga më prestigjiozet dhe nuk e ka këtë problem. Lidhur me decentralizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal ajo ka dhënë dhe jep një zë të emancipuar për ta çuar procesin sa më përpara. Pra, nuk është lidhur me të që ngrihet problemi.

Sigurisht që një sindikatë punonjësish të policisë, gjykatësish, avokatësh, etj, dhe pse jo, edhe një shoqatë ish të dhunuarish nga forcat e rendit, apo edhe ish të persekutuarish politikë nga regjimi

komunist, shoqata e kryetarëve të bashkive, e kështu me radhë jo vetëm do të ishin grupe të vërteta interesi të interesuara për një ligj sa më demokratik për policinë, por edhe për një ligj që të parashikonte një bashkëpunim sa më të mirë të saj me komunitetin dhe pushtetin lokal. Performanca e tyre profesionale nuk do të vinte prej faktit se ata kanë kompetenca teknike apo njohurish të specializuara, por nga përvoja e jashtëzakonshme dhe kredibiliteti i fjalës së tyre bazuar në moralin e njohjes së drejtpërdrejt të çështjes. Mbi këtë bazë ata do të kishin mundësinë e punësimit edhe të specialistëve për trajtimin e çështjeve që u interesojnë.

Në fakt, Sotiraq Hroni ngre me shumë kompetencë problemet e marrëdhënieve midis pushtetit lokal dhe Policisë së Shtetit. Mbi këtë bazë ai shpreh kritikën e tij se përse është hequr kapitulli mbi bashkëpunimin midis policisë dhe pushtetit vendor. Lidhur me këtë është impresionant edhe fakti se ai flet për një koncept që pak njihet në publik, ai i «policimin në komunitet». Patjetër, thotë ai me të drejtë, duhet normativizuar ky bashkëpunim, sepse kompetencat për jetën në komunitet i ka pushteti lokal, si atëherë kur është fjala për mirëmbajtjen e rrugëve, dritave, etj, ashtu edhe për probleme të tjera.

Si do të jetë efikas shërbimi i policisë në komunitet, kur nuk parashikohet me ligj bashkëpunimi i saj me pushtetin vendor?

Përse ndodh që politikani të jetë më kritik se aktorët e shoqërisë civile?

Kjo pyetje vjen menjëherë ndër mend, kur rishikon për të analizuar një edicion të emisionit *Vila 24*, në të cilin ishte ftuar politikani Petro Koçi, nënkryetar i grupit parlamentar socialist, ish-ministër i Brendshëm për një periudhë kohe përgjatë qeverisjes socialiste, aktualisht nënkryetar i Komisionit Parlamentar të Sigurisë.

Ai është në studio për të trajtuar të njëjtin problem, procedurat e aprovimit të projektligjit mbi Policinë e Shtetit.

Në fakt, rrjedha e bisedës ikën nga kjo temë për t'u zgjeruar më shumë e duke cekur në përgjithësi raportin në mes policisë dhe shoqërisë, si dhe domosdoshmërinë e profesionalizimit të saj.

Petro Koçi është tepër kritik ndaj disa aspekteve themelore të projektligjit në fjalë. Nuk është thjesht çështja e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive qytetare që i intereson në këtë mes. Ai mendon se ka një rrezik politizimi të policisë, për shkak të një prirjeje që sipas tij ekziston dhe që konkretizohet në dëshirën për t'i mbushur radhët e drejtuesve të policisë të niveleve të ndryshme apo edhe të vetë punonjësve të policisë me militantë. Kjo vjen në gjykimin e tij si rezultat i dëshirës për ta pasur policinë nën kontrollin e politikës partiake, por edhe për të plotësuar nevoja dhe premtime elektorale të dhëna përgjatë fushatave e që kanë lidhje me punësimin e përkrahësve të partive në qeverisje. Mungesa e profesionalizmit lidhet pikërisht me këto dy elemente. Pastaj largimi nga profesionalizimi i hap rrugën një shërbimi policor joefikas, korruptimit të punonjësve të ndryshëm të policisë, si dhe rritjes së shkallës së kriminalitetit.

Ai gjykon se fakti që për t'u emëruar drejtor i përgjithshëm i policisë, sipas projektligjit kërkohen vetëm dymbëdhjetë vjet përvojë në radhët e policisë, është krejt i pamjaftueshëm. Kështu mund të bëhet drejtor i përgjithshëm kushdo. Kushdo do të duhej ta konsideronte si një dhuratë këtë emërim, por jo edhe të merituar me punën dhe kompetencat e tij. Në fakt, sipas Petro Koçit, do të duhej të ishin parashikuar edhe kritere të tjera që kanë të bëjnë me kompetencat, me arsimimin, me arritjet në punë, etj.

Brenda caqeve të mendimit politik, Petro Koçi zhvillon pikëpamjen se kur ishte ministër, kishte ndaluar që militantët të hynin në shkollën e policisë pa kriteret e mjaftueshme, si dhe nuk kishte pranuar që ata të mbushnin radhët e policisë duke mos pasur formimin e duhur.

"Kujt i duhet një polici me militantë?" – pyet me të drejtë Petro Koçi.

Sidoqoftë kuadri i mendimit politik i imponon edhe atij që periudhën kur drejtonte vetë ta konsiderojë nën një këndvështrim pozitiv, ndërsa periudhën e qeverisjes së vendit nga rivalët e tij politikë ta paraqesë me ngjyrat më të errëta.

“Është rritur konfliktualiteti” – shprehet ai. “Mjafton të shohësh kryeministrin si flet dhe e kupton se përse ka ndodhur kjo dukuri. Krimet janë rritur dhe kjo duket në mbushjen e kronikave të zeza. Ajo nuk lidhet me gjendjen e varfërisë ekonomike të shqiptarëve, - thekson Petro Koçi, - por shpjegohet me *atë racë morale* (njerëzish) që po hyn në polici.”

Është qartazi e dallueshme që përveç paraqitjes bardh e zi të gjendjes, e detyrueshme kjo prej natyrës së mendimit politik, vihet re se prirja kritike e ligjëritit të politikanit është shumë më e ashpër se ajo e përfaqësuesit të shoqërisë civile.

Duke u nisur nga rasti konkret mund të pyetet se përse ka gjasa që të ndodhë kështu?

Ndoshta prej shkakut se politikanin i dalë në mediat televizive ka nevojë ta forcojë «dorën» mbi penelin me të cilin ai pikturon tablonë e gjendjes reale. Është i detyruar ta bëjë këtë, për shkak se do të tërheqë vëmendjen e elektoratit të tij, të justifikojë shpresat që ky elektorat ka tek ai dhe mbi të gjitha të ndikojë me forcën e tij bindëse tek elektorati i lëkundur, indiferent, apo pasiv.

Profesor Artan Fuga na thotë, duke u bazuar te punimet shkencore të sociologut amerikan të mediave Robert Merton, se shpeshherë taktikat dhe strategjitë e bindjes së publikut, qëndrojnë dhe bazohen te paraqitja e problemit në formën e një skandali.

“Ajo që ndodh është një skandal, unë jam i vetmi që e di zgjidhjen e problemit i cili po nuk u trajtua kështu sikurse e trajtoj unë, mund të prodhojë një katastrofë.”

Kjo quhet gjuha e skandalit të cilën politikanin e përdor në funksion të bindjes së turmës së elektoratit.

Nga ana tjetër, politikanin ndihet edhe komfort në pozicionet

politike që mban. Atij jo vetëm i duhet të jetë radikal në kritikën e politikave të qeverisjes, por edhe i ka të gjitha mundësitë për të qenë i tillë. I mbrojtur ekonomikisht, ai dhe familja e tij jetojnë në një të njëjtin rreth me individët qeveritarë që kritikon, të cilët i njeh shumë mirë dhe e njohin shumë mirë. Askush nga ata nuk ia merr seriozisht ligjërimin e vet tepër kritik.

«Flet ashtu, se është në opozitë.» Dhe me kaq mbaron gjithçka.

Rivalët e tij në politikë e dinë shumë mirë se kur të ndërrohen rolet, opozitari do të jetë në qeverisje dhe ai që është sot në qeveri do të jetë në opozitë. Edhe sensi i fjalëve do të bëjë një rrotacion. Pra, politikanët nuk ia marrin për keq njëri-tjetrit, prandaj edhe qeshin, janë hokatarë dhe zbavitën, edhe kur lëshojnë ndaj njëri-tjetrit fjalë të hidhura, gjithë helm. Spektatori që i dëgjon kujton se po bëhet hataja, por ai duhet ta dijë se ato sharje, mallkime, akuza, nuk janë veçse pjesë e një ligjërimi politik, që riprodhon klasën politike ashtu sikurse është.

Klasa politike ka nevojë që ta sensibilizojë, shokojë, tronditë, drithërojë elektoratin që ky të mos e harrojë politikën, që ky të mendojë se ajo është vërtet një çështje serioze, se aty vendosen fatet e tij dhe se anët e skenës politike janë të ndara në mënyrë radikale. Sa më e konfliktuar të jetë politika, aq më bosh dhe e kotë është përmbajtja e saj. Një politikë me mesazhe solide nuk ka nevojë të jetë konfliktuale.

Por politikani nganjëherë di edhe shumë më tepër gjëra sesa përfaqësuesi i shoqërisë civile. Shumë institucione dhe hallka të pushtetit ai i ka njohur si veprojnë në praktikë dhe nuk i njeh vetëm në letër, apo sipas parimeve formale të funksionimit të tyre. Shumë gjëra që përfaqësuesit të shoqërisë civile i duhet t'i zbulojë pas një pune shumë të mundimshme, politikani i ka të jetuara dhe të përjetuara.

Pastaj edhe një faktor tjetër. Politikani është shpeshherë më i pavarur se aktori i shoqërisë civile në raportet e tij me administratën.

Ai nuk ka nevojë për administratën e shtetit për të mbijetuar. Kurse përfaqësuesi i shoqërisë civile, edhe në rastin e një drejtuesi të një shoqate jofitimprurëse, joqeveritare, ka nevojë të ketë partneritet me dikasterin që mbulon fushën ku vepron, përndryshe projektet e tij rrezikojnë të dështojnë. Në këtë mënyrë gjuha zbutet.

MORALI POLITIK DHE KORRUPTIMI I VLERAVE

Problemi i përballjes me dukuritë e korrupsionit nuk është thjesht një çështje që ka lidhje vetëm me ekonominë, me pasurimin ilegal, apo me trafiqet e ndryshme. Mund të korruptohet veprimtaria e aktorëve ekonomikë, politika, shteti, si dhe morali politik. Pavarësisht se në emisionet e *NEWS 24* kjo çështje nuk është trajtuar më vete si një temë e mirëfilltë, përsëri ka dalë në pah. Dhe nuk mund të mos dilte përderisa cilado veprimtari njerëzore në fund të fundit, që të legjitimohet sadopak, ka nevojë të udhëhiqet nga koncepte që dallojnë sipas tyre të mirën nga e keqja. Pra, ka nevojë për një moral.

Cili është ky moral në shoqërinë shqiptare?

A ka kuptim të flasim për një moral të njëjtë në të gjitha fushat?

Përse flitet kaq shumë se ka një korruptim të vlerave morale?

A mund të bashkëpunohet me një ish-kundërshtar?

Në datën 21 nëntor 2006, në emisionin *Studio 24* janë mbledhur Nard Ndoka i Partisë Demokristiane, Erion Braçe, deputet e Partisë

Socialiste, si dhe Skënder Gjinushi i Partisë Socialdemokrate.

Gazetari hap temën e marrëdhënieve midis politikës dhe moralit korruptiv. Fjalën e ka sidomos për lidhjen midis aleancave politike dhe vlerave morale që duhet t'i legjitimojnë ato.

Është e kuptueshme që deputetët e opozitës të jenë kritikë ndaj politikave dhe aleancave qeveritare. Sipas Erion Braçes, koalicioni qeveritar i formuar nga 10 parti politike është i pamoralshëm politikisht, sepse gjithë këto grupime nuk kanë programe që mund të puqen aq kollaj me njëri-tjetrin.

Këtë e mbron si ide edhe Skënder Gjinushi i cili niset nga fakti se brenda koalicionit qeveritar ka programe me objektiva krejt të kundërta. Kështu për shembull, thotë ai, në këtë koalicion janë bashkuar në një front ruajalistët (e ka fjalën për Partinë Lëvizja e Legalitetit) dhe republikanët (e ka fjalën për Partinë Republikane të drejtuar nga ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu).

Të dy vënë në dukje si një fenomen të papranueshëm nga morali faktin që në këtë koalicion qeveritar bën pjesë edhe Partia Agrare-ambientaliste e kryesuar nga Lefter Xhuveli, si ministër i Mjedisit në qeverinë e Sali Berishës. Erion Braçe vë në dukje faktin se kur është fjala për Lefter Xhuelin, nuk duhet të harrojmë se ai për disa vite me radhë, sa kohë ka qenë ministër i Partisë Socialiste, është akuzuar nga Sali Berisha, atëherë në opozitë, si baritoni i ansamblit «Babëzia». Kurse tani, pas disa vjet sulmesh dhe akuzash për korrupsion Lefter Xhuveli jo vetëm pranohet në koalicionin e partive të shumicës qeverisëse, por merr edhe një post brenda qeverisë.

Ndërkaq, në këtë rast Skënder Gjinushi tregohet më i përmbajtur. Ai tregon se këtu mungesa e moralit qëndron te fakti se Lefter Xhuveli deri dje konsiderohej si kundërshtar politik i Partisë Demokrate dhe i Sali Berishës, ndërsa tani që ka pranuar të bashkëpunojë me ta, pranohet si aleat.

Duket se qëllimi i të dy deputetëve të majtë në studio është të transmetojnë idenë se qëndrimi politik i qeverisë dhe i partive

të shumicës nuk është aq i moralshëm sa trumbetohet. Në këtë mënyrë ata përpiqen të kundërvihen ndaj ligjërimin politik të Partisë Demokratike, sipas të cilit aksioni politik i kësaj partie dhe i qeverisë udhëhiqet nga një moral i ushqyer nga vlerat e transparencës, sinqeritetit, luftës kundrejt padrejtësive, pricipaliteti, ndershmëria, largimi nga qëndrimet pragmatike dhe konjukturale. Ata përpiqen të përballojnë gjithashtu akuzat që kryetari i Këshillit të Ministrave dhe i Partisë Demokratike u ka bërë drejtuesve të opozitës, sipas të cilave kur ishin në pushtet, ata kishin qenë të mbërthyer nga dukuri dhe interesa korruptive.

Taktika është e qartë:

Kush mund të akuzojë të tjerët për një moral korruptiv, kur vetë nuk ka një moral politik të paqortueshëm dhe bën aleancë pikërisht me ata që i konsideronte si kundërshtarë të tij dhe të korruptuar dje?

Në fakt, profesor Artan Fuga këmbëngul se logjikisht kjo lloj strategjie retorike nuk qëndron. Kritikën ndaj dikujt mund të jenë të vërteta edhe kur ai që i formulon ato është një njeri pacen në moralin e tij, por mund të ndodhë edhe që ato kritika të jenë dhe të mbeten po aq të vërteta, edhe kur formuluesi i tyre akuzohet prej të tjerëve se ka mbajtur edhe ai qëndrime politike moralisht jo fort të qarta.

Duke u mbështetur te psikologu dhe filozofi Gustav Le Bon, profesor Artan Fuga shpjegon se të folurit në televizion, edhe kur bëhet në studio, është gjithmonë një i folur përpara një mase të madhe njerëzish, pothuajse përpara një turme. Politikani e kupton me intuitë një gjë të tillë. Ai flet përpara gazetarit me fytyrë të drejtuar nga kamera, por e di se në atë çast e shohin dhe e dëgjojnë qindra mijëra njerëz. Kjo masë njerëzish e gjykon politikën me kriteret e veta të një morali personal dhe familjar, i cili nuk mund të funksionojë në politikë. Ai që shahet një herë nuk mund të bëhet partner në bashkëpunim. Fjala e thënë nuk ndërrohet. Kundërshtari

nuk bëhet aleat. Dy njerëz me ide të ndryshme nuk mund të bëjnë aleanca politike të përbashkëta. Ndaj çdo njeriu duhet mbajtur një qëndrim i nisur dhe i frymëzuar nga të njëjtat parime dhe kritere. Pushteti nuk është një mjet për ta përdorur si qëllim në vetvete, por për të mirën e bashkësisë. Këto janë disa parime morale me të cilat është rritur qytetari me nivel arsimim mesatar dhe që i ruan të shenjta që nga fëmijëria e tij. Besnikëria ndaj fjalës së dhënë, mbajtja e fjalës, dhënia e fjalës, mosndarja e fjalës nga veprat, janë të gjitha vlera që kanë një lloj rëndësie në jetën e përditshme familjare dhe në shoqëri.

Këtë e shfrytëzojnë të gjithë udhëheqësit e turmave, shkruan Gustav Le Bon. Ata i drejtohen masës duke u përpjekur të flasin gjuhën e saj. U drejtohen paragjykimeve të saj. Përpiqen të ngjallin pasionet e saj. Dhe e gjitha kjo për t'u bërë të besueshëm dhe për ta tërhequr masën drejt vetes.

Ndërkaq, politika nuk mund t'u bindet të njëjtave ligjësi morale. Një qëndrim që në planin e moralit të zakonshëm dhe të përditshëm do të quhej i papranueshëm etikisht, në politikë, si një sferë tjetër e veprimtarisë njerëzore, me tiparet e veta specifike, mund të konsiderohet si i pranueshëm moralisht. Njihen pa fund raste, shprehet profesor Artan Fuga, kur kundërshtarë politikë kanë bërë aleanca të fuqishme midis tyre, ose kur atij që i janë hedhur mbi kurriz akuza dhe sharje pafund i shtrihet dora e bashkëpunimit dhe që nga ky çast ai konsiderohet si i moralshëm, i drejtë dhe i frekuentueshëm.

Ky diskutim u hap në publik me një intensitet të fuqishëm në Shqipëri me rastin e takimit midis Sali Berishës dhe Fatos Nanos në Pallatin e Brigadave në muajin janar 2007. Të dy ata, një ditë përpara firmosjes së marrëveshjes midis partive politike lidhur me standardet e zgjedhjeve të 18 shkurtit 2007 për pushtetin lokal, u takuan dhe u bënë thirrje partive politike për ta zhbllokuar krizën politike, e cila rrezikonte ta shpërbënte kuadrin ligjor të vendit.

Nga pikëpamja e një këndvështrimi moral, politikanët dhe analistët në shtyp dhe në media televizive u ndanë në dy grupe të mëdha. Kështu ndodhi edhe në emisionet e televizionit *NEWS 24* për të cilat po flasim. Nga radhët e opozitës pati politikanë dhe analistë të mediave pranë saj që e konsideruan këtë takim si një akt moral të papranueshëm, sikurse nga politikanë dhe deputetë të shumicës qeverisëse e konsideruan si një kompromis të bërë me realizëm në emër të nxjerrjes së vendit nga kriza politike që e kishte mbërthyer atë. Në këtë kuadër, përfaqësuesit e së majtës e quajnë një akt moral të papranueshëm faktin që Sali Berisha takohet me Fatos Nanon, me atë që për vite me radhë e ka akuzuar për korrupsion dhe biznese të paligjshme. Sipas tyre, kjo tregon se fjalët e thëna prej tij ose nuk kanë qenë të vërteta, ose konsiderohen si të pavlera për shkak të një qëllimi praktik për t’u arritur. Kur Sali Berisha u shpreh se ato akuza që kishte hedhur për Fatos Nanon duheshin konsideruar si të thëna në kuadrin e fushatave propagandistike elektorale, kjo e acaroi edhe më shumë kampin politik dhe mediatik të majtë. Prej tyre u konsiderua se kështu pranohet dhe legjitimohet që gjithçka që thuhet në kohë fushatash elektorale është false dhe nuk duhet besuar.

Morali politik pëson një zvetënim.

Besimi i popullsisë kundrejt politikës lëkundet nga themelet.

«Moral i elektorali»

Në të njëjtin emision televiziv të së njëjtës datë, dëshiroj ta thelloj edhe më shumë problematikën që kam shtruar qysh në fillim. Pyes të ftuarit në studio:

A është e moralshme t’i bësh thirrje elektoratit tënd të votojë për kandidatët e një partie tjetër?

Pyetja vjen paksa e befasishme dhe ndoshta i gjen disi të

papërgatitur të ftuarit që marrin pjesë në bisedë. Kjo ndodh për shkak se të gjithë ata, përgjatë fushatave elektorale të mëparshme, ose i kanë ftuar zgjedhësit që bëjnë pjesë në elektoratin e tyre të votonin për kandidatë të partive të tjera, ose kanë përfituar nga thirrje që parti të tjera u kanë bërë zgjedhësve të tyre për të votuar për ta. E gjitha kjo ka ndodhur përgjatë atyre strategjive politike dhe elektorale, që kanë marrë emrin «Dushk». Partitë e vogla ftojnë elektoratin e tyre për të votuar në mazhoritar për kandidatët e partive të mëdha, që si rregull dalin drejtpërdrejt nga zonat zgjedhore, kurse partitë e mëdha shpesh i bëjnë thirrje elektoratit të tyre për të votuar në proporcional për partitë e vogla aleate të tyre, nga ku dalin edhe deputetët e partive të vogla.

Gazetari ka të drejtë ta bëjë këtë pyetje. Në bazë të një morali të përditshëm ose një këndvështrimi pastërtisht moral të politikës, edhe këtu do të kishim një degradim dhe korrupsion të vlerave morale. Në gjykimin e një morali të mbështetur në këndvështrime të zakonshme duket paksa e pabazuar që edhe të kërkosh që elektorati yt të të ndjekë, por edhe në çastin e fundit t'i kërkosh atij që të votojë për kandidatët e një partie tjetër. Në këtë mënyrë vullneti politik nuk shprehet qartazi. Aq më keq ka një lloj zhgënjimi nga ana e elektoratit i cili detyrohet të ndjekë vullnetin e lojërave politike të partive të ndryshme.

Pyetja u drejtohet të tre të ftuarve në studio, por Nard Ndoka e gjen me vend të mos përgjigjet, për shkak se deri në çastin e bërjes së pyetjes nuk është ai që ka predikuar një qëndrim moral në politikë.

Fjalën e merr Skënder Gjinushi i cili tani njeh dhe pranon specifikën e politikës në krahasim me sferat e tjera të marrëdhënieve shoqërore dhe të fushave të tjera të veprimtarisë.

«Kështu ndodh në dynja» - shprehet ai me një gjuhë popullore.

Është interesant ndryshimi i regjistrimit të të folurit tek Gjinushi. Kalimi për pak çaste në një gjuhë të foluri popullor lehtëson në

përgjithësi kalimin e argumentit si të vlefshëm dhe shkrin pengesat për të komunikuar në mënyrë të kuptueshme. Përdorimi i një zhargoni popullor nënkupton se për disa gjëra nuk ka nevojë të jepet argument.

«Kështu ndodh në dynja», pra flitet për një diçka që merret si fakt, e për rrjedhojë nuk ka nevojë të jepen argumente të stërholluara për të.

Skënder Gjinushi pranon këtu se politika ka nevojë për kritere të tjera morale. Ky nuk është një moral i përgjithshëm, ky është gjithsesi një «moral elektorale», përdor termin e ri ai. Kjo justifikohet pra me dinamikat politike. Atje ku partitë krijojnë aleanca midis tyre, rëndësi ka fitorja e përbashkët. Përpara humbjes, pra përpara faktit që elektorati ta shohë partinë e tij të humbur, nënkuptohet që më e leverdishme dhe e pranueshme do të ishte pragmatikisht një sjellje që do të nxirrte fitues jo një parti të caktuar, por të gjithë spektrin e aleancës midis partive politike në koalicion. E rëndësishme nuk është ruajtja e disa parimeve morale të ngurta, por gjithçka që sjell fitoren. Politika këtu, nënkuptohet në fjalët e Skënder Gjinushit, vepron sipas parimit qëllimi, fitorja pra, justifikon mjetin, taktika të ndryshme elektorale, që ndofta nuk janë në përputhje me konceptime popullore ose moraliste të politikës.

VËSHIRËSITË E AKTORËVE TË SHOQËRISË CIVILE

Nuk duhet harruar se aktorët e shoqërisë civile, në rastin tonë shoqatat joqeveritare dhe jofitimprurëse, nuk janë elementë «të rënë» nga qielli. Ato jetojnë, themelohen, veprojnë brenda një terreni të caktuar shoqëror, ekonomik dhe psikologjik që është yni.

Brenda tij këta faktorë veprues dhe të dobishëm shoqërorë japin një kontribut të pashoq për shëndoshjen dhe ekuilibrimin politik të shoqërisë, për përballjen e një sërë problemesh sociale, sikurse është edhe e keqja e korrupsionit, mobilizojnë opinionin publik përballë fenomeneve negative dhe ushtrojnë presionin qytetar mbi veprimtarinë e shtetit dhe të administratës së tij.

Ndërkohë dihet se edhe jeta dhe funksionimi i këtyre shoqatave ndjen vështirësitë e kohës. Në veprimtarinë e tyre edhe shoqatat e ndryshme jofitimprurëse, sado të pozicionohen në luftë kundër korrupsionit e të paraqiten si të njëanshme politikisht, me gjithë rolin e tyre të madh, ka prej tyre që njohin të gjitha ato vështirësi dhe mangësi.

Pas paanësisë politike të pretenduar ndodh që mbulohen influenca politike të prejardhura nga aktorë politikë të caktuar ose nga shteti.

Pas mbiemrit «jofitimprurës» nuk mungon që në raste të veçanta individë të dyshimtë të kamuflojnë një përpjekje për të grumbulluar sa më shumë fitime dhe fonde e që pjesërisht shkojnë për pagesa, honorarë dhe privilegje financiare të drejtuesve të caktuar.

Po fillon të vihet re, sidomos në periudha zgjedhjesh, se veprimtaritë e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile të cilëve nuk iu dëgjohet asnjëherë emri gjatë viteve ndërmjetëse, kur ushtrohet mandati publik i të zgjedhurve (midis legjislaturve) aktivizohen krejt papritur dhe interesat e tyre «përputhen» në mënyrë servile me interesat politike të çastit të partive që ushtrojnë influenca të ndryshme mbi to.

Me një fjalë, nuk mund të jesh në shoqëri dhe të jesh i painfluencuar prej shoqërisë.

Aktorë shoqërorë krejt të imunizuar nga dukuritë e tërheqjes pas interesit të ngushtë personal ose vetjak – është vështirë të gjesh.

Nuk ka aktorë shoqërorë të shenjtë.

Është vështirë ta mendosh botën sikur ajo është ndarë në politikanë, pushtetarë dhe administratorë të korruptuar, të gjithë në një thes, dhe nga ana tjetër e barrikadës përfaqësues të shoqërisë civile, të gjithë po në një thes, të gjithë të kulluar, të painteresuar, vullnetarë të idealeve të mëdha, që nuk kanë veçse një qëllim në jetë: të pastrojnë shoqërinë nga korrupsioni.

Vështirë ta mendosh shoqërinë shqiptare të ndarë në dy kampe pa lidhje dhe bashkëveprim me njëra-tjetrën, nga njëra anë shoqërinë civile dhe nga ana tjetër shtetin, politikën dhe administratën. Shteti, politika, administrata kanë zgjatime dhe ushtrojnë influencat e tyre mbi shoqërinë civile.

Profesor Artan Fuga pohon se, edhe nëse nuk do të themi si Niçja e Dühring-u se është shteti dhe politika që krijojnë shoqërinë civile dhe opinionin publik, se është shteti që i prodhon bile edhe revolucionet dhe kundërrevolucionet e veta, përsëri diçka mbetet e vërtetë për të thënë, që shtet më vete të kulluar dhe shoqëri civile

më vete të kulluar vështirë se ka.

Larg utopive të Lokut dhe Rusoit, marrëdhëniet midis këtyre faktorëve duken të strukturuar brenda një hapësire mikse dhe të ndërthurur, ku në vazhden e mendimit filozofik dhe politik të Aristotelit, Hobsit, Hanah Arendit, Rajmond Aronit apo Jyrgen Habermasit, mund të thuhet, sikurse del edhe nga analiza e këtyre emisioneve televizive, që shoqëria civile e prodhon politikën dhe shtetin, po aq sa shteti dhe politika e prodhon shoqërinë civile.

Që të dyja jetojnë në një bashkëveprim dhe ndërveprim të pandalur.

KAPACITETI REAGUES I SHOQËRISË CIVILE

Një nga treguesit më domethënës të ndërveprimit midis shoqërisë politike dhe shoqërisë civile është kapaciteti reagues i kësaj i të fundit. Madje, mund të thuhet pa frikë se ajo pjesë e shoqërisë civile që ka zhvilluar në këto vite të tranzicionit demokratik kapacitete reaguese ndaj problematikave që lidhen direkt ose indirekt me fushën e tyre të ekspertizës, përfaqëson sot edhe pjesën më vitale, shtyllën kurrizore dhe palcën e shoqërisë civile shqiptare në tërësi.

Kapaciteti reagues në kontekstin e këtij studimi duhet kuptuar si aftësia për të prodhuar qëndrime të cilat u adresohen institucioneve shtetërore ose/dhe publikut mbi aspekte të veçanta të proceseve demokratike apo dinamikave shoqërore në tërësi, të cilat ndikohen nga mënyrat e qeverisjes. Ky kapacitet reagues nuk nënkupton në këtë rast aktivitete të organizatave joqeveritare, të cilat janë përcaktuar për t'u zhvilluar në kuadër të plan-veprimeve të tyre dhe që janë detyrime kontraktuale ndaj donatorëve të ndryshëm. Në këtë rast do të kishim të bënim vetëm me atë që në terminologjinë teknike të sektorit njihet si «kapacitet implementues».

Kapaciteti reagues është aftësia për të përpunuar gjykime imediate brenda konteksteve mediatike apo të aktualitetit në tërësi, jashtë dhe përtej detyrimeve kontraktuale me donatorë. Ky lloj kapaciteti

përbën në thelb diferencën që karakterizon organizatat lider në sektorin joqeveritar dhe pjesës tjetër të organizatave. Po në këtë logjikë, kapaciteti reagues identifikon ata përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët ndërtojnë opinion në publik dhe/ose i përgjigjen interesimit publik si zëdhënës të këtij interesimi duke adresuar te politikbërësit dhe vendimmarrësit politikë me kompetencë dhe kurajë qytetare një problem specifik që mund të jetë verifikuar si rezultat i kombinacioneve të rrethanave të caktuara.

Gjatë implementimit të fazës së parë të këtij studimi që përkon me periudhën dhjetor 2006-shkurt 2007, pikërisht me mes të kësaj periudhe, vendi pothuajse u gjunjëzua nga një krizë shumë e thellë energjetike. Për të krijuar një ide mbi thellësinë e krizës, mjafton të mbajmë parasysh faktin se ajo po ndodhte në mes të dimrit, teksa vendi përgatitej të hynte në zgjedhje për pushtetin vendor (opozita kishte kërkuar shtyrjen e këtyre zgjedhjeve pikërisht për këto rrethana) dhe për më tepër, forca politike në pushtet kishte pasur si premtim thelbësor të saj pikërisht eliminimin një herë e mirë të një krize eventuale, e jo më të këtyre përmasave. Pra, aq e thellë ishte kjo krizë, sa edhe pse në prag të një palë zgjedhjesh lokale që duhet të certifikonin për mazhorancën e djathtë fitoren e saj politike të 3 korrikut 2005, rezultoi krejtësisht e pamundur për të që të sigurojë një zgjidhje, sado të sforcuar (çdo opsion i pakonsideruar për të zgjidhur krizën nga ana e qeverisë, ishte një opsion që do të prodhonte kosto elektorale imediate të rikuperueshme për mazhorancën).

Me fillimin e javës së dytë të janarit 2007, në *Vila 24*, për shkak të intensitetit të vet si program ku realizoheshin tri intervista mbi aktualitetin në ditë, mori kryesimin e debatit mediatic mbi krizën energjetike edhe në raport me televizionet e tjera. Të gjitha intervistat u orientuan drejt kuptimit të shkaqeve të kësaj krize kaq të thellë, shkaktarëve përgjegjës dhe orientimi ndaj zgjidhjeve të cilat synonin kapërcimin e krizës. Ishte një ambient i përsosur mediatic

dhe njëkohësisht studimor për të testuar kapacitetet reaguese edhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Ditën e hënë, datë 8 janar 2007, të ftuar në *Vila 24* kanë qene në tri fasha orare njëri pas tjetrit: Luigj Pjetri, ish-drejtor i përgjithshëm i KESH-it; Dritan Prifti, ish-drejtor i përgjithshëm i KESH-it; dhe Pajtim Bello, ish zv.ministër i Ekonomisë dhe Energjetikës gjatë kohës së qeverisjes së koalicionit të majtë para 3 korrikut 2005.

Një ditë më pas, të martën, kreu i Zyrës për Mbrojtjen e Qytetarëve, Kreshnik Spahiu, vjen në *Vila 24* menjëherë pas një proteste të ZMQ-së para KESH-it, nën sloganin «Tunde Belin!», duke aluduar në këtë mënyrë një kërkesë adresuar qeverisë për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm të Korporatës Elektronergjetike Shqiptare, Andi Beli. Në *NEWS 24* Kreshnik Spahiu ka qenë i qartë dhe i prerë në kërkesën e tij tek argumentoi në një intervistë prej 30 minutash përgjegjësinë që duhej t'i njihej drejtorit Beli për krizën e thellë energjetike dhe që duhej të pasohej menjëherë me shkarkimin e tij nga detyra. Në të njëjtën ditë, vetëm 30 minuta më pas, po në *Vila 24*, një tjetër përfaqësues i shoqërisë civile, njëkohësisht edhe gazetar, Lutfi Dervishi artikuloi të njëjtën kërkesë duke amplifikuar ZMQ-në.

Kriza po vazhdonte, madje vazhdonte edhe thellimi i mëtejshëm i saj me orë edhe më të zgjatura të ndërprerjeve të energjisë elektrike. Në datën 11 janar, në *Vila 24* vjen si i ftuar prej meje dr. Zef Preçi, drejtori ekzekutiv i Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike, ish-ministër i Ekonomisë, i cili ka bërë pa diskutim analizën më të plotë të shkaqeve që kishin gjeneruar krizën energjetike, identifikimin e personave përgjegjës dhe prognozën e ecurisë së mëtejshme. Bazuar në parimin e reduktimit të dëmit dhe në parimet e menaxhimit të krizës, Dr.Preçi kërkoi minimalisht nga drejtuesit e Korporatës informimin e publikut mbi oraret e ndërprerjes së energjisë. Ishte pa diskutim reagimi më i strukturuar nga pikëpamja e argumentimit të shkaqeve dhe pasojave që një përfaqësues i shoqërisë civile bënte

në kontekstin e krijuar. Përveç përfaqësuesve të lartpërmendur, asnjë tjetër nuk artikuloi në publik përgjegjësitë që binin mbi administratorët publikë sa i përket krizës energjetike.

Duke filluar që atë fundjavë (datë 12 janar, 2007) drejtori i përgjithshëm i KESH-it, Andi Beli, filloi të dilte në konferenca të përditshme për shtyp për të bërë me dije publikun mbi oraret e kufizimeve të energjisë elektrike. Disa ditë para zgjedhjeve të 18 shkurtit 2007, drejtori i përgjithshëm i KESH-it, Andi Beli, dha dorëheqjen.

Shoqëria civile, sa është impact-oriented?

Kapaciteti reagues në media si tregues nuk indikohet vetëm në përfaqësuesit e shoqërisë civile. Ai është një tregues i cili i aplikuar mbi administratën publike dhe shoqërinë politike në tërësi, indikon edhe sa *impact-oriented* janë veprimet dhe reagimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Rasti më tipik në kuadër të këtij studimi përfaqësohet nga Dr. Zef Preçi, Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike. Në datën 29 janar 2007 ai ka qenë i ftuar në *Vila 24* për të folur lidhur me disa gjetje që kishin rezultuar gjatë fazës së implementimit të titulluar: «Monitorimi i qëndrimit të administratës publike sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit», financuar në kuadër të Programit të Shtetit Ligjor, USAID. Nga të dhënat e rezultonte së 90% e qytetarëve të intervistuar perceptonin Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ZRPP, si tejet të korruptuara. Edhe më shumë se 90% pohonin se në këto zyra mund të mbarosh punë vetëm nëse paguan nën dorë. Nga ana tjetër, rezultonte se në raport me administratën publike dhe rregullat mbi bazën e të cilave ajo funksionon, qytetarët dispononin një kulturë të mangët. Rreth 25% e qytetarëve që kërkonin zgjidhje për problemet e tyre në administratën publike rezultonte se trokiste në derën e gabuar për të zgjidhur problemin. Megjithatë, kjo

kulturë e mangët kultivohej në mënyrë direkte apo indirekte nga vetë nivelet e ulëta të administratës, të cilat nuk përmbushnin ndër të tjera funksionin e informimit korrekt të publikut, duke ulur në këtë mënyrë performancën e institucionit ku vetë punonin dhe duke krijuar terren për lulëzim të fenomenit të rryshfetit, pra të zgjidhjes së halleve të qytetarëve me para nën dorë.

«Mosndëshkimi i praktikave korruptive në nivele të ndryshme të administratës është shtrati ku ngjizet dhe lulëzon korrupsioni.» Ishte ky konkluzioni të cilin theksoi në intervistën e tij në *Vila 24* Dr. Zef Preçi.

Nuk kaluan as 24 orë që për herë të parë në absolut, drejtoi i përgjithshëm i ZRPP-së, Edlir Vokopola, të reagoje me anë të një interviste ekskluzive në *NEWS 24* duke pranuar problemet e mprehta dhe korrupsionin që ekzistonte në sistemin e hipotekave. Po atë ditë, datë 30 janar 2007, dy zyrtarë të lartë të ZRPP-së Vlorë, Halit Rama dhe Devi Tushe, arrestohen nën akuzën e shpërdorimit të detyrës. Teksa në *NEWS 24* ritransmetohej rreth orës 17:00 intervista ekskluzive me drejtorin e përgjithshëm të Hipotekave, z. Vokopola, me titra në anë të ekranit jepej nën siglën «*Flash*» lajmi i arrestimit të dy zyrtarëve. Zyrtarë të tjerë vijuan të vendosën nën akuzë nga organi i prokurorisë edhe në Korçë e Kavajë. Drejtori Vokopola paralajmëroi një furtunë të vërtetë shkarkimesh në nivelet e para drejtuese në të gjitha Zyrat e Regjistrimit të Republikës, e cila në fakt vijoi me shkarkime në Shkodër.

Ky është një rast tipik jo vetëm i kapacitetit reagues dhe me impakt konkret i shoqërisë civile, por edhe shembulli tipik i rolit që ka media në maksimizimin e efektit të punës së shoqërisë civile në dobi të publikut, sidomos sa i takon faktimit të fenomenit të korrupsionit. Në kontekstin e duhur mediatik, pra në kohën e duhur dhe në vendin e duhur, efekte e gjeneruara maksimizohen dhe prodhojnë impakt korrekt, pra një vlerë të shtuar më të madhe sa i takon reputacionit në publik të përfaqësuesve të shoqërisë civile.

KOMUNIKIMI POLITIK DHE SHOQËRIA CIVILE

Përgjatë këtij ballafaqimi disamujor në studiot e televizionit NEWS 24, pikërisht në emisionin *Studio 24*, dhe më parë akoma në emisionin *Vila 24*, midis aktorëve të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të politikës, lidhur me temën e korrupsionit dhe të formave të çrrënjësjes së tij prej shoqërisë shqiptare bashkëkohore, janë shfaqur edhe disa karakteristika që i japin tiparet e veta specifike komunikimit politik të artikuluar nga shoqëria civile.

Ato mund të shërbejnë edhe si indikatorë për të vlerësuar performancat e çdo aktori të shoqërisë civile që ka shprehur mendimet dhe opinionet e veta brenda këtij projekti.

Le t'i analizojmë shkurtimisht këto karakteristika:

Shumëllojshmëria e formave të komunikimit

Është e qartë se komunikimi politik ka një efikasitet të jashtëzakonshëm në televizion. Ai atje është sa i çliruar nga peshat dhe inertitë e formave të tjera të komunikimit, aq edhe asimilohet mirë nga publiku. Të gjithë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare që kanë ardhur në studio duket se e kanë mbajtur mirë parasysht këtë.

Por, sikurse theksohet në teoritë e komunikimit dhe të informimit, që mesazhi të transmetohet me një rendiment të mjaftueshëm dhe me intensitetin që duhet, ka nevojë që secila formë kryesore komunikimi të shoqërohet me forma të tjera bashkëshoqëruese, të cilat përcjellin të njëjtin mesazh, por nëpërmjet metodave, teknikave dhe formave të larmishme dhe që nuk i ngjajnë komunikimit politik televiziv.

Mesazhi televiziv ka nevojë të transmetohet edhe me forma paralele komunikimi sikurse janë konferencat e shtypit, shpërndarja e fletëve-volante, afisheet e ngjitura anekënd qytetit, etj.

Ka rëndësi të madhe që këto strategji të ndryshme komunikimi të mos bien në kundërshtim me njëra-tjetrën qoftë në formë, qoftë në përmbajtje. Bie fjala, rastis të shohim nëpër qytet afishe që flasin për probleme ekologjike, që bëjnë thirrje për ta mbrojtur natyrën, ruajtur pemët, shtuar gjelbërimin e qytetit, afishe të bukura me plot kuptim, por që janë ngulur si mos më keq e kapur me gozhda a me thumba mbi trungje pemësh buzë trotuaresh. Dora e pakujdesshme ka bërë një punë mekanike dhe nuk e ka përvetësuar sa duhet përmbajtjen e mesazhit që përmban afishja. Forma dhe përmbajtja e mesazhit kanë rënë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Nga kjo pikëpamje duhet thënë se disa nga aktorët e shoqërisë civile bëjnë kujdes që të aktivizojnë të gjitha kanalet e mundshme për të transmetuar mesazhet e tyre në publik, kurse disa të tjerë mjaftohen vetëm me ndonjë ardhje sporadike në televizion. Kuptohet që kjo e fundit është më e thjeshta dhe mbi të gjitha që kërkon më pak mundim, talent, shpenzime financiare dhe materiale, vijnë falas dhe nuk përmban kokëçarjet e anës organizative që kanë format e tjera të komunikimit politik.

Sidoqoftë është një formë komunikimi e pamjaftueshme për të bindur opinionin publik për drejtësinë e çështjes që propagandohet apo që luftohet për t'u realizuar.

Një komunikim politik performant është kur ai bazohet mbi një shumësi kanalesh komunikimi, mediatik po se po, televiziv, radiofonik,

në shtypin e shkruar, por edhe në forma më tradicionale komunikimi, sikurse është komunikimi sy më sy, komunikimi në mbledhje publike, me afishe, etj.

Aftësia për të ndërtuar argumente bindëse dhe adresimi i qartë

Sado që të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile bëjnë kujdes që të jenë sa më të saktë dhe më të qartë në artikulimin e mesazhit të tyre mediatik dhe televiziv, jo të gjithë kanë aftësinë për të qenë të shkëlqyer në këtë veprimtari që kërkon veç përgatitjes profesionale, edhe njëfarë talenti të lindur.

Nga kjo pikëpamje ka rëndësi që komunikimi politik të jetë i qartë dhe me argumente konkrete.

E themi këtë, sepse ndonjëherë përfaqësuesit e shoqërisë civile, sikurse politikanë të ndryshëm, bien në një lloj kurthi. Ata kanë bindjet e tyre, kanë kohë relativisht të gjatë që jetojnë me idetë që duan të shtjellojnë në publik dhe ato në njëfarë mënyre u janë bërë një natyrë e dytë. Mirëpo ata duhet të kuptojnë se ajo që për ata është pothuajse evidente, e kuptueshme vetiu, për publikun jo medoemos është dhe duhet të jetë e tillë.

Nuk është fjala që në komunikimin publik të shprehësh bindjet personale apo të grupit ku bën pjesë. Rëndësi ka që në formë të përmbledhur, shumë sintetike, të dish që edhe të përdorësh argumente sociologjike, anketash, fakte, arsytetime logjike, etj, të cilat t'i drejtohen një publiku duke e konsideruar atë sikur është dyshues dhe i pabindur në vërtetësinë dhe dobinë e mesazhit që i komunikohet.

Në veprimtarinë e gazetarisë televizive gazetarit shpesh i duhet që të ndërhyjë për ta ndihmuar folësin, bashkëbiseduesin që të hyjë sa më shpejt në temë, të ketë argumente konkrete, të dijë t'i paraqesë ato dhe t'i rendisë brenda një arsytimi të përgjithshëm koherent.

Shpeshherë gazetari ia arrin në bashkëpunim me të ftuarin ose të ftuarit e vet t'ia mbërrijë këtij objektiv, por herë të tjera intervista dhe biseda mund të mos ecë, pikërisht sepse të ftuarit, përfaqësues të shoqërisë civile, apo të politikës, nuk kanë ardhur të përgatitur në mënyrë që argumentet e tyre të jenë të ndërtuara në mënyrë bindëse dhe konkrete, aq sa duken sikur janë të prekshëm.

Edhe këtu ekziston një fushë që vlen të eksplorohet.

Gatishmëria për t'u ballafaquar me të tjerët

Veçanërisht në bisedat që bëhen në studio, kur janë disa të ftuar, gazetari është i detyruar të ketë sjellë përpara kamerës individë që dihet se në mos kanë alternativa të kundërta për të ballafaquar, përsëri supozohet se mund të kenë përqasje të ndryshme rreth të njëjtit problem, ose së paku kanë përdorur metoda të ndryshme për ta shprehur dhe mbrojtur atë.

Gazetari është i detyruar ta bëjë këtë, pra ballafaqimin e pikëpamjeve, jo vetëm se ia kërkon etika e profesionit të tij, jo vetëm sepse këtë e kërkon zhanri i bisedës në studio si pjesë e gazetarisë televizive, por edhe sepse në këtë mënyrë jep një informacion të balancuar; është i drejtë me të gjitha anët e opinionit publik dhe mbi të gjitha shpreson të arrijë një sukses në tërheqjen e audiencës. Nëse të ftuarit në studio, me gjithë lutjet dhe kërkesën e gazetarit, nuk marrin pjesë për ta diskutuar argumentin e përdorur, atëherë edhe çështjet nuk rrihen tamam. Këtu është fjala për ta ndjekur tjetrin në ato që thotë dhe jo thjesht për të shprehur në forma pasive idetë për të cilat është kushtuar një bisedë e tërë në studio.

Përgjithësisht përfaqësuesit e shoqërisë civile dinë ta bëjnë këtë. Ata e ndjekin njëri-tjetrin në bisedë, e dëgjojnë me vëmendje, por shpesh disa nuk e kanë aq të zhvilluar kulturën e debatit në studio, ndonëse e kanë në jetë. Kjo është e natyrshme, sepse kërkon edhe

aftësi për të ndërhyrë në çastin e duhur. Mbi të gjitha kërkon që në bisedë e sipër të prodhohen argumente dhe kundërargumente spontane, të cilat nuk krijohen aq lehtë. Ndonjëherë për të evituar këtë vështirësi, të ftuarit më shumë e ndiejnë veten vetëm ballë përballë gazetarit dhe shumë më pak ballë përballë njëri-tjetrit.

Kjo në fakt vjen edhe sepse është krijuar tradita që pak a shumë çdo aktor i shoqërisë civile mbulon një fushë shoqërore dhe kryen një lloj veprimtarie, duke i shtyrë të tjerët drejt fushave të tjera. Duket sikur jemi në një treg gjigand idesh dhe shërbimesh ku ka një ndarje gati si me thikë të sferave të ndikimit dhe të influencës. Me një fjalë, gati-gati mund të thuhet se duket sikur ka një ndarje pune, e cila bën që të mos ketë organizata joqeveritare, apo aktorë shoqërorë konkurrentë apo rivalë që të udhëhiqen nga ideologji apo botëkuptime të ndryshme, por që veprojnë brenda së njëjtës fushë të jetës qytetare. Secili duket pothuajse i vetëm në fushën e tij. Është pikërisht kjo anë që në njëfarë mënyre krijon njëfarë boshllëku në debatin midis aktorëve të shoqërisë civile.

Pra, mund të thuhet se ky debat është më i fuqishëm në komunikimin politik midis partive të ndryshme, midis përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe politikanëve, midis gazetarëve dhe nëpunësve apo politikanëve, kurse aktorët e shoqërisë civile komunikojnë pak debatueshëm me njëri-tjetrin. Duket sikur kemi të bëjmë me një bllok të padiferencuar që është shoqëria civile dhe nga ana tjetër shteti dhe partitë politike.

Kompetencat profesionale në trajtimin e çështjeve

Këtu duhet mbajtur mirë parasysh se komunikimi politik ka specifikat e veta.

Më së pari, kjo do të thotë se ai është një ligjërim me natyrë, me objektiva dhe parametra formale politike dhe së dyti, ai është

televiziv. Të dy këto tipare e bëjnë atë që të mos ketë një përmasë të thjeshtë teknike.

Teknikaliteti dhe teknikizmi janë dy gjëra krejt të ndryshme, kur është fjala për të folur në televizion. Në qoftë se i pari, pra teknikaliteti, është i mirëseardhur, teknikizmi krijon probleme, sepse veç të tjerash e bën të folurit televiziv të pakuptueshëm për masën e gjerë të audiencës. Kjo mund të shoqërohet pastaj edhe me rënien e kërkesës për publicitet në orarin e transmetimit të emisionit dhe që për pasojë, herët ose vonë, do të sjellë edhe heqjen e emisionit nga programacioni. Duhet thënë se shoqëria civile te ne ka brenda gjirit të saj aftësi dhe kompetenca krejt të spikatura për t'i trajtuar çështjet me një profesionalizëm të veçantë. Në shumë raste aktorët shoqërorë janë profesionalisht në një nivel të ngritur. Kjo vjen se ata vijjnë si rregull nga sektori i arsimit apo i kërkimit shkencor dhe në raste të tjera kanë një formim shumë të mirë në fushën përkatëse, ose kanë punuar prej kohësh atje. Ata e kuptojnë mirë se tjetër është teknikaliteti i përqasjes dhe tjetër përqasja teknikiste, e cila e bën të pakuptueshëm mesazhin për audiencën, por e vendos edhe vetë gazetarin në një pozitë shumë të vështirë. Duhet mbajtur parasysh se stacionet shqiptare televizive janë stacione përgjithësuese dhe jo të tematizuara. Nga ana tjetër, është e sigurt se kemi të njëjtin spektator që është i interesuar për të gjitha temat që trajtohen qofshin këto të reformave të gjyqësorit, të luftës kundër informalitetit, të përballimit të dukurive korruptive në veprimtarinë e administratës dhe të shërbimeve të siguruara nga sektori publik, të hartimit të ligjeve për institucione të ndryshme të shtetit, për reformën elektorale, etj. Kuptohet se po qe se të gjitha këto aspekte trajtohen në detajet e tyre teknike, kuptimi i mesazhit bëhet i pamundur ose shumë i vështirë për këtë spektator.

Etika në debatin publik

Kur vjen fjala për debatin me natyrë politike, mjedisi është zakonisht më i tendosur dhe shpesh biseda merr një përmbajtje konfliktuale. Kjo ndodh shumë më tepër kur politikanë si përfaqësues të forcave të ndryshme politike ballafaqohen me njëri-tjetrin ose kur përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile debatojnë me përfaqësues të politikës. Zakonisht ndodhin rrallë skandale apo ekseese në studio, sepse gjithkush bën një përmbajtje maksimale për të ruajtur etikën e diskutimit. Sikurse thotë Habermas, sa herë zhvillohet një bisedë ka vend që bashkëbiseduesit të respektojnë parimet e konsensusit minimal, domethënë të pranojnë ta lënë njëri-tjetrin të flasë, pavarësisht se ajo që dëgjojnë mund të mos jetë e dëshirueshme ose e arsyeshme për ta.

Filozofia e sotme bashkëkohore insiston se në planin moral gjërat janë të ndara, domethënë tjetër është personaliteti i dikujt dhe tjetër janë argumentet që ai përdor. Dikush mund të sjellë argumente të papranueshme, të parespektueshme në planin logjik, por kjo nuk do të thotë se ai në planin e qëndrueshmërisë morale, e dëshirës për të kontribuar në opinionin publik etj, nuk është i respektueshëm.

Zakonisht aktorët e shoqërisë civile, sidomos në emisionet për të cilat po flasim, kanë një shprehje të edukuar dhe etike, por kjo nuk do të thotë se në raste të tjera aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile të mos përdorin ndonjëherë një gjuhë të denigrimit të tjetrit, ndonjëherë edhe të shantazhit apo të kërcënimit të tërthortë.

Sidoqoftë kur dy të ftuar, sidomos kur bëhet fjalë për të ftuara, sikurse ka ndodhur, vazhdojnë të flasin në të njëjtën kohë pa i lënë shteg njëra-tjetrës, duke krijuar një kakofoni zërash të çjerrë njerëzorë, ku asnjë tingull nuk ka më kuptim. Me gjithë thirrjet për të vendosur një komunikim të arsyeshëm nga ana e gazetarit, kuptohet se këtu nuk ka më komunikim politik, por ka vetëm zhurma të pakuptueshme, krisje, kërcitje. Ndoshta për një çast mund të

thuhet se ka telespektatorë që edhe zbaviten prej këtej dhe që e dëshirojnë një çast të tillë, por kjo ndodh jo shpesh dhe nuk mund të ketë vlerë në vazhdimësi.

Kapaciteti reagues ndaj aktualitetit mediatik

Në komunikimin politik në media ka rëndësi që të vepohet në përputhje me një axhendë çështjesh tashmë të pranuar nga publiku dhe të ndjekura edhe nga shumica e mediave të tjera kryesore të vendit.

Ky është një problem i madh sidomos për mediat që janë krijuar rishtazi si dhe për ato media që kanë një audiencë relativisht të ngushtë.

Për ç'arsyeje?

Arsyeja është se nëse këto media dëshirojnë të tërheqin vëmendjen e publikut, janë të detyruara që të paraqiten me një informacion të freskët dhe mundësisht edhe me një tematikë apo axhendë informacioni të re dhe specifike. Po pikërisht këtu ku mund të gjendej edhe forca e tyre e nisjes, pikërisht aty mund të qëndronte edhe thembra e tyre e Akilit, pra shkaku i dështimit. Do të mund të ndodhte kështu pikërisht sepse këto media do të ndodheshin përpara rrezikut për të dalë jashtë aksit qendror të interesit të publikut, i cili, sigurisht, ndikohet nga mediat më të mëdha dhe me një traditë në vend.

Ky problem është edhe më i mprehtë për aktorët e shoqërisë civile. Sidomos kur janë pa mjete të shumta materiale, njerëzore dhe financiare, ata e kanë shumë të vështirë që çështja që iu intereson atyre, e cila përballet zakonisht me anë të projekteve të financuara nga të tretët, të vihet në axhendën mediatike të diskutimit në publik. Ka shumë pak shanse që të ndodhë që mediat kryesore të vendit t'i ndjekin pas.

Ajo që mund të ndodhë më lehtë është që aktorët e shoqërisë civile të ndjekin nga afër axhendën e shqetësimeve publike që mbizotërojnë në media dhe aty të ndërpusin problematikën e tyre. Ka shoqata joqeveritare, të cilat arrijnë ta bëjnë këtë gjë.

Kjo ndodh pothuajse për tri arsye kryesore. Së pari, rastësisht. Ndodh që lumturisht një problem që ndodhet brenda spektrit problematik që ndjek një aktor kolektiv i shoqërisë civile, për shkak të zhvillimeve politike të vendit, për rrethana të ngjarjeve të ndryshme politike, apo për ndodhi, skandale, apo debate krejt të rastit, të hyjnë në aksin qendror të diskutimit publik dhe mediatic. Së dyti, mund të ndodhë që për shkak të aftësive komunikuese dhe aftësive personale të drejtuesve të një organizate joqeveritare, këta të fundit të dinë ta përshtatin problematikën që ndjekin, projektin që kanë nëpër duar, veprimtaritë që kanë parashikuar të zhvillojnë brenda asaj periudhe kohe, me axhendën e diskutimit publik në media. Jo vetëm kanë kujdes për t'u konformuar me shqetësimet e ditës së publikut dhe të mediave, por edhe e bëjnë këtë pa sforco dhe pa ndonjë amatorizëm të dukshëm. Së treti, kur është fjala se një aktor i shoqërisë civile ka autoritetin, aftësitë, mjetet, ngulmimin e duhur, ai mund të bëjë që çështja të cilën ai e ka në fokus të jetë edhe një objekt qendror diskutimi për mediat.

Sidoqoftë kjo qëllon radhë, ndërkohë duket si pa interes që aktorë të shoqërisë civile të vijnë në emisione televizive qendrore, kur diskutojnë atje çështje dhe argumente të cilat ndonëse të rëndësishme, përsëri janë larg shqetësimeve të ditës.

Pavarësia e mendimit dhe mungesa e oportunitetit

Duket sikur është një kriter dhe një indikator që kuptohet vetvetiu. Gjithkujt që nuk e njeh komunikimin politik në një shoqëri që aspiron të bëhet e lirë dhe demokratike, nuk njeh mënyrën se si

është strukturuar dhe funksionon shoqëria civile e shfaqur në aktorët e vet më të rëndësishëm, kështu do t'i dukej. Të gjithë aktorët e shoqërisë civile janë të lirë, sepse ata janë jashtë ndikimeve dhe kontroleve nga administrata, nga shteti dhe nga partitë politike. Por nuk është kështu, ndonëse përgjithësisht nuk mund të mendohet se e gjitha sa vumë në dukje është e tepërt dhe nuk qëndron.

Sikurse thuhet në gjuhën e sotme sociologjike kemi arritur në një fazë që quhet « e shoqërisë së projekteve». Një pjesë e madhe e aktorëve të shoqërisë civile i gjen fondet për të vepruar nga donatorë të ndryshëm, shumica nga agjenci të huaja që veprojnë në shoqëri, që duan të promovojnë demokracinë e re shqiptare, të rrisin influencën e tyre mbi shoqërinë lokale, por pa interesa konkrete në fushat ku ata subvencionojnë dashamirësisht. Sigurisht që është fjala për subvencione të cilat nuk jepen me kushte, megjithatë për t'i marrë dhe përdorur ka nevojë që të plotësohen disa kriterë. Kundër politizimit, mosqenia radikal, një lloj moderacioni në trajtimin e çështjeve dhe sidomos vetëpërmbajtje për të mos bërë përqasje të cilat nuk do të imagjinoreshin si të pranueshme nga subjekti donator.

Edhe administrata luan ndikimin e vet, sikurse edhe shteti dhe partitë politike. Nuk ka aktor individual të shoqërisë civile që të mos ketë afinitetet e veta me këtë apo atë krah të prirjeve dhe partive politike. Do të ishte naive të mos mendohej në këtë mënyrë. Pastaj, shumë projekte kërkojnë ndihmën e pushtetit publik, të pushtetit lokal, të dikastereve për t'u kryer. Pa këtë bashkëpunim vështirë se do të kishte objektiva të realizuara, impakt konkret të projekteve mbi veprimtarinë e përditshme institucionale, nuk do të kishte as edhe informacion që iu duhet si uji dhe buka shoqatave qeveritare.

Për të mos thënë se aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile kanë edhe ata synime të tyre karriere, e cila në të shumtën e rasteve kalon nëpërmjet kontrollit dhe influencës së aktorëve politikë.

E themi këtë, sepse shpeshherë në komunikimin politik të

aktorëve të shoqërisë civile ndihet edhe ndonjë lloj nuance për të qenë më tepër të kujdesshëm sa duhet për të qenë në përputhje me humoret e institucioneve të ndryshme shtetërore ose me ato të partive apo personaliteteve të caktuara politike.

Masivizimi i mendimit politik

Aktorët e shoqërisë civile mund të jenë dy llojesh nga pikëpamja e bartësve socialë të tyre. Ata mund të jenë aktorë shoqërorë individualë, sikurse do të ishin për shembull figura qendrore të jetës sociale, shkrimtarë, gazetarë të shquar, pedagogë apo shkencëtarë, sportistë apo këngëtarë, etj. Këta kanë një rol të madh jo vetëm kur gjenden dhe veprojnë vetëm brenda sferës së kompetencave të tyre personale, por edhe kur shprehen lidhur me probleme shoqërore që trajtohen në media, për hir të influencës së tyre të jashtëzakonshme mbi publiku, por edhe kur shprehen politikisht. Por ka rëndësi parësore që shoqëria civile të shfaqet edhe në formën e aktorëve kolektivë, pra si grupe interesi, si shoqata, si grupe identiteti kulturor, si organizata sindikale, si korporata profesionale, si shoqata joqeveritare, etj.

Këtu duhet të ritheksojmë se shoqëria civile në Shqipëri aktualisht më shumë shfaqet si e strukturuar në shoqata jofitimprurëse, sesa nëpërmjet grupeve të interesit. Sikurse trajtohet në tekst, midis këtyre ka ngjashmëri, por ka edhe shumë dallime të cilat nëse mbahen mirë parasysh, nuk lejojnë që ato të konfondohen me njëra-tjetrën. Një drejtim i spikatur dallimesh është se pjesëmarrja në grupet e interesit ka prirje të bëhet masive, pavarësisht indiferencës që vihet re në kohët tona dhe ndërkohë shoqatat joqeveritare, ndonjëherë nuk kanë një numër të zgjeruar pjesëmarrësish aktivë.

Kjo situatë është duke u thyer megjithatë.

Aktivistë të shumtë, kryesisht të rinj e të reja në moshë, po

bashkëpunojnë me shoqata joqeveritare, nga të cilat ka që kanë krijuar edhe rrjetet e tyre organizative në të gjithë Shqipërinë. Megjithatë, vihet re se bërthama që përbën si të thuash zemrën e një shoqate jofitimprurëse mbetet e fokusuar te një grup shumë i ngushtë njerëzish, për të mos thënë se ka aktorë të shoqërisë civile që në fakt shfaqen si kolektivë, por realisht janë individualë. Një, dy ose tre, apo edhe pak më shumë individë, ndonjëherë miq me njëri-tjetrin, përbëjnë forcën reale vepruese të shoqatës, ndërsa pjesa tjetër është si të thuash një numër bashkëpunëtorësh. Sot është vështirë që brenda çdo aktori kolektiv të shoqërisë civile të ketë mendime alternative, të cilat të dalin në shtyp dhe në mediat televizive. Mendimi politik në to është shumë i përqendruar dhe ndonjëherë boll i kontrolluar në rrugë personale.

Po këtu vihet re se ka një lloj ndarjeje midis aktorësh kolektivë ku drejtojnë gra dhe aktorëve kolektivë ku drejtojnë burra, çka bën që të mos ketë një përzierje personalitetesh nga të dy gjinitë. Aq më tepër që personazhet femra më tepër angazhohen në çështje sociale, juridike, apo të edukimit, kurse ata meshkuj mirëfilltazi në probleme politike, etj.

Artikulimi i mendimit – aksion

Kuptohet se kur flitet për një ligjërim që derdhet në kuadrin e një komunikimi politik me publik, lloj, përmbajtja dhe forma e ligjërimit është shumë specifike. Nuk mund të jetë njësoj sikurse ndërtohet një tekst, një shkrim në shtypin e shkruar apo një leksion universitar. Kuptohet që komunikimi politik i bërë nga aktorët e shoqërisë civile nga njëra anë është i detyruar të privohet nga disa elemente sikurse janë gjatësia e arsytimit, përmasat historike të zgjatura të paraqitjes së problemit, futja e një informacioni shumë të zgjeruar teknik në brendësi të tij, erudicioni i ekzagjeruar që veç të tjerash e frustron

tej mase vetë audiencën, etj.

Por ky lloj komunikimi politik ka disa epërsi të pamatshme në plane të tjera që vlejné për t'u mbajtur parasysht. Ai mbi të gjitha nuk mund t'u thotë njerëzve gjëra që këta i dinë më mirë sesa ai që i shpreh në televizion ato. Ky komunikim publik duhet të ketë një qëllim të qartë përpara vetes, ai duhet të zbulojë një çështje nën një këndvështrim të ri për ta bërë interesante për qasjen përpara publikut. Mbi të gjitha mënyra e organizimit të tij ka vend që të ketë një natyrë shumë pragmatike ose një "racionalitet" tepër instrumental:

Probleme – argumente për të vepruar – objektiva konkrete për të realizuar.

Kjo duket se është struktura më e gjetur e një mendimi – aksion aq i përshtatshëm për komunikimin politik me publikun nëpërmjet një medie televizive.

Sipas mendimit tonë, ka nevojë të evitohet një lloj natyre disi e pafokusuar mirë te objektivat që duhen realizuar nga ana e komunikimit politik. Një nga detyrat e aktorëve të shoqërisë civile është sigurisht sensibilizimi propagandistik i opinionit publik për probleme të rëndësishme të përmasave të caktuara dhe që kanë lidhje me interesin publik. Por vetëm kaq sigurisht që duket e pamjaftueshme. Mbi të gjitha nuk është misioni i aktorëve të shoqërisë civile për t'u bërë elemente që mbushin programacionet e emisioneve televizive pa ruajtur specifikën e tyre. Problemi më i rëndësishëm lidhur me këtë komunikim publik të ardhur nga shoqëria civile është tërësia e propozimeve alternative për të vepruar ndryshe, për të propozuar për qasje të ndryshme, për të çelur pamje të tjera të veprimtarisë kolektive të njerëzve. Ndodh që përgjatë këtij komunikimi publik vihen re të meta, evidentohen për shembull mangësi në hartimin e projektligjeve, kritikohen qëndrime të administratës, politika të shtetit, për qasje të aktorëve të politikës, nxirren në pah defekte në procedurat apo zbatimin e ligjeve dhe të Kushtetutës nga ana e

subjekteve të ndryshme shtetërore ose gjyqësore, bëhen thirrje për të reformuar shtetin, gjyqësorin, Kodin Elektorale etj, por ndodh që rrallë thuhet konkretisht se çfarë duhet bërë ndryshe, si duhet bërë ndryshe, cila do të ishte zgjidhja.

Mendimi – aksion është një fokus virtual i ndërgjegjes kolektive drejt realizimit të disa objektivave konkrete që nuk bëhet thjesht teorikisht, por edhe nëpërmjet thirrjes për të vepruar ndryshe, nëpërmjet prodhimit të zgjidhjeve alternative.

Mbi të gjitha shoqëria civile është një forcë e madhe presioni mbi shtetin dhe politikën. Ajo mund t'i influencojë fuqimisht politikën publike, por për këtë nevojitet një forcë mobilizuese që përgjithësisht është akoma e dobët.

Çinteresimi material dhe përkushtimi personal

Në një ekonomi tregu, të gjithë aktorët shoqërorë kanë nevojë që të kenë financime për të kryer detyrat dhe objektivat që i kanë vendosur vetes. Nuk është se të tilla janë vetëm organizatat joqeveritare, por të gjitha firmat prodhuese, të shërbimeve, partitë politike dhe të gjitha agjencitë shoqërore. Mbi të gjitha është bërë shumë e kushtueshme ndërmarrja e fushatave të publicitetit, promovimit të një ideje ose misioni dhe e sensibilizimit të opinionit publik lidhur me të. Edhe aksesin në medianë e shkruar dhe televizive, ndonëse përfiton shumë nga interesi i ndërsjellë, përsëri ka koston e vet, sidomos kur është fjala për të botuar atje spote publicitare. Po kështu, ndërmarrja e studimeve kërkon angazhimin e ekspertëve dhe studiuesve të cilët bëjnë një punë shpeshherë të lodhshme, që kërkon kualifikim të lartë dhe prandaj detyrimisht duhet të shoqërohet me faturën e vet financiare. Por sot militanti apo aktivisti që angazhohet në këtë punë me kohë të plotë nuk është thjesht një përvojë shqiptare.

Pra, nuk duket aspak e tepërt që organizatat joqeveritare të jenë në kërkim të fondeve. Sidoqoftë, nuk ka vend të ndodhë që ato gjatë komunikimeve të tyre politike me publikun ta theksojnë apo ta paraqesin këtë anë. Aq më pak ka vend që publikisht të paraqesin imazhin e një subjekti që rend për të marrë fonde dhe për këtë arsye e ka të lehtë të konformohet me kërkesat eventuale të donatorit, fleksibël në idetë dhe kërkesat e veta duke qenë shumë i ndjeshëm nga nevojat financiare. Kjo nuk u shkon jo vetëm shoqatave jofitimprurëse, por edhe disa analistëve që pretendojnë të kenë pamjen e gazetarëve krejt të pavarur, ndërkohë që dihet se ata marrin honorarë dhe pagesa të tjera shpeshherë shumë të mëdha nga kompanitë e mediave të tyre.

Në publik ka një konfuzion që krijon pasoja të padëshirueshme mbi forcën bindëse të fjalës, konfuzion që ngatërron në perceptimin e tij rrogëtarin që punon për interesin e tij personal, për rrogë dhe të ardhura të mira, shumë herë më të larta se ato të një «hallexhiu» apo të një shqiptari – qytetar mesatar nga të ardhurat, dhe militantit shoqëror të pasionuar pas mbrojtjes dhe promovimit të interesit të përgjithshëm dhe të së mirës publike.

Ndoshta në ndonjë shoqëri tjetër më të pjekur me rrethanat dhe konjunkturat e militantizmit profesionist, kjo nuk do të kishte sjellë asnjë pasojë dhe do të kishte kaluar si diçka e natyrshme dhe krejt normale. Kurse për mentalitetin shqiptar, mbetet problem ajo që thoshte Maks Weber-i, sociologu i famshëm gjerman i fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimit të shekullit të njëzetë, se ka rëndësi të dallohet ai që «jeton prej politikës», pra fiton si të thuash bukën e gojës prej saj, nga ai që «jeton për politikën», pra që në plan të parë, pasi ka zgjidhur problemet e veta materiale, ia ka kushtuar jetën politikës apo pohimit të interesit të përgjithshëm pa pasur asnjë motiv tjetër egoist apo personal.

Nga kjo pikëpamje komunikimi politik i aktorëve të shoqërisë civile bëhet edhe më bindës, nëse ai shoqërohet me një transparencë

të fondeve, të llogarive bankare, të të ardhurave të funksionarëve, si dhe kur është i shoqëruar me një vullnetarizëm të pashoq dhe të manifestuar publikisht dhe pa kaluar nëpërmjet interesave dytësore.

PROF. DR. ARTAN FUGA

EDHE NJË HERË MBI KORRUPSIONIN

Pasojat negative të korrupsionit

Prej kohësh korrupsioni, në format e tij të shumëllojta, është bërë një problem i mprehtë për opinionin e përgjithshëm mbarëkombëtar si dhe përfaqëson një gangrenë të vërtetë për vetë funksionimin normal të shoqërisë së sotme shqiptare. Ndikimet e tij negative në shoqëri nuk prekin vetëm sferat morale dhe etike, por kanë të bëjnë edhe me vetë ngecjen e dinamikave të zhvillimit të shoqërisë sonë, ende në hapat e para të demokratizimit, si edhe me fatin e individit në këtë shoqëri.

Korrupsioni në radhë të parë krijon grupe të fuqishme dhe individë që jetojnë përtej rregullave të së drejtës dhe kundër ligjit duke u vënë në përballje të drejtpërdrejtë me shtetin dhe të drejtën, e për pasojë, hap pas hapi, kanë prirje të shkojnë më tej, duke përdorur në raste ekstreme edhe dhunën, presionet, krimet ndaj jetës dhe pasurisë së personit si mjete të realizimit të veprimtarisë korruptive kur kjo është e përmasave veçanërisht të rrezikshme.

Nga analiza e shumë rasteve gjyqësore del se në origjinë të veprave penale kundër personit, sikurse mund të jenë vrasjet,

atentatet, plagosjet, ushtrimi i dhunës fizike, fyerjet etj, ka qëndruar edhe përfshirja e palëve, si e agresorëve, por ndonjëherë edhe e vetë viktimave, në veprimtari korruptive. Larja e hesapeve, mbyllja e gojës e të dyshuarve për denoncime, eliminimi i kundërshtarëve dhe i rivalëve, goditja e kujtdo që i kundërvihet veprimtarisë korruptive, hapin të gjitha shtigjet që korrupsioni të nxisë dhe të mbajë gjallë të gjitha format e kriminalitetit në vend. Aq më shumë që ai i ngjan një vorbulle që pasi e përfshin individin, ka forca që ndoshta edhe ta mbajë atë përjetësisht brenda vetes, për shkak se të gjitha daljet nga ky mjedis janë të rrezikshme dhe të mbyllura nga ish-partnerët apo rivalët.

Mirëpo sado që të duket e rëndësishme ana kriminale, ajo nuk është e vetmja. Në fakt, korrupsioni ka fuqi të tilla, të cilat kanë forcën e duhur që të çojnë në ndryshimin e vetë natyrës së shtetit dhe të sistemit politik të demokracisë që në letër, në Kushtetutë dhe në ligje mund të shpallet si shtet ligjor që respekton parimet bazë të një demokracie, pra barazinë në të drejta të të gjithë qytetarëve. Korrupsioni, duke i lënë letrat shpesh të palëvizura, ligjet të pacenuara në formë, duke lejuar që mediat dhe ligjërimi publik të flasin sa dhe si të duan për demokraci, shtet ligjor dhe barazi në të drejta midis qytetarëve, në të vërtetë, përtej hipokrizisë së fjalëve, e kthen shtetin në një shoqatë individësh të izoluar, në një lloj ndërmarrjeje private, biznes, agjenci financiare që u shërben vetëm interesave të të pasuruarve me anë të aferave korruptive. Ai apo ajo që ka nëpër duar një pare të lehtë, të fituar me rrugë trafikesh, korrupsioni apo tenderësh të paligjshëm, vjedhesh dhe abuzimesh, që ka prona apo biznese të vëna prej veprimtarish klandestine dhe të dënueshme, apo të korrura nëpërmjet rrugës më të turpshme, frikacake dhe të padenjë që është ajo e përfitimit prej posteve politike apo administrative, nëpërmjet abuzimit me pushtetin dhe besimin e publikut, janë në gjendje të blejnë konkurset për të futur fëmijët e tyre në universitete padrejtësisht dhe në kurriz të të

tjerëve, janë në gjendje të paguajnë gjykatës të pandershëm për ta trajtuar çështjen gjyqësore në favor të tyre dhe në mënyrë të njëanshme, kanë mjetet për të paguar aty ku duhet me qëllim që të afërmit e tyre të emërohen jashtë rregullave dhe kritereve, në mënyrë nepotike, në vendet më të mira në administratë.

Vetë shteti bie pra në dorë të të korruptuarve dhe humbet si natyrën e paanshme që duhet të kishte, ashtu sikurse nuk respekton konkretisht, me vepra dhe jo me fjalë, barazinë e qytetarëve përpara ligjit.

Por ndikimet negative të korrupsionit nuk përfundojnë me kaq, sepse rrjetet e të korruptuarve nuk e duan as rregullin dhe as shtetin. Është tjetër gjë ajo që thuhet shpesh si formë justifikimi se edhe ata që e kanë vënë pasurinë në forma korruptive, një ditë, duke e parë veten të pasuruar sa dhe si duhet, do të fillojnë të kërkojnë rregull, ndershmëri dhe vendosjen e ligjit në shoqëri për t'u mbrojtur nga kundërshtarët apo konkurrentët e tyre, të tentuar nga përdorimi i po atyre formave korruptive pasurimi si të atyre që e filluan këtë proces.

Nuk e përjashtoj se ndoshta kjo do të ndodhë pas njëqind apo dyqind vjetësh, por sidoqoftë jo tani. Pas një ose dy shekujsh, atëherë po, do të paguhet edhe filozofë, historianë, sociologë, apo edhe elifimatrakë pa diplomë, që do të argumentojnë (siç kanë bërë deri tani për shefat e tyre) se të korruptuarit e zanafillave të kapitalizmit në Shqipëri nuk kanë qenë veçse ata më trimat, më të aftët, më të zgjuarit, më të shkathët, bile dhe më patriotët dhe filantropikët, më *débrouillards*, (në frëngjisht në tekst), ndërsa ata që mbetën të varfër ishin budallenjtë, të mefshtët, handikapatët, idealistët, ëndërruesit, ata që s'qenë të aftë as për veten e tyre, as për atdheun, as për kombin, pra individët që seleksioni natyror i eliminoi si në botën e kafshëve.

Atëherë këto lloj trajtesash do të hyjnë në tekste shkollash dhe në këtë formë do të përsëriten brez pas brez, duke i bërë të besojnë

në to fëmijët e atëhershëm.

Sa për sot të korruptuarit janë ende larg dhe do të qëndrojnë larg të kthyeri në legalitet, duke kërkuar turbullira, vakume administrative, përshtjellime politike, bile dhe në kuptimin e rrjeteve të trafikut ndërkombëtar, dëshirë për mungesë stabiliteti gjeopolitik për rajonin tonë dhe për më gjerë.

Duket se në një pjesë të qytetarëve që jetojnë në kushte modeste ekonomike dhe që nuk interesohen shumë për politikën, është rrënjosur mendimi kryekëput i gabuar se ata nuk kanë punë me luftën kundër korrupsionit, se ata shohin hallet e tyre dhe se ajo që u intereson është vetëm përmirësimi i kushteve të tyre të jetesës.

Sa gabim që e kanë që lundrojnë në këtë det absurd iluzionesh!

Ata nuk e kuptojnë se gjendja e tyre e rrënuar ekonomike mbetet e tillë dhe shkaktohet edhe nga shkalla e lartë e korrupsionit në vend. Mekanizmi ekonomik korruptiv vepron në mënyrë të drejtpërdrejtë duke i bërë të varfrit edhe më të varfër dhe të pasurit edhe më të pasur. Paraja e fituar lehtë, në mënyrë joligjore ose antiligjore, e grumbulluar me shpejtësi në xhepat e një pjese të vogël të shoqërisë, rrit kërkesën për mallra në treg duke ndikuar që çmimet e tyre të shkojnë në stratosferë qoftë, sepse bizneset korruptive ndikojnë që të mbeten monopolistikë në treg, qoftë sepse raporti midis kërkesës dhe ofertës në treg vendoset mbi bazën e parasë korruptive që qarkullon.

Qytetari i ndershëm, ai që e fiton bukën e tij të përditshme nëpërmjet punës dhe djersës së ballit, njeriu me vlera morale duhet të jetojë në kushtet kur çmimi i banesave për metër katror, çmimi i këpucëve, i perdeve, i ndërtimeve në plazhet e vendit, i dhomave me qira etj, përcaktohet jo vetëm nga monopoli korruptiv në treg, por edhe nga fakti se ka në qarkullim në treg një pare të fituar lehtë dhe me shifra marramendëse.

Cili do të ishte ai tregtar që do t'i shiste këto të mira materiale me çmime stratosferike, nëse nuk do të kishte blerës nga ata që fitojnë

një pare të lehtë korruptive?

E fundit në listë, por jo nga rëndësia, do të ishte fakti se korrupsioni shkatërron jo vetëm bizneset e ndershme duke ia u bërë të padurueshme ekzistencën, por shkallmon edhe themelet etike të kombit. I moralshmi detyrimisht në këto kushte do të mbetet i varfër, ndërsa i pamoralshmi, domethënë ai që do të thyente ligjet, ai që do të blinte padrejtësisht privilegje për veten, do të pasurohej. Në këtë mënyrë do të ndodhte një degjenerim i plotë i hierarkisë së vlerave morale në shkallë kombëtare. Nderi, ndershmëria, zbatimi korrekt i normave të moralit dhe i ligjeve, puna, respekti për tjetrin etj, do të ishin sinonime me fjalët varfëri, mjerim, poshtërim, grindje familjare, disharmoni, vyshkje fizike dhe intelektuale. Njeriu do të ndodhej në dilema të forta dhe në fund të fundit do të jepej, thjesht për të evituar shkatërrimin e jetës së tij dhe do të adoptonte antivlerat, gënjeshtëri, egoizmin, mashtrimin, përfitimin nga trafiket e gjithçka tjetër të kësaj natyre.

Shprehjet e përhapura sot në masë që thuhen disi me një farë humori të zi, cinizmi dhe dhimbjeje, e që kanë zëvendësuar shprehje të tjera në gjuhën shqipe, janë shumë simptomatike të kësaj bjerrjeje të vlerave etike të popullsisë. «A e ke ndihmu ndonjë çikë rrogën sot?», «A ke bërë sot ndonjë korrupsion?», dëgjohen gjithmonë e më shpesh në mjedise nga më të ndryshmet dhe shoqërohen me buzëqeshjen pranuese të dëgjuesve.

Përafrime të mangëta të çështjes

Sado që format e korrupsionit janë të shumëllojta dhe me peshë e forcë dëmtuese të ndryshme, ato përbëjnë një të tërë dhe nuk ka kuptim të mos merren në konsideratë si të tilla.

Përfitimi i privilegjuar i tenderëve publikë duke dëmtuar rregullat e konkurrencës së ndershme, marrja e rryshfeteve dhe e dhuratave

kundrejt shërbimeve që nëpunësi publik i detyrohet qytetarit, përfitimi i privilegjeve në kurriz të të tjerëve duke paguar pare ose shkëmbyer në natyrë shërbime të ndërsjella, alienimi i destinacionit të pareve publike, ndryshimi i së drejtës në procese gjyqësore për shkak të influencimit me pare ose me mjete të tjera presioni financiar, fshehja e taksave dhe e tatimeve, ndryshimi i dokumenteve dhe i faturave me qëllim përfitimi, mbajtja e bizneseve të padeklaruara, krijimi i privilegjeve të padrejta dhe joligjore në shkëmbim të mbështetjes politike ose financiare dhënë një politikani ose force politike nga përfituesit e këtyre privilegjeve, trafiqet, kontrabanda, anashkalimi i detyrimeve doganore kundrejt përfitimeve ose zbatimit të urdhrave nga ana e eprorëve, të gjitha këto dhe të tjera të ngjashme përbëjnë një gamë të tërë veprimtarish korruptive, që çojnë në shkallë dhe masë të ndryshme, por të gjitha në të njëjtin drejtim, përkrah atyre pasojave negative që kemi përmendur më lart.

Ndonëse lidhur me çështjen e pranisë të korrupsionit në shoqërinë shqiptare sot flitet dhe shkruhet shumë, më duket se ka përafrime që bëhen, jo pak herë dhe jo pa qëllim, që janë të mangëta, lënë për të dëshiruar, ose përmbliohen në ca gjysmë të vërteta që më shumë janë opinione fluturake sesa gjykime të bazuara në studime të literaturës ndërkombëtare apo në analiza të thelluara të realitetit shqiptar.

Në këtë vorbull përafrimesh të mangëta bëjnë pjesë shumë konsiderata të cilat e shohin lindjen dhe përforcimin e korrupsionit ndër ne duke filluar me procesin e hapjes dhe demokratizmit të vendit, duke pretenduar se nën diktaturë kemi "qenë të pastër". Ndërkaq të gjithë e dimë se nuk është kështu, porse në vitet e shkuara të socializmit korrupsioni galopant erdhi dhe zuri vend në mënyrë të turpshme në shoqërinë shqiptare duke fituar më pas, në kushtet e hapjes, demokratizmit dhe tregut, forma të tjera të reja. E them këtë se korrupsioni nuk është si liria në gojën e Skënderbeut. Korrupsionin nuk na e sollën të huajt, sikurse pretendohet ndonjëherë

pa të drejtë, duke mbrojtur idenë e një shqiptari të dikurshëm të virtytshëm, të pastër, që u prish nga kontakti me botën e jashtme. Nuk e solli bota e jashtme korrupsionin; atë ajo e gjeti këtu midis nesh, jo në ushtat dhe shpatat tona, por në xhepat dhe skutat e shpirtit egoist të individit. Nëse dikush dëshiron të shkojë edhe më larg në histori, do t'i rekomandoja të lexonte edhe Migjenin apo edhe ndonjë autor tjetër më të hershëm, ose edhe Nolin, ose Konicën apo kë t'i pëlqente.

Korrupsioni nuk është një ves kleptomanësh apo individësh që për shkak të deformimeve psikologjike kanë prirjen për të fituar me çdo kusht pa njohur as interes publik, as ligj, as norma juridike dhe morale. Nuk është as me ngjyra politike. Të gjithë kemi parë se korrupsioni sado të ketë si digë morale personalitetin individual, nuk është një dukuri patologjike, por shoqërore. Ndoshta të gjithë kanë prirjen për të fituar sa më shumë, por është shoqëria, kushtet në të cilat ndodhet individi që e bëjnë ose jo të mundur përfshirjen e tij në hapësirat e ekonomisë dhe të veprimtarisë korruptive. Korrupsioni nuk është shprehje atipike dhe patologjike njerëzore, sepse rregulli, norma morale, shtrëngesa juridike, kanë lindur dhe ekzistojnë, sepse në fakt njeriu individual ka gjithmonë prirjen egoiste për të fituar me çdo mjet, vetëm dhe kundër të tjerëve. Pra, puna nuk është e ndonjë natyrë njerëzore e alienuar e njeriut që vjedh apo korrupton, por te defektet në organizimin e jetës sonë shoqërore që krijojnë mundësi dhe të çara edukimi, të cilat i hapin rrugë përfshirjes masive të individëve dhe të grupeve të ndryshme shoqërore në veprimtari korruptive, në ata që e bëjnë korrupsionin dhe në ata që përfitojnë nga korrupsioni.

Ky korrupsion është bërë nga individë me prirje dhe kahe politike nga më të ndryshmet. Nuk do të thotë se je socialist dhe doemos je i korruptuar, sikurse nuk do të thotë aspak se je demokrat dhe je i imunizuar nga korrupsioni. Si rregull përfshirja në korrupsion rritet si rrezik, sa më afër pushtetit qëndron individi apo grupi shoqëror.

Korrupsioni më i rrezikshëm dhe më i fortë ka prirjen të shfaqet te grupet shoqërore në pushtet sesa në grupet politike në opozitë.

Nga kjo pikëpamje ka vend që rrotacioni politik që u krye të shoqërohet me një auditim të përgjithshëm dhe të detajuar të shtetit, qoftë edhe duke kërkuar ndihmesën e ndonjë apo disa shoqërive ndërkombëtare të auditimit financiar dhe me një verifikim dhe riverifikim të pasurive të elitave politike dhe administrative të vendit. Shteti nuk dorëzohet duke lënë mbi tavolinë dosje me citate ose shkrime gazetash me rekomandime për pasardhësit apo me këshilla për ta. Duhet monitoruar gjerësisht rezultati i administrimit që një forcë politike i ka bërë shtetit. Në mos u bëftë kështu, nesër, pasnesër, nuk do të merret vesh se cili funksionar i cilës forcë politike i ka përgjegjësitë për pasojat negative të korrupsionit në dikasterin ku punon.

Kur flitet për korrupsionin shpesh dëgjohet të thuhet se nuk duhet të shqetësohemi sepse korrupsion në fund të fundit ka në të gjithë botën. Nuk do shumë mend për të kuptuar se kjo tezë është një përpjekje për ta mbrojtur veprimtarinë korruptive në vendin tonë, më së paku kemi të bëjmë me një dorëzim moral përpara saj. E themi këtë se ndërsa është e vërtetë që korrupsion ka pak a shumë në çdo vend të botës, kjo nuk do të thotë që ne të mos shohim syhapur se masat dhe organizimet administrative, politike dhe ligjore te ne janë në këtë fushë shumë, shumë larg, me kilometra larg, atyre që ka adaptuar dhe zbaton shoqëria e zhvilluar perëndimore. Këtu është problemi dhe jo thjesht te prania e faktit të korrupsionit kudo në botën e sotme.

E njëjta veprimtari merret në mbrojtje dhe justifikohet edhe kur thuhet se Shqipëria qenka vendi më i korruptuar i botës dhe se të gjithë nëpunësit, policët, pedagogët, mjekët, gjykatësit ndër ne qenkan të korruptuar dhe se problemi qenka vetëm të dihet se sa e ka çmimin gjithsecili. Është e kuptueshme se një pohim i tillë duke qenë i paverifikueshëm as nuk mund të vërtetohet dhe as mund të hidhet poshtë, pra mbetet spekulativ.

ARSYE QË MBAJNË GJALLË KORRUPSIONIN

Modeli ekonomik kryesisht tregtar i vendit

Lexuesi mund të pyesë se ç'hyn këtu modeli ekonomik tregtar i Shqipërisë dhe çfarë lidhje ka ai me korrupsionin?

Për të qenë më të besueshëm në sytë e tij, po e mbështesim analizën tonë te një nga autorët më në zë të ekonomisë politike klasike, Adam Smith. Kur ky shkruante librin e tij mbi burimet e pasurisë së kombeve, merrte për bazë shembullin e Anglisë së atëhershme. Analiza që bënte bazohej në idenë dhe konstatimin se Anglia kolonizatore mbështetej në një tregti të sforcuar me vendet koloniale e në radhë të parë me Amerikën. Dukej se ajo përfitonte shumë nga pozita e saj prej sundimtareje të privilegjuar duke u zhvilluar nga shfrytëzimi i mbështetur në dhunë i vendeve të kolonizuara. Prej andej ajo merrte në radhë të parë produkte të ndryshme bujqësore si edhe minerale të ndryshme. Këtu është shkak i krizës sonë, thërriste Adam Smithi që nga studioja e tij, duke e kthyer avantazhin iluzor në burim të krizës dhe të prapambetjes së ardhshme, që sipas tij do ta bënte mbretërinë të humbiste vitalitetin dhe forcën e saj ekonomike si edhe rolin e saj gjeostrategjik në

botë. Ne jemi një vend që jetojmë me anë të import – eksporteve sidomos me kolonitë tona. Prej këtij modeli, theksonte ai, përfitojnë këta aktorë shoqërorë: së pari, qeveritarët tanë në vendet koloniale, doganierët dhe pastaj tregtarët grosistë që në mos qofshin vetë doganierët apo administratorët, janë të lidhur me ta shumë ngushtë. Në një regjim ekonomik tregtar, shtresa sunduese ka prirjen të bëhet treshja: nëpunës – grosistë - doganierë, e cila nga njëra anë ruan monopolin në treg, nga ana tjetër pengon çdo degë tjetër prodhimi në vend.

Mbi këtë bazë, shpjegonte Adam Smithi, pengohet në Angli zhvillimi dhe modernizimi i industrisë dhe krijohet prapambetja teknologjike e saj në raport me vendet fqinje që dukeshin në ngjitje e sipër. Trinomi administratorë – doganierë – grosistë pasurohet, ndërsa vendi dhe popullsia varfërohen dhe degradojnë. Ai gjente edhe lidhjen e pjesëtarëve të trinomit që shqyrton duke e cilësuar të mbivendosur në qarkullimin e një paraje korruptive midis administratorëve – doganierëve – tregtarëve grosistë, që shpesh janë të njëjtët individë ose që vijnë nga të njëjtat rrethe familjare. Tregtari grosist ia kalon një pjesë të fitimit doganierit që ky të ngrejë trarin e doganës dhe administratorit, i cili të vazhdojë në mënyrë monopolistike po të njëjtën politikë ekonomike të mbështetur mbi tregtinë dhe aspak ose fare pak mbi prodhimin.

Kushdo që e lexon këtë paraqitje të shkurtër e kupton se ne nuk jemi shumë larg modelit ekonomik të katër shekujve më parë që kritikonte Adam Smithi në një nga librat më klasikë të shkencave shoqërore moderne. Ekonomia shqiptare prodhon sot në një masë thuajse minimale në krahasim me qarkullimin e mallrave që vijnë nga importi dhe që kalojnë nëpërmjet doganës.

Një rreth i tërë të interesuarish formohet duke përfshirë aktorë si ata që përmend Adam Smithi dhe që kanë bërë që nga doganat tona të kalojnë në mënyrë të parregullt, sipas parapëlqimeve të përcaktuara nga politika apo nga administrata, të mallrave që duke

hyrë në tregun shqiptar, jo vetëm prodhojnë një para korruptive, por edhe që korrupton.

Në këtë mënyrë na duhet të themi se prerja e burimeve të korrupsionit ka të bëjë në radhë të parë me ndërmarrjen e ndryshimeve strukturore të thella dhe të shpejta të shoqërisë shqiptare dhe të ekonomisë së saj, e cila ka nevojë të kthehet nga e mbështetur në qarkullimin e vlerave, në një ekonomi prodhuese, moderne, të integruar me tregun botëror. Vetëm në këtë mënyrë do të kishim jo vetëm uljen e peshës së rëndesës së vijave doganore, por edhe krijimin e një lobingu të fortë politiko-prodhues që do të ishte fortësisht i interesuar për një politikë të shtrënguar kundër korrupsionit.

Politizimi i administratës dhe i sistemit të drejtësisë

Në përafrimet më të thelluara që janë realizuar në Perëndim lidhur me dukurinë e korrupsionit, disa herë të porositura nga institucionet financiare ndërkombëtare, theksohet se kjo e keqe shoqërore vihet re edhe në shtetet diktatoriale dhe autoritare të botës së sotme, ashtu sikurse edhe në regjimet politike demokratike.

Në fakt, thuhet se njihen shtete diktatoriale tërësisht të korruptuara, sepse shtresat sunduese në to e përdorin korrupsionin si mjet për të krijuar bashkësinë e interesave të elitave politike dhe ekonomike të njehsuara në kastat sunduese dhe sepse në shtetet e këtij lloji, duke mos pasur as transparencë dhe as opozitë e as opinion të vërtetë publik, krijohet shtrati i përshtatshëm për veprimtaritë korruptive të elitës drejtuese gjë që pastaj përfshin të gjithë shoqërinë si një sëmundje kolektive ngjitetëse. Por njihen edhe shtete diktatoriale dhe autoritare, kur korrupsioni gëlon pothuajse vetëm në majën e hierarkisë politike, pa u përhapur në të gjithë trupin shoqëror, për shkak se elita sunduese pasi ka kapur shtetin,

nuk lejon që asnjë proces t'í dalë jashtë kontrollit duke zbatuar një moral radikal "puritan", çka nuk është veçse një përpjekje për ta lënë popullsinë në gjendje varfërie dhe kontrolli policor.

Nga ana tjetër theksohet se korrupsioni në shoqëritë demokratike, ndonëse në parim gjen më pak kushte për të vepruar, zvogëlimi i sferës së influencës së tij nuk është as i realizueshëm automatikisht dhe as gjithmonë i suksesshëm dhe plotësisht i realizuar.

Në këtë mënyrë njihen shtete demokratike tepër të korruptuara, sikurse njihen edhe shtete demokratike me një nivel korrupsioni të mbajtur gjithsesi nën kontroll.

Por në çdo rast edhe në shoqëritë demokratike, pohohet në këto studime, ka një lidhje shoqërore të qëndrueshme që e bën korrupsionin të paçrrënjoshëm krejtësisht. Kjo lidhje krijohet nga njëra anë midis forcave politike që diskutojnë midis tyre pushtetin shtetëror dhe pjesëve të ndryshme të elektoratit që mbështet këtë apo atë forcë politike. Mbi këtë bazë nuk mungojnë edhe prirje shoqërore të thella dhe të qëndrueshme, të cilat bëjnë që elita politike në pushtet të shpërndajë privilegje shtetërore në favor të shtresave të popullsisë apo grupeve ekonomike që e përkrahin politikisht përkundrejt shpërblimeve korruptive ndaj nëpunësve të administratës apo politikanëve.

Privilegje përkundrejt blerjes me para të tyre në forma të parregullta jashtëligjore, në dëm të bizneseve të tjera dhe të të gjithë shoqërisë dhe të vetë shtetit si të tillë.

Theksohet kjo lidhje për të shpjeguar në mënyrë që të mos krijohen keqkuptime të ndryshme, se ndërsa marrëdhënia midis forcave politike në pushtet dhe shtresave të ndryshme të popullsisë që i përkrahin ato, karakterizon funksionimin e demokracive moderne, korrupsioni i ngritur mbi këtë lidhje, ndonëse mund të ngushtohet në shkallën e tij të veprimit, përsëri nuk mund të eliminohet krejtësisht. Eliminimi i tij tërësor dhe radikal do të kërkonte në fakt vetë heqjen e lidhjes midis politikës dhe elektoratit që funksionon në mënyrë

demokratike, pra për rrjedhojë do të dëmtonte vetë demokracinë, duke rrezikuar shndërrimin e saj në një shtet autoritar që nga ana e tij prodhon edhe më shumë korrupsion.

Po nuk u mbajt me kujdes brenda një kufiri të arsyeshëm edhe lufta kundër korrupsionit ka rrezik të hyjë pra në një rreth vicioz që pak a shumë Zbigniew Berzezinski e ka cilësuar kështu: Demokraci ----> korrupsion ----> autoritarizëm ----> korrupsion + cenim i të drejtave politike ----> demokraci ----> korrupsion e kështu pafundësisht, çka e ka paralajmëruar edhe vetë Aristoteli.

Ndaj bëhet kujdes që të mbahet parasysh se në një shoqëri demokratike, ndonëse mund të bëhet shumë për ta luftuar këtë të keqe shoqërore që përfaqëson korrupsioni, përsëri edhe në këtë drejtim, veprimi demokratik i përmbahet një limiti, ka kufizimet e veta, sepse ai nuk mund të heqë ndërvartësinë midis politikave privilegjuese për këtë apo atë pjesë të elektoratit dhe vetë interesave të këtij elektorati që anon nga njëra anë apo nga tjetra anë e balancës politike të vendit.

Ky kufizim bëhet më i kuptueshëm po të mbahet parasysh, se demokracia nënkupton ekonominë e tregut dhe ekzistencën e mijëra fijeve të lidhjes midis pushtetit, nëpunësit dhe pasurisë, të cilat që të kontrolloheshin deri në fund do të kërkonin që pas çdo qytetari të vihej nga një polic dhe pas çdo polici të vihej një polic tjetër, dhe pas çdo polici tjetër të vendosej akoma edhe një polic tjetër dhe kështu pafundësisht. Por edhe kjo metodë ndonëse mund të supozohet se do ta zhdukte korrupsionin iluzivisht, do të rrezikonte jetën demokratike, privatësinë e gjithkujt, të drejtat politike të personit dhe do ta vinte vendin nën një kontroll të rreptë policor.

Studimet në fjalë theksojnë se megjithatë një hap i rëndësishëm për ta zvogëluar dhe minimizuar korrupsionin pa i hequr megjithatë tharmin dhe sharmin spontan dhe privat demokracisë, është krijimi i një administrate dhe i një sistemi gjyqësor sa më pak të politizuar dhe sa më larg interesave dhe praktikave elektorale të partive

politike. Kjo merr një rëndësi të dorës së parë në vendin tonë për shkak se administratori dhe nëpunësi me një status të politizuar i bëjnë këta që nga njëra anë të tentohen prej veprimtarive korruptive dhe nga ana tjetër të çedojnë, pra të lëshojnë pe ndaj urdhrave të shefave të tyre që kërkojnë, kundrejt parasë korruptive, të krijojnë privilegje ekonomike për individë, shtresa apo grupime ekonomike të caktuara.

Nëpunësi i politizuar ndjehet i përkohshëm në postin e tij, prandaj e kthen atë në një pazar korruptiv për të fituar vetë ose shefat e tij.

Krijimi i një administrate të papolitizuar apo i një pushteti gjyqësor jashtë influencave politike, ndërtimi i praktikave administrative të dobishme kërkon një analizë tjetër më të gjatë.

Këtu, po të theksojmë vetëm se ky proces duhet parë me përparësi, nëse na duhet të ecim përpara drejt një shoqërie sa më të spastruar prej korrupsionit.

Varfëria dhe mungesave e infrastrukturave

Në literaturën filozofike dhe sociologjike që përbën bazën shpjeguese dhe kuptimore të rrënjëve të korrupsionit zënë vend edhe analizat që pati bërë për këtë problem Michel Fuko.

Duke analizuar zanafillat e veprimtarisë ekonomike ilegale, të vjedhjeve në periudhën e zanafillave të kapitalizmit, ai shpjegon se klasa e atëhershme sunduese i toleronte ato disi duke i quajtur si veprimtari ilegale e domosdoshme. I konsideronte si një lloj mekanizmi rishpërndarjeje që i lejonte individët dhe familjet në qoshe të varfërisë për të mbijetuar.

Nuk duhet harruar në asnjë mënyrë ky koncept i Fukosë mbi të ashtuquajturin "ilegalitet i domosdoshëm".

Përse e theksoj këtë në rastin tonë shqiptar?

Sepse çështja e korrupsionit, kur është fjala për masivitetin e tij

në shtresat e varfra të shoqërisë bëhet shumë e ndërlikuar. Të mos harrojmë se vendi kalon një periudhë krize ekonomike dhe papunësie të theksuar që vjen ndër të tjera nga politikat monopolistike dhe prej korrupsionit të lartë që e ka mbajtur modelin shqiptar të ekonomisë brenda një kuadri tregtar dhe rishpërndarës. Në këto kushte, ka ndodhur që shumë fronte pune me të cilat mbajnë frymën një masë e konsiderueshme familjesh, të subvencionohen prej një paraje që vjen nga trafiqet apo nga korrupsioni.

Në këto kushte financimi korruptiv i punës ka prirje të bëhet normalitet, kurse normaliteti ligjor të prodhojë krizë ekonomike.

Ka muratorë, teknikë, hidraulikë, bojaxhinj, taksistë, mekanikë, pastrues, berberë, roje, gazetarë, mësues privatë, inxhinierë, specialistë të marrëdhënieve me publikun, shitës, marangozë, bodigardë, bukëpjekës dhe dhjetëra zanate të tjera që nga njëra anë dëmtohen rëndë nga veprimtaritë ekonomike korruptive dhe nga trafiqet, sikurse edhe përfitojnë andej si shitës të aftësive të tyre dhe të punës së tyre në një treg ku kërkesa e shprehur në pare për këtë punë ndodh që vjen masivisht edhe nga trafiqet dhe nga aferat korruptive.

Në një farë mënyre dhe në një farë shkalle kemi një lloj ribotimi të kategorisë së "ilegaliteteve të domosdoshme" për të cilat fliste Fukoja.

Prerja e rripave dhe e rrjetave të korrupsionit do të duhej të shoqërohej medoemos me një dinamikë të re ekonomike që do të sillte të tilla burime të ardhurash të tjera çka do të bënte të mundur nga njëra anë mbajtjen me punë të zanateve që numëruam dhe nga ana tjetër zgjerimin e tregut të punës.

E themi këtë, sepse në gjendjen aktuale te ne kemi:

Punë të pandershme të shpërblyer me pare të ndershme.

Punë të pandershme të shpërblyer me pare të pandershme.

Punë të ndershme të shpërblyer me pare të ndershme.

Punë të ndershme të shpërblyer me pare të pandershme.

Për këtë të fundit është fjala.

Pikërisht që të mos goditet puna e ndershme nga goditja e merituar që duhet të pësojë paraja e pandershme.

Përndryshe do të binim në paradoksin që çdo sukses i policit, prokurorit, gjykatësit, tatim-mbledhësit, doganierit, do të ishte një disfatë për berberin, marangozin, gazetarin, bukëpjekësin.

SHTOJCA 1

MBI METODOLOGJINË E STUDIMIT

Sikurse është shpjeguar edhe në “parashtrimin e problemit”, pikënisja e këtij studimi është teza e re e një ridimensionimi eventual të aksionit të shoqërisë civile duke e konsideruar demokracinë e brishtë shqiptare, e cila sapo ka hyrë në fazën e konsolidimit si një media-demokraci. E parë në këtë mënyrë dhe e kuptuar drejt dhe në kontekstin e duhur, kjo veçori e demokracisë shqiptare, që po mbyll tranzicionin e saj duke lënë përfundimisht prapa njërin prej sistemeve më të egra totalitare të Lindjes ish-komuniste, mund të kthehet në një avantazh për të rikuperuar më shpejt duke integruar më mirë përvojat më të suksesshme të vendeve të tjera. Komunikimi mediatik, nëse përdoret me efikasitet dhe profesionalizëm mund të kthehet në një instrument të fuqishëm në realizimin e këtyre qëllimeve që synojnë përparimin e vendit dhe integrimin e tij në familjen e shoqërive me kulturë të konsoliduar demokratike.

Politika moderne ose më mirë të themi shoqëria politike në epokën e medias elektronike e ka të kondicionuar suksesin ose dështimin, fitoren ose humbjen në një shkallë shumë të konsiderueshme nga aftësia për të komunikuar me publikun e gjerë. Fushatat elektorale moderne që zhvillohen sot në Shqipëri janë një shembull i përsosur

ilustrues i këtij realiteti. Sot pranohet se pothuaj të gjitha institucionet politike, sikurse janë Parlamenti, Qeveria, partitë politike etj, por edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile (organizata kombëtare dhe ndërkombëtare), grupet e presionit, grupet e interesit etj, janë duke adaptuar strategji komunikimi për të mobilizuar opinionin publik apo për të ndërthurur dhe harmonizuar interesat që këto entitete përfaqësojnë respektivisht, sidomos para dhe gjatë procesit ligjbërës dhe në implementimin e politikave qeverisëse.

Studimi i Qendrës për Çështje të Informimit Publik mori përsipër pikërisht të sondojë këtë realitet mediatik në Shqipëri dhe potencialin që ai mbart për t'u kthyer në një lokus ndërveprimi mes aktorëve të politikës dhe shoqërisë civile për të ndikuar pozitivisht mbi proceset qeverisëse dhe ligjbërëse. Shqipëria aktualisht është në fazën e përafrimit të legjisllacionit të saj me atë të vendeve të BE-së. Përveçse detyrimet që ka vendi në kuadër të proceseve të integritetit, ky legjisllacion duhet të mbajë shumë mirë parasysh edhe nevojat specifike, të cilat prodhon realiteti shqiptar.

Për shkak të volumit relativisht të lartë të procesit ligjbërës dhe nevojave për reforma me karakter institucional, shoqëria politike nuk e ka të gjithë "luksin" që do të dëshironte për të prodhuar ligje dhe implementuar politika me cilësi të garantuara në të gjitha rastet. Një proces ligjbërës duhet të garantojë dy aspekte shumë të rëndësishme në mënyrë që të meritojë të quhet i suksesshëm:

1. Aspektin demokratik, i cili kryesisht ka të bëjë me transparencën dhe pjesëmarrjen dhe që konsiston në diskutimin e projektligjeve me grupet e interesit dhe aktorët e interesuar, mundësisht që në procesin e draftimit nëpër institucionet qeveritare. Ky proces është shumë i domosdoshëm në krijimin e një balance në harmonizimin e interesave të grupeve dhe aktorëve të ndryshëm.

2. Aspektin kualitativ, i cili ka të bëjë kryesisht me cilësinë dhe efektivitetin ligjeve, pra me mënyrën në të cilën legjisllacioni bën të mundur arritjen e objektivave të ligjvënësve si një instrument legal.

Zakonisht vëmendja kritike e medias në realitetin shqiptar drejtohet kryesisht ndaj aspektit të dytë dhe në raste shumë të rralla ajo ka në fokus të veprimtarisë së saj aspektin e parë. Është pikërisht terreni ku vepron aspekti demokratik i proceseve legjislativë, por edhe i hartimit të politikës atje ku vendos "të shkelë" studimi në fjalë.

Nga pikëpamja metodologjike studimi mori përsipër të analizojë një seri intervistash dhe debatesh televizive, kryesisht të orientuara ndaj temave të debatit të ditës, me orientim të fortë në proceset legjislativë dhe ndërmarrjen e reformave si dhe mënyrën e implementim të politikeve qeverisëse, sidomos ato që synojnë goditjen dhe/apo minimizimin e korrupsionit, duke promovuar iniciativat antikorrupsion të shoqërisë civile dhe duke marrë përsipër të amplifikojë efektin e tyre në publik për të të gjeneruar një mbështetje masive nga shtresat e gjera të popullatës.

Fillimisht, metodologjia e përcaktuar parashikonte një lloj "nxemje" për ata aktorë të shoqërisë civile, të cilët kishin afirmuar vullnetin në kuadër të organizatave që përfaqësonin për të dhënë kontributin e tyre në influencimin e proceseve antikorrupsion. Që nga data 5 dhjetor 2006 e deri në fund të janarit 2007, në programin *Vila 24* u ftuan për të promovuar iniciativat e tyre antikorrupsion:

Marjana PAPA, CAO (02/01/2007, h 09:00)

Endri SHABANI, Parlamenti Rinor (dy herë 18/01/2007, h 13:00, 18/01/2007 h 13:00)

Genta RAMADANI, Gratë mbështesin Gratë, (11/01/2007, h 13:00)

Sotiraq HRONI, IDM (dy herë - 05/12/2006 h 12:00, 16/01/2007 h 13:00)

Krista KUME, ACAC (4 herë - 12/12/2006 h 09:00---12/01/2007 h 12:00, --- 23/01/2007 h 09:00, 18/02/2007 h 14:00)

Genci CAUSHI, ACAC (24/01/2007 h 09:00)

Arta Dyrmishi, Mbrojtja e të drejtave të gruas, Berat (19/01/2007 h 13:00)

Aurela ANASTASI, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. Tiranë (22/01/2007 h 12:00)

Belioza Çoku, Zhvillimi dhe e ardhmja e fëmijëve, SH.ZH.A.F. (25/01/2007 h 13:00)

Dr. Zef Preçi, ACER (dy herë 11/01/2007 h 12:00 29/01/2007 h 13:00)

Suela Kusi, Aleanca për Fëmijët në Shqipëri, (30/01/2007 h 12:00)

Në fillim të muajit shkurt 2007, unë pranova të drejtoj programin STUDIO 24. Programi është i konceptuar si një panel debat ku përgjithësisht të ftuar janë dy përfaqësues nga politika (mazhorancë-opozitë) dhe shpeshherë dy përfaqësues nga shoqëria civile ose media. Nga përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë marrë ftesa dhe kanë pranuar të vijnë:

Kreshnik Spahiu, CAO, (debat i drejtpërdrejtë me ministrin e Drejtësisë të kohës, Aldo Bumçi, ish-ministrin socialist të Drejtësisë, Fatmir Xhafa, dhe Ilir Panda, nënkryetar i KLD-së)

Kliton Zguri, CAO (dy herë, për t'i adresuar pyetje Sokol Olldashit, kandidat i PD-së për postin e Bashkisë së Tiranës dhe Edi Rama, kandidat për një mandat të tretë në krye të Bashkisë së Tiranës)
Julian Pema, CAO

Genta Ramadani, "Gratë mbështesin gratë" (për t'i adresuar pyetje Edi Ramës, kandidat për një mandat të tretë në krye të Bashkisë së Tiranës)

Endri Shabani, Parlamenti Rinor (dy herë për t'i adresuar pyetje Olldashit dhe Ramës gjatë të njëjtave intervista)

Dr. Zef Preci, ACER (dy herë për t'i adresuar pyetje Olldashit dhe Ramës gjatë të njëjtave intervista) dhe i ftuar disa herë në debate, mes të cilave përmend atë të zhvilluar në *Studio 24* në datë 19 shkurt

2007, një ditë pas zgjedhjeve lokale dhe ku të ftuar të tjerë në panel për të debatuar kanë qenë Neritan Ceka, kryetar i PAD-së, Nard Ndoka, kryetar i PDK-së, Ylli Rakipi, drejtor i gazetës "Albania".

Kristaq Kume, ACAC, i ftuar në *Studio 24, Special Edition*, ditën e votimeve më 18 shkurt 2007

Ilirian Celibashi, ECA, i ftuar në *Studio 24, Special Edition*, ditën e votimeve më 18 shkurt 2007.

Të gjitha këto dalje publike në media të përfaqësuesve të shoqërisë civile gjatë periudhës dymujore dhjetor 2006-janar 2007 mund të strukturohen në katër argumente kryesore, te të cilat është fokusuar studimi për të indikuar reagimin e përfaqësuesve të shoqërisë politike ndaj problemeve të adresuara nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe integrimin e tyre në procesin ligjberës. Këto katër argumente janë:

Procesi legjislativ i ligjit "Për shërbimin e Policisë së Shtetit"
 Reforma në sistemin gjyqësor
 Kriza e energjisë elektrike
 Zgjedhjet lokale

Të ftuar si përfaqësues të legjislativit dhe ekzekutiv në Vila 24 për:

Procesi legjislativ ligjit "Për Policinë e shtetit":

Sotiraq Hroni, IDM 05/12/2006 h 12:00

Fatos Beja, nënkryetar i Kuvendit 05/12/2006 h 13:00

Petro Koci, nënkryetar i Komisionit të Sigurisë 06/12/2006 h 09:00

Vasilika Hysi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 07/12.2006 h 09:00

Migena Leskoviku, Drejtore Juridike, Ministria e Brendshme
 07/12/2006 h 09:00

Spiro Peçi, Komisioni i Ligjeve, 12/12/2006 h 12:00

Reforma në sistemin gjyqësor:

Kreshnik Spahiu, (mbi 5 herë në data të ndryshme)
Spartak Ngjela, Komisioni i Ligjeve 11/12/2006 h 12:00
Spiro Peci, Komisioni i Ligjeve 12/12/2006 h 12:00
Paskal Milo, Komisioni i Politikës së Jashtme 13/12/2007 h 09:00
Afrim Krasniqi, këshilltari politik i Presidenti të Republikës
Arben Isaraj, Komisioni i Ligjeve, PS

Kriza e energjisë elektrike:

Luigj Pjetri, ish-drejtor i KESH, 08/01/2007
Dritan Prifti, deputet LSI-së, ish-drejtor i KESH-it 08/01/2007 h 13:00
Pajtim Bello, nënkryetar i PSD-së, ish-ministër i Energjetikës, 09/01/2007 h 09:00
Kreshnik Spahiu, CAO, 09/12/2007 h 12:00
Lutfi Dervishi, gazetar, 09/00 h 09:00
Luan Bregasi, kryetar i Dhomës së Tregtisë, 10/01/2007 h 12:00
Nikolla Neranxi, deputet LSI-së, 10/01/2007 h 13:00
Musa Ulqini, deputet PS-së, 11/01/2007 h 09:00
Dr. Zef Preci, ACER, 11/01/2007 h 12:00

Zgjedhjet lokale

Kristaq Kume, ACAC, 12/01/2007 h 12:00
Arben Malaj, anëtar i Komisionit të Ekonomisë, deputet i PS-së, 15/01/2007 h 09:00
Prec Zogaj, kryetar i Komisionit të Politikës së Jashtme 15/01/2007 h 13:00
Aleksander Biberaj, Komisioni i Ekonomisë, deputet PD-së,

16/01/2007 h 09:00

Arian Madhi, Komisioni i Ligjeve, kreu i Grupit Parlamentar PR,
17/01/2007 h 13:00

Dritan Prifti, Komisioni i Ekonomisë, LSI, 18/01/2007 h 09:00

Vangjel Duke, kryetar i PBDNJ-së, 19/01.2007 h 12:00

Kristaq Kume, Gerta Meta, ACAC, SHKD, 20/12/2006, h 13:00

Genci CAUSHI, ACAC, 24/01/2007 h 09:00

Vasilika Hysi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit 26/01/2007 h 09:00

Spartak Ngjela, Komisioni i Ligjeve, PD 26/01/2007 h 13:00

Në *Studio 24* të ftuar kanë qenë këtë anëtarë të Parlamentit, politikanë, (*prime time*, h 21:00)

Aldo Bumçi - Fatmir Xhafa - Ilir Panda - Kreshnik Spahiu
31/01/2007

Skënder Gjinushi (PSD) - Erion Braçe (PS) - Nard Ndoka (PDK)
02/02/2007

Sokol Olldashi, kandidat i PD-së për Bashkinë e Tiranës 07/02/2007
Arta Dade (PS) - Preç Zogaj (PD) - Lajla Përnaska (PR) - Pëllumb
Xhufi (LSI) 09/02/2007

Edi Rama 13/02/2007

Dritan Prifti (LSI) - Arian Madhi (PR) - Majlinda Bregu (PD) - Ylli
Manjani jurist pranë PS-së) 16/02/2007

Neritan Ceka (PAD) – Nard Ndoka (PDK) – Dr. Zef Preci (ACER) - Ylli
Rakipi (gazeta "Albania") 19/02/2007

Të gjitha këto intervista dhe debate të zhvilluara në dy emisione të *NEWS 24*, të drejtuara prej meje, kanë shërbyer si bazë metodike, ose më mirë të themi si "lëndë e parë" për të analizuar komportimin në media të përfaqësuesve të shoqërisë civile në raport me

përfaqësues të shoqërisë politike dhe anasjelltas.

Procesi i analizimit të sjelljes mediatike të këtyre përfaqësuesve në raport me impaktin real të krijuar në proceset konkrete, që janë kontekst i diskurit të tyre mediatik finalizohet në këtë studim me zhvillimin e 10 indikatorëve që bëjnë të mundur vlerësimin sa më objektiv të performancës së aktorëve të shoqërisë civile në media. Këta indikatorë mund të përdoren këtëj e tutje si instrumente për çdo përfaqësues të operatorëve të shoqërisë civile shqiptare për të vlerësuar performancën e tyre mediatike.

Po ashtu, këta indikatorë mund të aplikohen dhe nga përfaqësues të komunitetit të donatorëve për të vlerësuar objektivisht performancën e granteve të cilët kanë zgjidhur në punën e tyre t'i adresojnë mesazhe publikut duke përdorur fuqinë e medias në demokraci, në një shoqëri të lirë, ku gjithkush mund dhe duhet të degjohet tesa shpreh pikpamjet dhe mendimet e tij.

Ky libër është një bashkëpunim midis një gazetari që për muaj të tërë koncepton dhe drejton emisione në televizionin NEWS 24 ku ballafaqohen përfaqësues të politikës dhe të shoqërisë civile për probleme të aktualitetit, e midis tyre kanë debatuar edhe për problemin e luftës kundër korrupsionit, dhe një folozofi, specialist i logjikave të shprehjes gjuhësore, të imazhit, pra edhe të komunikimit mediatik në shtypin e shkruar si edhe në mediat audiovizive. Gerti Shella dhe Artan Fuga kanë dashur të sjellin përpara lexuesit një analizë të prodhimtarisë televizive dhe nëpërmjet saj të bëjnë një lloj skaneri të tre problemeve themelore të demokracive dhe të gjithë shoqërive bashkëkohore: roli i mediave televizive në debatin shoqëror të aktualitetit; parametrat e ballafaqimit midis shoqërisë civile dhe botës së politikës. (A është e njëjta fjalë kur thua «grup interesi» dhe kur thua «shoqatë joqeveritare»?); përqasjes semantike dhe mediatike të problemit të përbaljes me korrupsionin.

Kështu ndodh edhe me fjalën «korrupsion». Nuk është se nuk ka korrupsion real. Puna është se në politikë ajo është kthyer në një kontratë gjuhësore të të folurit të përditshëm dhe ka zëvendësuar të gjitha të tjerat. I ka shtyrë fjalët e tjera jashtë dhe përtej, sikurse themi në filozofi, fushës semantike dhe simbolike të gjuhës. Nuk dëgjohen fjalë të tjera çelës, sepse gjithë struktura e të folurit politik mbështetet në pak fjalë e midis tyre në fjalën-kyç «korrupsion». Fjala «korrupsion» është si fjala «Zot» dikur në Mesjetë. E vlefshme për të folurit politik, për të ndërtuar strategji politike, për të ndërtuar shtet, për t'u pasuruar, për të hyrë në Europë, për të ëndërruar, për të kërkuar fajje, për të përmbledhur mëkatet, për të djegur në turrën e druve shtriganët, për të trembur, për të kompaktësuar trupën e militantëve, nëpunësve dhe deputetëve, për t'u kuptuar, për të mos u kuptuar, për të shkuar në zgjedhje, për të tërhequr elektoratin në votime, për të bërë marrëveshje me rivalët dhe aleatët në minutën e fundit, për të zgjedhur Presidentin konsensual, për gjithçka.

Ajo është një fjalë magjike









